# MANUAL SHPJEGUES
# DHE
# TRAJNIMI MBI PARANDALIMIN
# E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË PUSHTETIN VENDOR

**- 3 –**

**Përgatitur nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP)**

**Në bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë ( SH.B.SH )**

**Manual Shpjegues dhe Trajnimi**
**mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Pushtetin Vendor**

Maj 2009

**DPK/USAID Kontrata me Nr.**


**USAID Programi i Shtetit Ligjor në Shqipëri**
Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit"
Sky Tower, Suite 13/3, Tiranë
Tel. +355 422 1666 Ext. 123
Fax. +355 422 1666 Ext. 192

**Shoqata e Bashkive të Shqipërisë (SH.B.SH)**
Rruga "Ismail Qemali", Pall i Fratarit, nr 27, Tiranë, Shqipëri.
Tel: 00 355 4 225 76 03
Fax: 00 355 4 225 76 06
Email: aam@albmail.com
URL: www.aam-al.com

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe i Kontrollit të Pasurive (ILDKP)**
Rruga "Reshit Collaku", Tiranë
Te. +355 4 259461 / 228527

Për raportim të deklarimeve të rreme ose për informacion
të procesit të deklarimit: 0800 99999
Fax. +355 4 288516
Email: info@hidaa@gov.al
Web: www.hidaa.gov.al


## REFUZIM


Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

**Treguesi i Lëndës**

Kapitulli I
1. Hyrje ………………………………………………………………… fq. 2-3

Kapitulli II
2. Koncepte dhe parime të përgjithshme………………………………….. fq. 4-8
   2.1. Parime të përgjithshme
   2.1. Fjalor shpjegues i termave në lidhje me konfliktin e interesit

Kapitulli III
3. Roli i organeve të pushtetit vendor në qeverisjen e veprimtarisë publike për parandalimin e konfliktit të interesit……………………………………fq. 8-21
   3.1. Autonomia dhe decentralizimi si faktor bazë në mbrojtje të interesave publike.
   3.2. Vendimmarrja në pushtetin vendor moment i rëndësishëm për rritjen e rolit të përfaqësimit të interesit publik në parandalim të konfliktit të interesave.
   3.3. Organet e qeverisjes vendore marrin rol aktiv nëpërmjet ushtrimit konkret të funksioneve dhe kompetencave përkatëse.
   3.4. Transparenca e pjesëmarrja e publikut në qeverisje dhe parandalimi i konfliktit të interesave.

Kapitulli IV
4. Konflikti i interesit në nivel vendor..........................................................fq. 21-51
   4.1. Aspekte të përgjithshme të ligjit
   4.2. Zyrtari dhe vendimarrja në kushtet e konfliktit të interesit
   4.3. Konflikti i interesave dhe llojet e tij
   4.4. Personi i lidhur me zyrtarin sipas nenit 24
   4.5. Ndalimi për lidhjen e kontratave për të gjithë zyrtarët (Neni 21/3)
   4.6. Ndalimi i sigurimit të të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë (neni 22 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005)
   4.7. Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale (neni 23)
   4.8. Konflikti i vazhdueshëm i interesit
   4.9. Raste konkrete të konfliktit të interesave sipas funksioneve të caktuara të pushtetit vendor

Kapitulli V
5. Mënyrat e trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave..........................fq 51- 76
   5.1. Institucionet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave
   5.1.1. Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive
   5.1.2 . Drejtoritë e Burimeve njerëzore
   5.1.3. Institucionet eprore dhe eprori

5.1.4. Si e ushtron këshilli i bashkisë, komunës dhe qarkut rolin e institucionit epror?
5.2. Mënyrat bazë të trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave
5.2.1. Roli i vetë zyrtarit dhe eprorit në parandalimin e konfliktit të interesave.
5.2.2. Po eprori në këtë rast çfarë duhet të bëjë ?
5.3. Zgjidhja e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave.
5.4. Procedurat konkrete të zgjidhjes së konfliktit të interesit nga zyrtaret vendore, eprorët dhe organet kolegjiale
5.4.1. Organet kolegjiale
5.4.2. Efektet e përjashtimit
5.4.3. Efektet e deklarimit të përjashtimit
5.4.4. Masat disiplinore
5.5. Pavlefshmëria e akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesit dhe pasojat
5.5.1 Aktet administrative absolutisht të pavlefshme
5.5.2. Aktet administrative relativisht të pavlefshme
5.5.3. Shfuqizimi dhe revokimi i akteve administrative
5.5.4. Nxjerrja e akteve nënligjore

ANEKSE TE MANUALIT

1. Rregullore e brendshme tip për parandalimin e konfliktit të interesave në njësitë e qeverisjes vendore
2. Roli konkret (aktiv) i organeve të qeverisjes vendore (këshilli dhe kryetari) dhe drejtime për parandalimin e konfliktit të interesave - Matrica nr. 1
3. Rritja e rolit të përfaqësimit të interesit publik në parandalimin e konfliktit të interesit, në funksion të mënyrës së zgjedhjes, organizimit dhe funksionimit të organeve të qeverisjes vendore - Matrica nr. 2
4. Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së rasteve të konfliktit të interesave - Matrica nr. 3

## QËLLIMI I MANUALIT

**Për një vendimmarrje pa konflikt interesi**



Manuali për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Pushtetin Vendor është një tjetër sfidë e përballuar me sukses nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në drejtim të përmirësimit dhe forcimit të mekanizmave të parandalimit të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike të zyrtarëve të administratës publike.

Pas publikimit të dy manualeve për parandalimin e konfliktit të interesave, të cilët kanë pasur në fokusin e tyre kryesor veprimtarinë e institucioneve qendrore, ky punim është i përqendruar tërësisht në funksion të qeverisjes vendore.

Me decentralizimin dhe rritjen e autonomisë vendore është zgjeruar fusha e veprimtarisë dhe detyrat e organeve të qeverisjes vendore, gjë e cila kërkon rritjen e përgjegjshmërisë së zyrtarëve në kryerjen e detyrave të tyre publike, në mënyrë të drejtë, të paanshme, në interesin më të mirë të publikut dhe të besimit të tij ndaj institucioneve publike, si dhe duke parandaluar në kohë rastet e konfliktit të interesave.
Institucionet vendore janë më pranë problematikës së përditshme të qytetarëve dhe interesit publik në tërësi. Për këtë arsye, efektshmëria e tyre në zbatimin korrekt të dispozitave ligjore në fushën e konfliktit të interesave, shihet si një ndër prioritet e punës së Inspektoratit të Lartë.

Në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë dhe me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), tashmë zyrtarët e nivelit lokal kanë një mjet më shumë për të zbatuar me korrektësi kërkesat e parashikuara në ligjin "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", një nisëm kjo që do të vijojë me organizimin e seminareve trajnuese me të gjitha nivelet e zyrtarëve të qeverisjes vendore.

Manuali ka një rëndësi të veçantë, pasi përbën një punim serioz për dhënien e përgjigjeve të një sërë problematikash, me të cilat përballet pushteti vendor dhe ka për qëllim krijimin e standardeve dhe unifikimin e praktikave në trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave. Procesi i vendimmarrjes, për shkak të mosnjohjes apo të mosrespektimit të ligjit, në disa raste krijon situata joligjore ose konflikt interesash, të cilat shoqërohen me përfitime të padrejta të zyrtarëve të ndryshëm apo familjarëve të tyre nga fondet publike.

Në aktivitetin e tij, Inspektorati i Lartë është përballur me situata konflikti interesi në vendimmarrjen e institucioneve lokale, më së shumti si rrjedhojë e mosnjohjes sa dhe si duhet të kërkesave ligjore, të cilat shërbyen si pikënisje për botimin e këtij Manuali.

Në formatin e një guide praktike, Manuali për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Pushtetin Vendor, synon thjeshtësimin e koncepteve teorike legjislative, në çështje të prekshme për të gjithë punonjësit e qeverisjes vendore, të cilët përfshihen në vendimmarrje të caktuara. Këtu zbërthehen raste të ndryshme të shfaqjes së konfliktit të interesave, duke u dhënë njëkohësisht përgjigje pyetjeve të ndryshme që mund të lindin gjatë procesit vendimmarrës.

I ndarë në 5 kapituj, Manuali trajton rolin dhe përgjegjësitë në vendimmarrje të vetë zyrtarit, eprorit të zyrtarit ose institucionit epror, ndalimet dhe kufizimet e posaçme që parashikon ligji për zyrtarët vendorë, procedurat dhe mjetet për identifikimin dhe regjistrimin e konflikteve të interesave, mënyrat e parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesit, si edhe masat administrative të parashikuara në rastet e shkeljeve ligjore.

Duke falënderuar grupin e punës që përgatiti Manualin, shpreh bindjen se aplikimi në praktikë i udhëzimeve të paraqitura në këtë botim do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së procesit të vendimmarrjes në institucionet e pushtetit vendor.

**INSPEKTORI I PERGJITHSHEM**

**Adriatik LLALLA**

Kapitulli I

# 1. HYRJE

Veprimtaria publike administrohet nga organet qeverisëse në tërësi. Në funksion të këtij misioni, krahas konsolidimit të organeve dhe strukturave të qeverisjes qendrore, një rol të rëndësishëm zënë organet e qeverisjes vendore që si rregull, menaxhojnë ato veprimtari publike të cilat përbëjnë problematikë me karakter vendor dhe prekin fusha më pranë komuniteteve vendore. Në këtë kuptim, mënyra se si qeveriset vendi në tërësi dhe çdo komunitet vendor në veçanti, ndikimi që luan veprimtaria qeverisëse e të gjithë strukturave qendrore dhe vendore, efektiviteti i punës së tyre në përdorimin e burimeve natyrore dhe financiare publike, të matura me dobitë që sjellin ato në raport me interesat e komunitetit, përbëjnë një tregues shumë të rëndësishëm, si për suksesin e një qeverie ashtu edhe për zhvillimin e vendit, për nivelin e përfitimit nga shërbimet publike të mbarë popullsisë.

Ndryshimet në konsolidimin e pushtetit vendor, të bazuara në dy tipare bazë, atë të rritjes së autonomisë vendore dhe atë të decentralizimit të pushtetit, kanë synuar pikërisht një qeverisje sa më efektive nga ana e tyre. Një qeverisje e tillë në nivel vendor është e aftë të trajtojë sa më drejt kërkesat e komunitetit vendor dhe të plotësojë sa më mirë interesat e qytetarëve në përgjithësi. Ndryshimet e përmednura gjithashtu synojnë t'u krijojnë organeve dhe organizmave qeverisëse mundësi reale për përcaktimin dhe identifikimin e interesave publike në kushtet konkrete të komunitetit vendor dhe, në këtë kuadër, vendosjen e raporteve sa më të drejta në mes interesave publike dhe atyre private të njerëzve që angazhohen, si të zgjedhur apo të emëruar në organet dhe institucionet publike vendore. Kjo, pasi, në raportin e interesave publike me ato private lind mundësia e konfliktit të interesit që është pjesë e të ashtuquajturit "abuzim me pushtetin" nga zyrtarët publikë (të zgjedhur apo të emëruar). Ky abuzim ndodh kur interesat personale të zyrtarit bien ndesh me kryerjen me korrektësi të detyrës publike, gjë që çon në shfrytëzim të pushtetit publik për interesa private.

Sipas një përkufizimi *"..konflikti i interesit në një kuptim të gjerë është shfrytëzimi i kryerjes së detyrës publike me qëllim përfitimi personal financiar ose jo"*. [1]

Sfida për çdo lloj qeverisjeje dhe për shoqërinë është të shqyrtojë dhe aplikojë mekanizmat adekuate për luftimin e këtij fenomeni dhe për të mënjanuar, në masë të madhe, ndërhyrjen e interesave personale në ato publike.

Qëllimi i këtij manuali është që në kushtet specifike të qeverisjes vendore, duke trajtuar probleme të parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të njësive të qeverisjes vendore si dhe duke sqaruar llojet dhe format e shfaqjes së interesave dhe konfliktit në mes tyre, të kontribuojë për një vendimmarrje dhe veprimtari ekzekutive të tyre, të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike. Kjo edhe për faktin mjaft të veçantë që lidhet me karakterin publik

[1] Gordon Tullock, "The politics of bureaucracy", Public Affairs Press, Washington DC, 1965, and Anthony Downs, "Inside bureaucracy", Little Brown, Boston, 1967.

të veprimtarisë së zyrtarëve në qeverisjen vendore (të zgjedhur dhe të emëruar), të cilët janë shumë pranë qytetarëve, për larminë e detyrave të tyre që lidhen me funksione dhe kompetenca shumë të prekshme nga komuniteti, kryesisht në fusha të shërbimeve publike vendore si: furnizimi me ujë dhe kanalizimet, shërbimi në rrugë, parqe, lulishte, varreza, pastrimi i zonave publike urbane, ndriçimi e të tjera.

Ky manual synon të jetë jo vetëm libër informues dhe i përdorshëm nga pushteti vendor, të zgjedhurit dhe të emëruarit që ushtrojnë funksione dhe detyra në qeverisjen vendore, por të shërbejë në mënyrë sa më të efektshme për të gjithë njerëzit, në afrimin e tyre sa më pranë njohjes dhe pse jo, zgjidhjes së problematikave me të cilat ato mund të ndeshen si rezultat i konfliktit të interesave.

## Kapitulli II

## 2. KONCEPTE DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Asnjë zyrtar vendor nuk duhet të jetë pjesëmarrës në veprime që në një mënyrë ose tjetrr çojnë në shfrytëzimin e postit të tij publik në shërbim të interesave personale. Ai nuk duhet të marrë pjesë në vendimmarrje në të cilat ai gjendet në kushtet e konfliktit faktik në dukje ose të mundshëm të interesave.

Parandalimi i konfliktit të interesave në pushtetin vendor duhet të bëhet sipas ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 nëpërmjet përcaktimit të rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave konkrete për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve që paraqiten.

### *2.1 Parime të përgjithshme*

Parandalimi i konfliktit të interesit kërkon të udhëhiqemi nga disa parime që rregullojnë veprimtarinë publike. Pa u shtrirë në të gjitha drejtimet, po evidentojmë disa nga parimet bazë që na shërbejnë në veprimtarinë praktike në plotësimin e misionit shumë të rëndësishëm për qeverisje cilësore dhe të sukseshme.

Si të tillë përmendim:

- *Parimi i ligjshmërisë.*
- *Parimi i barazisë dhe proporcionalitetit.*
- *Parime të përgjithshme të etikës.*
- *Parimi i kufizimit më të rreptë.*

*Parimi i ligjshmërisë*

1. Organet e Administratës Publike të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Aktet administrative të nxjerra në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të jenë të vlefshme, në qoftë se rezultati i kërkuar në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Palët e dëmtuara nga aktet e lartpërmendura kanë të drejtë të kompensohen për humbjet eventuale në bazë të dispozitave ligjore, që rregullojnë përgjegjësinë e administratës

publike[2].

*Parimi i barazisë dhe proporcionalitetit*

1. Në marrëdhëniet me personat privatë, administrata publike udhëhiqet nga parimi i barazisë në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohet apo diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore.

2. Veprimet e administratës publike, të cilat për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, kufizojnë të drejtat themelore të individit të njohura nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore, duhet gjithsesi të respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe të mos cënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave. Kjo do të thotë që veprimet e administratës publike duhet të jenë të tilla që:

- të kërkojnë realizimin e interesave të ligjshme publike;

- të përdorin gjithnjë mjete të përshtatshme dhe në proporcion me qëllimet që synohen të arrihen.

Në çdo rast, organet e administratës publike detyrohen të vlerësojnë nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre.

"Parim i proporcionalitetit" është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari ose institucioni publik me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë ose kompetencat e zyrtarit, aq më të shumta janë kufizimet e interesave të zyrtarit, aq më të ashpra janë dënimet dhe në mënyrë edhe më të hollësishme janë përcaktuar rregullat, mënyrat, mjetet dhe procedurat për parandalimin e konfliktit të interesave[3].

*Parime të përgjithshme të etikës*

Në kryerjen e funksioneve, nëpunësi i administratës publike duhet të respektojë parimet si me poshtë:

a) të kryejë detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat;

c) të sillet gjithnjë në mënyrë të tillë, që besimi i publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik të ruhet e të rritet dhe të ruajë konfidencialitetin e

[2] Kodi i Procedurave Administrative
[3] Kodi i Procedurave Administrative

informacionit, që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"

<u>*Parimi i kufizimit më të rreptë*</u>

Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim i cili është më i rreptë.

Nëse në këtë ligj, në lidhje me një interes të caktuar privat të zyrtarit, nuk është përcaktuar ndonjë kufizim sasior i këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufizimi sasior, atëherë ky kufizim zbatohet si për ligjin e parandalimit të konfliktit të interesave dhe anasjelltas[4].

## 2.2 Fjalor shpjegues i termave në lidhje me Konfliktin e Interesit

Në manual termat e mëposhtme kanë këtë kuptim:

1. **"Konflikt i interesit"** është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.
2. **"Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive"** është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.
3. **"Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive"** është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij fjalori për shkak, dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave private të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij fjalori.
4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij fjalori, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:
a) **"konflikt faktik i interesit"** është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar, ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare;
b) **"konflikt në dukje i interesit"** është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;
c) **"konflikt i mundshëm i interesit"** është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje, të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;

[4] Neni 5 pika 2 e ligjit nr.9367, datë. 7.4.2005

ç) **"konflikt rast për rast i interesit"** është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;
d) **"konflikt i vazhdueshëm i interesit"** është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.
5. **"Zotërim aktiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital"** është ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave, që burojnë nga pronësia mbi aksionet ose pjesët në kapital.
6. **"Zotërim pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital"** është gjendja, në të cilën pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër civil mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera (administrim, zotërim, tjetërsim etj.) kryhen nga një person i besuar nga pronari, bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre, që përcakton kriteret e përfitimit të fryteve të pasurisë, si dhe të drejta e detyrime të tjera të domosdoshme. I besuari nuk shkëmben asnjë mendim dhe asnjë informacion me pronarin dhe as nuk ndikohet nga ai për kryerjen e këtyre veprimeve me pasurinë. I besuari duhet të veprojë vetëm në të mirë të ruajtjes dhe rritjes së pasurisë, me të njëjtin motivim sikur këto veprime të kryheshin nga vetë pronari. Kufizimet në përzgjedhjen e të besuarit jepen në këtë ligj. Palët, në çdo rast, ruajnë të drejtën e zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje. Pronari ka të drejtë të rimarrë, në çdo kohë, të drejtat e kryerjes së veprimeve të tjera civile me pronësinë, kur, sipas këtij ligji, kushtet që e diktuan këtë veprim nuk ekzistojnë më. Të drejtat dhe detyrimet e tjera, të papërmendura më sipër, rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
7. **"Zyrtar"** është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike, sipas përcaktimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave.
8. **"Institucion publik"** në kuptimin e këtij manuali është çdo subjekt vendor dhe çdo organ i krijuar në varësi të tij, përfshirë ndërmarrjet shtetërore ose vendore, shoqëritë tregtare me pjesëmarrje kontrolluese të kapitalit vendor, OJF-të dhe persona të tjerë juridikë të kontrolluar nga subjektet e përmendura në këtë pikë.
9. **"Epror i një zyrtari"** është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucioni, që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë zyrtar, ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.
10. **"Institucion epror"** është një institucion publik (ose organ i një institucioni publik) që, sipas ligjeve në fuqi, ka kompetenca rregulluese, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese mbi një institucion tjetër publik (ose organ të tij), ku, në këtë të fundit, një zyrtar kryen detyrat dhe ushtron kompetencat e tij. Roli epror ushtrohet në përputhje me ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike. Pavarësisht nëse një institucion epror mund të ketë njërën nga kompetencat e mësipërme, ai nuk mund të vlerësohet i tillë, nëse kjo do të çonte në cenimin e parimeve kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe të autonomisë institucionale.
11. **"Person i lidhur me një zyrtar"** është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore, me zyrtarin.
a) me **"autoritet publik"** kuptohet çdo organ i administratës shtetërore dhe i enteve publike;
b) me **"dokument zyrtar"** kuptohet dokument i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik;
c) me **"person"** kuptohet çdo person, fizik ose juridik, vendas ose i huaj.
12.**"Aksion"** është titull pronësie, që përfaqëson njërën nga pjesët në të cilat është ndarë kapitali i një shoqërie dhe që i jep të drejtën zotëruesit të saj të marrë pjesë në fitime.

13. **"Pjesë e kapitalit"** është pjesa që zotëron një ortak në kapitalin e shoqërisë.
14.**"Funksion"** është fusha e veprimtarisë për të cilën është përgjegjës një organ i caktuar.
15. **"Funksione të deleguara**" janë funksione të pushtetit qendror ose të institucioneve të tjera qendrore që me ligj ose me marrëveshje caktohen të realizohen nga njësitë e qeverisjes vendore në mënyrën dhe masën e përcaktuar nga pushteti qendror dhe institucione të tjera qendrore.
16. **"Funksione të përbashkëta"** janë funksione për të cilat njësia e qeverisjes vendore ka pjesën e saj të përgjegjësisë së dallueshme nga pjesa e përgjegjësisë së dhënë pushtetit qendror, si dhe që bashkëshoqërohen përpjesëtimisht me kompetenca, të cilat i ushtron në mënyrë autonome.
17. **"Funksione të veta"** janë funksionet e dhëna me ligj njësisë së qeverisjes vendore, për të cilat ajo është përgjegjëse për realizimin, si dhe ka lirinë dhe autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për realizimin e tyre, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuara përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, shërbimi, investimi dhe rregullator.
18. **"Kompetencë"** është autoriteti dhënë me ligj një organi për kryerjen e një funksioni.
19. **"Kompetenca të veta"** janë autoritetet ekskluzive që u janë dhënë me ligj njësive të qeverisjes vendore për realizimin e funksioneve të veta.
20. **"Kompetencë administrative"** është kompetenca për menaxhimin e strukturave dhe personelit (ngritjen, përmirësimin, shkrirjen e strukturave, si dhe emërimin, shkarkimin, transferimin, kualifikimin, përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve të personelit) në përputhje me legjislacionin në fuqi.
21. **"Kompetencë e deleguar"** është kompetenca e pushtetit qendror që, me ligj ose me marrëveshje, i është dhënë njësisë së qeverisjes vendore.
22. **"Kompetencë investimi"** është kompetenca për planifikimin, shpërndarjen dhe realizimin e investimeve.
23. **"Kompetencë rregullatore"** është kompetenca për krijimin dhe vendosjen e rregullave (dhënie liçensash, caktime oraresh, vendosje gjobash ose në përgjithësi dhënie të drejtash.
24. "**Kompetencë shërbimi"** është aftësia e organeve të qeverisjes vendore për planifikimin, shpërndarjen, dhe realizimin e mirëmbajtjes së objekteve dhe shërbimeve ndihmëse.
25. **"Subjekt i kompetencave të përbashkëta"** është një komitet, ent, institucion, ndërmarrje ose bord, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të qeverisjes vendore ose mes njësive të qeverisjes vendore dhe institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e një shërbimi ose përmbushjen e një detyrimi të përbashkët.
26. **"Subsidiaritet"** është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë shtetasve.
27. **"Nëpunësit civilë"** janë ata nëpunës të institucioneve të administratës publike të nivelit qendror apo vendor, të cilët ushtrojnë autoritetin publik në detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse apo ekzekutuese, përcaktuar sipas ligjit për statusin e nëpunësit civil.
28. Me **"epror direkt"** në kuptimin e ligjit për statusin e nëpunësit civil, do t'i referohemi: drejtorit të drejtorisë për klasat nga shef sektori deri specialist, sekretarit të përgjithshëm për klasat nga drejtor departamenti, deri në drejtor drejtorie dhe titullarit ose organit drejtues të institucionit për sekretarin e përgjithshëm.
39. **"Përgjegjësi jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore"** kuptohet detyrimi i organeve të administratës shtetërore për të shpërblyer dëmin që këto të fundit i

kanë shkaktuar interesave të personave privatë në ushtrim e sipër të funksioneve të tyre publike.
30. **“Kundërvajtja administrative”** quhet shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet shtetërore kompetente e kryer me veprim ose mosveprim dhe për të cilën parashikohet një dënim administrativ.
31. **“Me veprimtari të jashtme të nëpunësit”** kuptojmë çdo lloj veprimtarie të rregullt ose të rastësishme, që kërkon angazhimin e nëpunësit të administratës publike, qoftë për qëllime fitimi ose jo, që nëpunësi zhvillon jashtë detyrës zyrtare.

## Kapitulli III

## 3. ROLI I ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT.

### 3.1. Autonomia dhe decentralizimi si faktor bazë në mbrojtje të interesave publike.

Decentralizimi dhe autonomia vendore kanë bërë të mundur rritjen e aftësive vepruese të organeve të qeverisjes vendore në ushtrim të funksioneve publike me karakter vendor.

Ndryshimet në sistemin e qeverisjes vendore për pajisjen me atributet përkatëse u filluan qysh në vitin 1992 me transformimin radikal të strukturave të mëparshme të organeve të pushtetit vendor. Një objektiv i tillë u vendos në baza ligjore me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me miratimin nga Kuvendi të "Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore" dhe, menjëherë, në vitin 2000, u konsolidua dhe u konkretizua me ligjin nr. 8652, datë 31.6.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Përmendim në veçanti nenin 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet:

*"Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore". (2)* (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë)[5].

Në zbatim të kësaj dispozite, autonomia vendore dhe decentralizimi, si dy shinat kryesore përcaktuese të këtyre ndryshimeve, janë shtrirë dhe konsoliduar në mënyrë progresive.

Ecuria e transformimeve deri tani e në vazhdim, e ka bërë veprimtarinë e organeve dhe institucioneve të qeverisjes vendore mjaft të ndjeshme ndaj mënyrës se si veprojnë këto organe në shërbim të interesave publike. Përcaktime bazë në këtë drejtim janë bërë në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"[6] dhe që përshkojnë të gjithë këtë ligj dhe ligjet e tjera që kanë ndikim në punën e organeve të qeverisjes vendore.

➢ ***Autonomia vendore*** *ka bërë të mundur* që organet e qeverisjes vendore të zhvillojnë veprimtari të pavarur, t'i japin atyre autoritet të mjaftueshëm për të realizuar atë pjesë të qeverisjes të veprimtarisë publike të garantuar me ligj, e përcaktuar në "Kreun III" "Të drejtat e njësive të qeverisjes vendore" të ligjit organik të qeverisjes vendore. Në thelb autonomia e organeve të qeverisjes vendore është e siguruar me anë të:

- **autonomisë politike**, që shprehet në faktin që organet e qeverisjes vendore kanë autoritetin e mjaftueshëm për të marrë vendime për probleme të kompetencës së tyre, brenda kuadrit ligjor që vepron në shkallë vendi dhe nuk ka ndonjë autoritet tjetër administrativ që të shfuqizojë vendimet e tyre. Shfuqizimi i vendimeve bëhet vetëm në rrugë gjyqësore, për rastet kur është vepruar në kundërshtim me ligjin.

---

[5] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

[6] Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

- **autonomisë financiare**, pasi organet e qeverisjes vendore kanë mjetet e veta financiare me të cilat mbështesin realizimin e angazhimeve të tyre,

- **autonomisë administrative** që gjen shprehjen në autoritetin e mjaftueshëm ligjor të organeve të qeverisjes vendore për të administruar veprimtarinë për realizimin e angazhimeve, në mënyrën më efektive në kushtet e njësisë përkatëse brenda rregullave dhe mënyrave të përcaktuara me ligj.

➢ **D*ecentralizimi*** (i shprehur në mënyrë të përmbledhur në nenet, 10, 11, 12, 32, 44 dhe 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000") ka bërë të mundur të përcaktohen dhe konkretizohen fushat e veprimtarisë ku ushtrohet qeverisja e jetës publike nga organet e pushtetit vendor, si dhe mjetet që përdoren për të mundësuar rolin aktiv të tyre në qeverisje.

Me legjislacion janë përcaktuar qartë:

- fushat e veprimtarisë që janë përgjegjësi e pushtetit vendor në tërësi si dhe të çdo organi në veçanti;
- rrugët dhe mjetet për të bërë realitet misionin e tyre, secili nga organet apo edhe administrata e tyre, me kompetencat konkrete përkatëse.

Lidhur me faktin që qeverisja vendore është aktor i rëndësishëm në menaxhimin e veprimtarive publike, lufta kundër përfitimeve personale nga zyrtarët (individët) e angazhuar në këtë fushë, parandalimi i çdo veprimi në këndvështrimin e përfitimeve të paligjshme dhe të pamerituara, i shprehur edhe në parandalimin e konfliktit të interesit, përbëjnë një tregues mjaft të rëndësishëm dhe pasqyrim të nivelit dhe mënyrës së ushtrimit të qeverisjes. Kjo bëhet më e prekshme për faktin që veprimtaria publike e organeve të qeverisjes vendore ushtrohet në fusha mjaft të prekshme nga komuniteti dhe ballafaqohet çdo ditë me nevojat dhe interesat publike.

## 3.2. Vendimmarrja në pushtetin vendor, faktor i rëndësishëm për rritjen e rolit të përfaqësimit të interesit publik në parandalim të konfliktit të interesave.

Në pjesën e gjashtë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohen parimet bazë të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore. Sipas nenit 108, pika 1 të saj: "Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet". Po ashtu, në nenin 109, pika 1 thuhet: "Organet përfaqësuese të njësive të qeverisjes vendore janë këshillat..." ndërsa në pikën 2 më poshtë përcaktohet që: "Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari..." Rregullat për realizimin e misionit të mësipërm u zbërthyen më tej me ligjin nr. 8652 datë 31.7.2000.

### a. Organet përfaqësuese.

- *Në bashki dhe komuna, krijohet këshilli i bashkisë ose komunës, si organ përfaqësues* i komunitetit për njësinë vendore, me zgjedhje të drejtpërdrejta, dhe, me atributin për marrjen e vendimeve në fusha dhe për kompetenca të përcaktuara sipas ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 (neni 8, pika I/b). Madje këshilli nuk ka mundësi të delegojë tek organet ekzekutive

(kryetari), disa funksione ekskluzive të tij si: buxheti, pronat publike, taksat e tarifat vendore etj, (neni 44/a).

- *Në qark, krijohet këshilli i qarkut si organ përfaqësues*, i cili formohet nga përfaqësuesit e komunave dhe bashkive, në numër në raport me numrin e popullsisë përkatëse.

Mënyra e krijimit të organeve përfaqësuese të qeverisjes vendore, e organizimit dhe funksionimit të tyre, përbëjnë kushte shumë të domosdoshme për misionin që ato marrin përsipër si përfaqësues të komuniteteve vendore dhe në ushtrim të detyrave për t'u shërbyer banorëve në plotësim të interesave të tyre publike. Madje, betimi që bën çdo i zgjedhur në këshillin vendor, me marrjen e mandatit, përbën një "kontratë" të tij me komunitetin, pasi në të, ndër të tjera thuhet shprehimisht: "..do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të komunës ose bashkisë.." (neni 28, ligji nr. 8652, datë 31.7.2000).

- *Masa për t'i paraprirë parandalimit të konfliktit të interesave* qysh në momentin e krijimit të këshillave vendore, janë përcaktuar në ligjin për qeverisjen vendore, nr. 8652, datë 31.7.2000. Në nenin 25 të këtij ligji shprehet në mënyrë të drejtpërdrejtë:

- Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit me funksionin e kryetarit, zëvendës/kryetarit të bashkisë/ komunës, të sekretarit të këshillit, të nëpunësit të administratës së bashkisë/ komunës përkatëse, funksionin e deputetit.

- Nuk mund të jenë anëtarë në të njëjtin këshill persona që janë me njëri-tjetrin bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrri e vjehrra me nusen apo dhëndrin.

Mbi bazën e këtyre dispozitave, kandidatët për anëtarë në këshillat vendore (të bashkive dhe komunave) nuk mund të marrin mandatin nëse nuk plotësojnë kriteret e mësipërme.

Që të plotësohet kjo kërkesë ligjore duhet që, para se të anëtarësohet në këshill, kandidati:

i. të japë dorëheqjen nga funksionet administrative, ose e kundërta, në se nuk jep dorëheqjen nga detyra të përcaktuara më sipër, nuk mund të marrë mandatin si përfaqësues i komunitetit;
ii. ii. në rast se fitojnë të drejtën e anëtarit të këshillit dy persona të lidhur si më sipër, paraprakisht, njëri nga ata duhet të japë dorëheqjen.

- *Në masa me karakter organizativ* të organeve të qeverisjes vendore shërben respektimi i rregullave të përcaktuara në ligj, si dhe të atyre që përcakton vetë çdo organ në kushtet përkatëse. Organet përfaqësuese, në ushtrim të funksioneve të tyre përdorin forma të shumta organizimi. Ato ngrenë komisione, krijojnë institucione e ndërmarrje për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Eksperienca e këtyre viteve ndryshimesh demokratike ka vërtetuar se, ngritja dhe përdorimi në mënyrë të organizuar mirë i strukturave të tilla të brendshme pranë këshillave vendore, ka rritur ndjeshëm shkallën e komunikimit të organeve qeverisëse me banorët dhe ato (organet qeverisëse), bëhen mjaft efiçiente në parandalimin e konfliktit të interesave, si në fazën e vendimmarrjeve ashtu edhe në ecurinë e zbatimit të tyre.

• *Funksionimi i organeve të qeverisjes vendore kërkon respektim të normave* sipas përcaktimit në "Kodin e procedurave administrative" për organet kolegjiale, si dhe në "Kreun e VI" të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000.

Ndër normat më të rëndësishme evidentojmë:

- përgatitjen paraprake për zhvillimin e mbledhjeve;
- sigurimin e numrit të mjaftueshëm të anëtarëve të këshillit (kuorumi i nevojshëm) për zhvillimin e mbledhjeve;
- shqyrtimin dhe diskutimin serioz të problemeve, mënyrën e marrjes së vendimeve me votimin e shumicës (relative, absolute apo shumicë e kërkuar), sipas përcaktimit në nenin 33 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000;
- dokumentimin e mbledhjes, përpunimin dhe publikimin e akteve, etj.

Në nenin 8, pika I/b të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 , lidhur me organet e qeverisjes vendore parashikohet se:
*"Bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra që janë të detyrueshme për të gjithë subjektet e përfshira në akt, në juridiksionin e tyre".*

Në lidhje me mënyrën e funksionimit të këshillit, ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, përcakton norma të drejtpërdrejta në shërbim të parandalimit të konfliktit të interesave. Në neni 30, pika 1, ky ligj ka përcaktuar që:
" Këshilltari nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe miratimin e aktit të këshillit kur ai vetë ose bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, vjehrri, vjehrra, dhëndëri e nusja e tij, kanë interes pasuror ose çdo interes tjetër me çështjen që diskutohet në këshill".

Kjo përbën një normë me karakter të përhershëm që mundëson shmangien nga ndikimi i drejtpërdrejtë i këshilltarit në vendimmarrjen rast pas rast të konfliktit të interesit. Për vetë karakterin e funksioneve dhe kompetencave që ka këshilli me vendimmarrje për probleme të tilla si miratimi i shesheve të ndërtimit, përfitimi i strehimit në banesa sociale për të pastrehët, e drejta e bursës, akordimi i ndihmës ekonomike, etj., respektimi i kësaj dispozite, nga njëra anë normalizon raportet "funksion publik" me "përfitimin personal" për parandalimin e konfliktit të interesit por, nga ana tjetër, krijon mundësi që zyrtari ose personi i lidhur me atë, të mos përjashtohet apriori nga përfitimet ligjore, si qytetar i zakonshëm.

Formimi (krijimi) dhe përbërja e organeve të zgjedhura, si dhe organizimi e funksionimi i tyre në plotësim të detyrimeve ligjore, përbëjnë faktor shumë të rëndësishëm për t'i shërbyer komunitetit në plotësim të interesit publik. Çdo nënvlerësim në këto drejtime përbën element që nxit ose i hap rrugë përfitimit të drejtpërdrejtë individual ose të grupeve të caktuara përfituesish, në dëm të komunitetit dhe interesave publike, gjë që detyrimisht duhet parandaluar.

Veprime në konflikt interesi në kundërshtim me ligjin nga të zgjedhur të veçantë janë të mundshëm të ndodhin më shumë kur ndikojnë, nga njëra anë masat jo të mira organizative

dhe funksionale dhe, nga ana tjetër, qoftë edhe si pasojë e të parës, kur nga individë të veçantë ka abuzim me detyrën, duke vënë në plan të parë përfitimin personal.

Për ta ilustruar idenë e mësipërme përmendim:

- Nëse këshilli me vendimet e tij, kur diskuton për miratimin e shesheve të ndërtimit apo dhënien e bursave të nxënësve e studentëve, favorizon me përparësi individë të caktuar të lidhur me këshilltarë apo punonjës të administratës që kanë ndikim në vendimmarrje.
- Në rast se këshilli bën shpërndarje të fondeve të ndihmës ekonomike me preferenca dhe për persona apo familje që janë të lidhur me anëtarë të këshillit, pa i përjashtuar këto të fundit nga procesi i diskutimit dhe vendimmarrjes.
- Në rastin kur këshilli diskuton dhe miraton, me destinacion të caktuar, fonde për investime apo shërbime, kur është i qartë që institucioni apo ndërmarrja përdoruese e tyre drejtohet nga persona të lidhur me interesa, në këtë rast me këshilltarë apo me drejtues dhe nëpunës të interesuar për këtë.

- *Disa nga momentet e rëndësishme të krijimit, organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore në këndvështrimin e parandalimit të konfliktit të interesit.*

Raste të konfliktit të interesave në veprimtarinë e anëtarëve të këshillave të bashkive, komunave apo qarqeve, parandalohen nëpërmjet masave korrekte, nga ana e këshillit, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e të gjithë strukturave që janë aktor të një vendimmarrje të tillë, ku vëmendje e veçantë i duhet kushtuar funksionimit të komisioneve dhe "filtrave" të tjerë të kësaj natyre që përmendëm më lart si struktura në shërbim të një vendimmarrje korrekte nga ana e këshillit e deri në respektim të normave në procesin e diskutimit dhe marrjes së vendimit në mbledhjet plenare të vetë këshillit.

Në këtë drejtim evidentojmë sidomos:

➢ *Të zgjidhen përfaqësuesit më të denjë të komunitetit,* ato që meritojnë besimin qytetar, njerëzit që kanë manifestuar interesimin për komunitetin dhe përfitimin personal nuk e shohin si qëllim në vetvete, por vetëm në rastet dhe në kuadër të përfitimit kolektiv dhe publik.

➢ *Të merren masa organizative të qëndrueshme* që veprimtaria e këshillave vendore, si organe kolegjiale, në ushtrim të funksioneve, kompetencave, të drejtave dhe detyrave përkatëse, të përshkohet kurdoherë nga këndvështrimi i plotësimit të interesave publike.

Kjo bëhet e mundur të realizohet nëpërmjet:

- Respektimit rigoroz të të gjitha dispozitave ligjore si në organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale ashtu edhe ato sektoriale sipas fushave të veprimtarisë që realizon këshilli.

  Kështu p.sh. një procedurë korrekte votimi sipas përcaktimeve në ligj, me kuorumin e domosdoshëm, si dhe duke përjashtuar nga shqyrtimi dhe votimi anëtarët që kanë

interesa për çështjen në diskutim, parandalon konfliktin e interesave në vendimmarrje të këshilltarëve të caktuar.

- Miratimit të statutit të njësisë vendore, hartimin, pasurimin e vazhdueshëm të rregullores së këshillit dhe më pas respektimin rigoroz të tyre që përbëjnë masa shumë të rëndësishme për institucionalizimin e demokracisë brenda organeve kolegjiale dhe të domosdoshme për plotësimin e misionit të përfaqësimit të komunitetit me korrektësi.

Si e tillë raportet e përcaktuara qartë të këshillit me kryetarin e bashkisë/ komunës e këshillit të qarkut, administratën dhe institucionet e varësisë, me objektiv që këshilli të jetë i pavarur në arsyetimet dhe argumentet e veta para vendimmarrjes, lehtëson mjaft mirë këshillin në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të veçanta në drejtim të interesave publike duke shmangur zgjidhje të problemeve në favor të përfitimeve të mundshme materiale nga zyrtarët (të zgjedhurit apo të emëruarit) dhe personave të lidhur me ato.

- Këshillat e bashkive/ komunave dhe qarqeve, të ndërtojnë gjithnjë e më mirë problematikën e punës së vet dhe institucioneve të tyre, duke përcaktuar sa më drejt fushat prioritare dhe duke u ndalur në mënyrë të veçantë në zgjidhjen e problemeve kyçe duke përcaktuar norma, kritere, rregulla me karakter të përgjithshëm që duhen respektuar më pas në zgjidhjen rast pas rasti.

Për ta ilustruar marrim si shembull që në ushtrim të kompetencës për strehimin me banesa sociale të familjeve në nevojë, marrja e masave paraprake, duke përcaktuar kritere për përfituesit, duke vendosur një sistem pikëzimi për kriteret e caktuara, lehtëson vendimmarrjen rast për rast dhe shmang madje edhe trajton me përgjegjësi çdo përfitues duke mos lejuar favorizime në konflikt interesi.

- Organizimi i veprimtarisë së këshillit me programe zhvilluese dhe projekte konkrete, të miratuara në mënyrë demokratike me një proces të gjerë konsultimi.

Për shembull, miratimi në kohë i programeve dhe projekteve për infrastrukturën rrugore në bashki, parandalon procedura të përshpejtuara të përdorimit të fondeve, duke mos lënë shteg për përfitime të paligjshme të subjekteve të caktuara si dhe duke kapërcyer vështirësitë në proces të parandalimit të konfliktit të interesit.

- Funksionimi dhe përdorimi efektiv i strukturave dhe organizmave që ndërton dhe organizon këshilli si komisionet, grupet e punës apo komitetet këshilluese, etj, me qëllim që për çdo problem, kurdoherë në vendimmarrjen për zgjidhjen e tyre, ato të jenë të njohur dhe të orientuar drejt interesave publike, të identifikuara qartë, të shërbejnë si filtër i veçantë në vlerësimin se sa përfiton komuniteti nga veprimtaria publike që administron këshilli.

Në funksion të këtij qëllimi shërben p.sh. diskutimi paraprak i marrëveshjeve apo kontratave me ndërmarrjet në sipërmarrje, në komisionet e këshillit si p.sh. për pastrimin dhe heqjen e mbeturinave. Kjo përbën një mundësi reale që parandalon rastet e konfliktit të interesit, duke mos lejuar vendimmarrje të këshillit për kontrata me persona që ndalohen nga ligji ose duke parandaluar lehtësira për subjektet palë në kontratë në dëm të interesave publike.

- Kontrolli në proces të veprimeve në zbatim të vendimeve, gjë që përbën një hallkë shumë të rëndësishme dhe me mundësi të mëdha parandaluese. Ky kontroll duhet të shtrihet me kompetencë, si në drejtim të krijimit të të ardhurave dhe përdorimit të fondeve publike, por edhe në drejtime të tilla si: përdorimi efektiv dhe për interesa publike i pronës publike, respektim i legjislacionit në emërimin e personelit, në organizimin dhe drejtimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve të varësisë, etj.

Si shembull përmendim se kontrolli mbi strukturat e taksave të bashkisë/ komunës, me komisione të këshillit, (pa përjashtuar mënyra të tjera) ndihmon ndjeshëm zbutjen e evazionit fiskal, në eleminimin e pabarazisë në vjeljen e detyrimeve nga subjekte të caktuara dhe rastet e lëshimeve si rezultat i personave të lidhur të interesit, etj.

- Transparenca me publikun dhe pjesëmarrj e komunitetit në qeverisje, të zbatuara drejtpërdrejt t nga këshilli, me mënyra sa më të thjeshta e të qarta komunikimi, përbën një moment shumë të rëndësishëm për parandalimin e konfliktit të interesit. Publiku ka këndvështrim shumë të gjerë dhe njeh edhe momente që, nganjëherë zor se mund të identifikohen vetëm nga këshilltarët.

Përmendim që prezantimi në publik i projekt/buxhetit para miratimit nga këshilli, i aktivizon banorët të shprehen qartë për destinacionin e përdorimit të fondeve, madje edhe të respektimit të rregullave për krijimin e të ardhurave sidomos nëpërmjet aplikimit të barabartë të vjeljes së detyrimeve duke parandaluar raste të prezencës së konfliktit të interesit por edhe të shkallës dhe formave të përfitimit nga individë të veçantë, në dëm të interesave publike.

Një veprimtari e organizuar me masa të kësaj natyre apo me të tjera si këto sipas specifikave, nga ***këshilli,*** krijon terren të përshtatshëm për parandalimin e konfliktit të interesit.

**b. Organet ekzekutive**

Kryetari i bashkisë ose komunës, përbën organin ekzekutiv në bashki dhe komuna, ndërsa në këshillin e qarkut, misionin ekzekutiv e kryen kryesia dhe kryetari i këshillit të qarkut. Ato kanë si mision kryesor të zbatojnë vendimet e organit përfaqësues (këshillit) si dhe detyra të tjera të caktuara me ligj, ekskluzivisht në kompetencë të tyre.

Në nenin 109, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thuhet:

*"Organi ekzekutiv i bashkisë ose komunës është kryetari, ...."*

Kryetari i bashkisë/ komunës apo kryesia dhe kryetari i këshillit të qarkut janë autoriteti që drejton të gjithë veprimtarinë realizuese, ushtron funksionet e tij ekzekutive duke punuar për plotësimin e vendimeve të këshillit apo detyrime që burojnë nga legjislacioni ynë dhe, si e tillë, tek ato pasqyrohet niveli i qeverisjes.

Nga ana tjetër, në nenin 8, pika I/c të ligjit nr. 8652 datë 31.7.2000 përcaktohet që njësitë e qeverisjes vendore: *"Krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi"*.

Aparati i administratës së bashkisë, komunës apo këshillit të qarkut kërkohet të veprojë me profesionalizëm në zbatim të funksioneve dhe kompetencave të organeve të zgjedhura dhe për këtë, përgjigjet para kryetarit por edhe para këshillit përkatës.

➢ ***Ekzekutivët e*** bashkive, komunave apo këshillave të qarqeve, kanë shumë hapësira për të parandaluar konfliktin e interesave nëpërmjet masave me karakter organizativ e funksional. Kjo konsiston në punën e vetë kryetarëve të bashkive e komunave dhe kryesive e kryetarëve të këshillave të qarqeve dhe më pas, në veprimtarinë e administratës së tyre dhe institucioneve që ato menaxhojnë, në lidhje me organizimin e tyre dhe strukturave përkatëse, ashtu edhe në mënyrën e funksionimit të tyre.

Disa nga drejtimet që mund të vlerësohen me ndikim në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesave pa u kufizuar në to, mund të përmendim:

- Njohja e legjislacionit me karakter të përgjithshëm dhe atë sektorial dhe disiplina në zbatimin e tij, padyshim përbëjnë faktorin bazë dhe shumë të rëndësishëm që ekzekutivi (përfshi administratën) të mos gabojë dhe mos t'i krijojë terren përfitimit nga individë, në dëm të interesave publike, në konflikt interesi.

  Për shembull, njohja e mirë nga administrata dhe nga vetë kryetari i bashkisë/ komunës i legjislacionit në fushën e prokurimeve, përbën një mundësi reale për parandalimin e konfliktit të interesave në procesin dhe vendimmarrjen për përdorimin e fondeve publike.

- Hartimi i rregullores së administratës, me ndarje të qartë të detyrave të drejtorive, zyrave dhe të specialistëve të veçantë dhe deri tek përcaktimi i kompleksit të metodave për bashkërendimin e punëve dhe organizimin e saj në ekip, përbëjnë faktor shumë të rëndësishëm për cilësi dhe korrektësi në ushtrimin e detyrave ekzekutive, si dhe ndihmë e kontroll paralel, të domosdoshëm dhe funksional në parandalimin e konfliktit të interesave.

  Kjo konkretizohet me nevojën që çdo drejtor dhe nëpunës duhet të ketë të qartë detyrat konkrete dhe të dallueshme për rolin e tij në kuadër të hartimit të projekt/akteve për këshillin apo në kompetencë të kryetarit të bashkisë, komunës apo kryesisë së këshillit të qarkut e më pas, deri në momentet e veçanta të zbatimit të tij, si dhe rolin e strukturave të tjera të administratës, me qëllim që ato, nga njëra anë të kontribuojnë për parandalimin e konfliktit të interesit të aktorëve në vendimmarrje dhe nga ana tjetër të përcaktohet qartë, të dihet mirë përgjegjësia e secilit nëse shkelen rregullat ligjore.

- Përgatitja në kohë dhe me cilësi e projekt/vendimeve për këshillin, duke filluar me buxhetin vjetor dhe projekt/buxhetin afatmesëm, si dhe të akteve në zbatim të tyre, si dhe aktet në fushën e pronave për administrimin dhe përdorimin e aseteve të veçanta të saj, pa dashur të neglizhojmë fushat e tjera, përbëjnë momente delikate dhe duhet të vlerësohen drejtë në këndvështrimin e parandalimit të konfliktit të interesave. Në projekt/aktet që përgatiten nga administrata për organet vendimmarrëse, në çdo rast duhet, në mënyrë korrekte, të pasqyrohen dhe identifikohen si autorët e projekt/akteve ashtu edhe personat e konsultuar apo që kanë kontribuar në proces të hartimit të tyre.

Për konkretizim përmendim që kryetari i bashkisë/ komunës apo këshillit të qarkut dhe administrata përkatëse, në rastet e propozimit apo zbatimit të mënyrave të përdorimit të aseteve të caktuara të pronës (si dhënie me qira, krijim ndërmarrje apo shërbim me sipërmarrje etj,) nuk mund të lejohet të kërkojë zgjidhje në kushtet e konfliktit të interesave.

- Bërja e analizave dhe studimeve në konsultim me komunitetin dhe veçanërisht me grupet e interesit janë të domosdoshme për identifikimin e interesave publike me karakter të përgjithshëm dhe, mbi këtë bazë, për të propozuar politika të qarta dhe të qëndrueshme zhvilluese. Në këto raste zgjidhja e problemit largohet shumë nga mundësia e përfitimit personal dhe si e tillë ngushtohet hapësira për krijimin e situatave me konflikt interesi.

Për shembull, nëse ka:
- analizë të nevojave të strehimit,
- studim për mënyrën e përballimit të nevojave,
- sistem konkret pikëzimi për renditjen e përfituesve të banesave sociale,

pakësohet në minimum përfitimi abuziv dhe më konkretisht i rasteve me konflikt interesi.

- Organizimi dhe funksionimi i rregullt i strukturave që ngrihen pranë bashkisë/ komunës apo këshillit të qarkut dhe ndjekja e mbështetja e punës së tyre, ndihmojnë shumë në ushtrim të kompetencave e detyrave të caktuara, në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e këshillit.

Kështu, nëse komisionet qytetare funksionojnë rregullisht dhe sidomos në prag të vendimmarrjeve, padyshim përfaqësimi i interesave të komunitetit është më i pranishëm dhe përmirëson terrenin për parandalim të konfliktit të interesave.

- Ushtrimi kontrollit intensiv dhe në proces të zbatimit të veprimtarive publike dhe raportimi sistematik pranë organeve të zgjedhura përkatëse janë një tjetër moment shumë i efektshëm për parandalimin e konfliktit të interesit. Kjo përforcohet sidomos në rastet kur realizimi i shërbimeve publike kryhet nga të tretë.

Nëse administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve e lulishteve i është besuar një enti të caktuar, kontrolli mbi marrëdhëniet që krijon ky ent me furnitorë apo zbatues punimesh, shërben si parandalues për shfaqjen e konfliktit të interesave në lidhje me përdorimin e fondeve publike.

Në mënyrë të përmbledhur, në "tabelën 1" janë pasqyruar disa momente të rëndësishme të mënyrës së zgjedhjes, organizimit dhe funksionimit të organeve të qeverisjes vendore që lidhen me rritjen e rolit të përfaqësimit të interesit publik në parandalimin e konfliktit të interesit.

Tabela 1
Rritja e rolit të përfaqësimit të interesit publik në parandalimin e konfliktit të interesit, në funksion të mënyrës së zgjedhjes, organizimit dhe funksionimit të organeve të qeverisjes vendore.

**"Tabela 1"**

| **Nr.** | **Fusha** | **Drejtime që lidhen me parandalimin e konfliktit të interesit** | **Cilat evidentohen si problemet bazë** | **Çfarë mund të bëhet për parandalimin e konfliktit të interesit** |
|---|---|---|---|---|
| I. | Mënyra e krijimit, organizimit dhe funksionimit të organeve të qeverisjes vendore (këshilli i bashkisë, komunës dhe qarkut si dhe kryetari i bashkisë, komunës dhe kryetari i kryesisë së këshillit të qarkut). | 1. Mënyra e zgjedhjes dhe krijimit të organit të zgjedhur.<br><br>2. Organizimi i brendshëm i këshillit.<br><br>3. Organizimi i ekzekutivit:<br>-Kryetari,<br>-zëvëndës/kryetar-i/ët, | - Pjesëmarrje e gjerë e qytetarëve në zgjedhje rrit besueshmërinë e përfaqësimit.<br>- Subjektet zgjedhore të përfshijnë kandidatët më të mirë, në lidhje me punën në shërbim të interesave publike.<br><br>-Zhvillimi korrekt i seancave plenare.<br>-Organizimi i komisioneve të këshillit.<br>-Krijimi i strukturave të tjera të ligjshme:<br>-Konsultimi.<br>-Zbatimi.<br><br>-Organizimi i strukturës administrative.<br>-Ndarja e qartë e detyrave për secilën njësi strukturore. | **-** Papajtueshmërinë e funksionit të këshilltarit me atë të kryetarit, zëvendës/ kryetarit të bashkisë/ komunës, të sekretarit të këshillit, të nëpunësit të administratës së bashkisë/ komunës përkatëse dhe me funksionin e deputetit.<br>- Nuk mund të jenë anëtarë në të njëjtin këshill persona që janë me njëri-tjetrin bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrri e vjehrra me nusen apo dhëndrin.<br>- Përjashtimi në procesin përgatitor të zyrtarëve në konflikt interesi ose të lidhur me persona në konflikt.<br>-Respektimi rigoroz i të gjitha përcaktimeve ligjore në organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale ashtu edhe ligje sektoriale sipas fushave të veprimtarisë që realizon këshilli.<br>- Miratimi i e statutit të njësisë vendore, hartimi, pasurimi i vazhdueshëm i rregullores së këshillit dhe të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -Administrata<br><br>4. Funksionimi i organeve të qeverisjes vendore. | Respektimi i normave ligjore për këshillin si dhe për ekzekutivin e qeverisjes vendore. P.sh:<br>-Përgatitja paraprake për zhvillimin e mbledhjes.<br>-Sigurimi i numrit të mjaftueshëm të anëtarëve të këshillit në shqyrtimin e çështjes.<br>-Shqyrtimi rigoroz i problemeve, mënyra e marrjes së vendimit, votimi.<br>-Dokumentimi i mbledhjes, përpunimi dhe publikimi i akteve, pas miratimit. | administratës, mbi këtë bazë, respektimi rigoroz i tyre.<br>-Këshillat e bashkive/ komunave dhe qarqeve, dhe organet ekzekutive në qeverisjen vendore të ndërtojnë gjithnjë e më mirë problematikën e punës së vet dhe institucioneve të tyre, duke përcaktuar sa më drejtë fushat prioritare.<br>- Organizimi ie veprimtarisë së organeve të qeverisjes vendore me programe zhvilluese dhe projekte konkrete të miratuara në mënyrë demokratike me një proces të gjerë konsultimi.<br>- Strukturat dhe organizmat që ndërton dhe organizon këshilli dhe ekzekutivi si komisionet, grupet e punës apo komitetet këshilluese, etj, të vihen gjithnjë e më mirë në rolin e tyre të përcaktuar me aktin e themelimit të tyre.<br>- Kontrolli në proces i veprimeve në zbatim të vendimeve.<br>- Transparencë me publikun dhe pjesëmarrje e komunitetit në qeverisje, para, gjatë dhe pas vendimmarrjes, me mënyra sa më të thjeshta e të qarta komunikimi. |

### 3.3 <u>Organet e qeverisjes vendore funksionet dhe kompetencat e tyre.</u>

Transferimi në pushtetin vendor i funksioneve publike me karakter vendor ashtu edhe i kompetencave për plotësimin e tyre në kuadër të decentralizimit kanë rritur rolin konkret të organeve të qeverisjes vendore në jetën publike. Si e tillë edhe fusha e konfliktit të interesave është zgjeruar, është bërë konkrete dhe më e mundshme.

*a. Decentralizimi i funksioneve publike vendore*

Organeve të qeverisjes vendore u janë transferuar në mënyra të ndryshme një gamë mjaft e gjerë e shërbimeve publike. Këto janë përcaktuar si fillim në VKM nr. 651, datë 29.12.1999 ”Strategjia e decentralizimit dhe autonomisë vendore” dhe pastaj janë përcaktuar në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”

- F**unksione ekskluzive (të veta) të pushtetit vendor**. Janë të gjitha ato fusha veprimtarie të jetës publike të cilat, duke pasur karakter thellësish vendor, i janë transferuar me të gjithë autoritetin qeverisës, organeve të qeverisjes vendore. Si të tilla përmendim shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, rrugët e brendshme (vendore), trotuaret dhe sheshet publike, transportin urban, ndriçimin publik, varrezat dhe shërbimin e funeralit, dekorin, parqet e lulishtet, pastrimin dhe largimin e mbeturinave, planifikimin urban, menaxhimin e tokës, strehimin, shërbimet sociale (çerdhet, azilet, etj), veprimtaritë dhe institucionet kulturore e sportive me karakter vendor, etj. Po ashtu këtu përfshihen edhe disa funksione që i shërbejnë zhvillimit ekonomik me karakter vendor si tregjet, mbështetja e biznesit, pyjet dhe kullotat, shërbimi veterinar, etj.

Në këto fusha pushteti vendor ka autoritet të plotë në ushtrimin e tyre dhe, si i tillë, përgjegjësia për përcaktimin dhe plotësimin e interesit publik është më e drejtpërdrejtë dhe e plotë. Në këto drejtime nevoja e parandalimit të konfliktit të interesave nga organet e qeverisjes vendore dhe administrata përkatëse duhet të jetë në qendër të vëmendjes në të gjithë problematikën planifikuese, zbatuese dhe kontrolluese nga ana e tyre.

- **Funksione të përbashkëta** janë ai grup funksionesh ku pushteti vendor ka një pjesë të përgjegjësisë, të ndarë nga përgjegjësia e pushtetit qendror. Si të tilla përmendim arsimin parauniversitar, shërbimin parësor shëndetësor, rendin publik dhe mbrojtjen civile, mbrojtjen e mjedisit, etj. Në këto raste përgjegjësia e pushtetit vendor është e pjesshme, vetëm në drejtimet e parashikuara nga legjislacioni sektorial. Për këtë edhe këndvështrimi i parandalimit të konfliktit të interesave lidhet kryesisht me rolin që kanë drejtpërdrejt organet e qeverisjes vendore, pa përjashtuar edhe ndikimin jo të drejtpërdrejtë që mund të marrin edhe për ushtrimin e rolit nga strukturat e pushtetit qendror.

- **Funksione të deleguara** janë një grup tjetër funksionesh që përbëjnë ato fusha veprimtarie të cilat, ndonëse janë në përgjegjësi të pushtetit qendror, me ligj ose me marrëveshje, caktohen të kryhen nga organet e qeverisjes vendore. Si të tilla përmendim shërbimin e gjendjes civile, ndihmën ekonomike për familjet në nevojë, etj. Në këto fusha roli qeverisës

është më i kufizuar megjithatë, mundësi për shfaqje të konfliktit të interesave nuk përjashtohen, sidomos në ato drejtime që janë objekt i punës së strukturave vendore si emërimi i personelit apo përcaktimi i përfitueseve, etj.

➢ Për të krijuar një ide më të gjerë për rolin konkret të pushtetit vendor në qeverisje të veprimtarisë publike, lind nevoja të shohim funksionet e tij të lidhura ngushtë me kompetencat që ai ka, me mundësinë, apo mjetet që i janë dhënë për t'i realizuar ato. Në kuadër të decentralizimit dhe autonomisë vendore është bërë e mundur që, për fushat e përmendura më sipër si funksione ekskluzive të pushtetit vendor, kompetencat të jenë të gjëra dhe të plota ndërsa, për funksione të përbashkëta dhe të deleguara, kompetencat kufizohen deri në nivelin e përcaktuar nga legjislacioni.

**b. Decentralizimi i kompetencave.**

Për të vlerësuar drejt rolin që marrin organet e qeverisjes vendore në funksionet publike vendore, kompetencat janë mjeti për plotësimin e misionit qeverisës.

Me shumë interes është të trajtojmë faktin se zgjerimi i transferimit të funksioneve në organet e qeverisjes vendore dhe rritja e kompetencave përkatëse në ushtrim të tyre, rrit mundësitë për rënien në konflikt interesi nga zyrtarët e qeverisjes vendore. Kjo sepse vendimmarrja, si dhe e gjithë praktika ekzekutive, krijon për organet e qeverisjes vendore mjaft hapësira për favorizime të pamerituara të individëve në konflikt interesi. E rëndësishme mbetet në këtë drejtim që e gjithë veprimtaria qeverisëse vendore të mos tejkalojë kufirin e përfitimeve publike dhe raporteve pozitive të përfitimit individual në kuadër të përfitimit publik. Çdo shmangie (gjë që është e mundshme) në përfitim individual, jashtë këtij ekuilibri, sidomos nga zyrtarë që janë aktorë në vendimmarrje, përbën një konflikt të pastër interesi dhe bën të domosdoshme marrjen e masave për parandalimin e tyre.

Për secilën nga fushat (funksionet), ashtu edhe për secilën kompetencë të qeverisjes vendore të paraqitur më sipër, mund të paraqiten shembuj të rasteve të konfliktit të interesave.

Kështu, konflikti i interesave dhe puna për parandalimin e tyre lidhet me natyrën e kompetencave. Mbi këtë bazë, në kontekstin e parandalimit të konfliktit të interesit në lidhje me veprimtarinë e përditshme, po trajtojmë më poshtë raste se çfarë duhet të kenë parasysh në mënyrë specifike organet e qeverisjes vendore dhe zyrtarët e tyre, për t'u orientuar gjatë ushtrimit të kompetencave, në kushtet e njësisë vendore përkatëse.

- **Kompetenca administrative,** është aftësia e organeve të qeverisjes vendore që, në mënyrë të pavarur, të vendosin për mënyrën e menaxhimit të shërbimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ato ngrenë dhe përmirësojnë strukturat administrative të veta, vendosin për emërimin, shkarkimin, kualifikimin e personelit, përcaktojnë pagat, krijojnë ndërmarrje të varësisë, si dhe vendosin për ushtrimin e funksioneve me të tretë.

Puna për parandalimin e konfliktit të interesave në kompetenca të këtij grupi është e gjerë.

Për ta ilustruar:

- Në punën me personelin, si emërimin apo shkarkimin e tyre, ka shumë terren për konflikt interesi që shfaqet me favore të pamerituara dhe që duhen parandaluar në mënyrë të paramenduar.

  Në këto kushte, duhen parandaluar: emërimi i një punonjësi në administratë kur është i lidhur me kryetarin, zëvendës/kryetarin e bashkisë/ komunës apo edhe anëtarë të këshillit;

- Në krijimin e ndërmarrjeve dhe sidomos në kontratat me të tretët, ka shumë mundësi për konflikt interesi.

  Si rast për të ilustruar një fenomen të tillë shërben lidhja e një kontrate shërbimi të bashkisë/ komunës apo këshillit të qarkut me një ndërmarrje që drejtohet nga persona të lidhur të kryetarit apo është anëtar këshilli etj.

- **Kompetencë investimi,** është autoriteti që kanë organet e qeverisjes vendore për planifikimin, shpërndarjen dhe realizimin e investimeve. Madje kjo e drejtë me ligje të veçantë i jepet atyre, si për funksione ekskluzive të tyre, ashtu edhe për funksione të përbashkëta dhe të deleguara.

- Në fushën e investimeve, të gjithë e dinë tanimë se sa kjo kompetencë mund të passjellë realizimin e favoreve dhe parandalimi i konfliktit të interesave përbën faktor shumë të rëndësishëm antikorrupsion.

  Ndër të tjera përmendim se duhen parandaluar rastet e realizimit të investimeve kur ndërmarrja zbatuese drejtohet nga persona të lidhur me drejtues të bashkisë/ komunës apo këshillit të qarkut apo edhe anëtarë të këshillave përkatës.

- **Kompetencë shërbimi** nënkupton aftësinë e organeve të qeverisjes vendore për planifikimin, shpërndarjen dhe realizimin e mirëmbajtjes së objekteve të shërbimit.

- Në kompetencat në fushën e shërbimeve, janë jo të pakta mundësitë për keqpërdorim të fondeve publike dhe përfitim të pamerituar për këto shërbime nga persona në konflikt interesi.

  Kështu, institucionalizimi i procedurave të hapura dhe të organizuara mirë i përfitueseve nga shërbimet publike bëhet faktori bazë për të shmangur raste të shërbimeve të diferencuara për persona të lidhur me zyrtarë me funksione vendimmarrëse me qëllim që të mos privilegjohet askush.

  Organizimi i shërbimeve publike me të tretë kërkon që të respektohen të gjitha procedurat për caktimin e subjektit që do të realizojë ato me qëllim që të mos favorizohen subjekte të caktuara por edhe të mos spekulohet me fonde publike në proces të zbatimit të shërbimeve publike.

- **Kompetencë rregullatore** është aftësia e organeve të qeverisjes vendore për krijimin dhe vendosjen e rregullave (dhënie liçensash, caktim orari pune dhe shërbimi, vendosje gjobash, dhe në përgjithësi dhënie të drejtash dhe caktim detyrash).

- Në kompetencat rregullatore mjafton të kujtojmë shembuj të tillë si diferencimi që mund të bëhet në dhënien e liçensave, në vendosjen e gjobave etj, për të kuptuar nevojën e masave për parandalimin e konfliktit të interesave.

Në tabelën 2 janë paraqitur disa drejtime të mundshme të punës për parandalimin e konfliktit të interesave në lidhje me plotësimin e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave konkrete nga ana e organeve dhe zyrtarëve në njësitë e qeverisjes vendore**.**

Tabela 2

Roli konkret (aktiv) i organeve të qeverisjes vendore (këshilli dhe kryetari) dhe drejtime për parandalimin e konfliktit të interesave.

**"Tabela 2"**

| Nr. | Funksione të pushtetit vendor | Kompetenca në ushtrim të funksioneve | Drejtime të mundshme të punës për parandalimin e konfliktit të interesave |
|---|---|---|---|
| I. | **1. Funksione të veta:**<br>**a**. Shërbime publike: shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, rrugët vendore, trotuaret dhe sheshet publike, transporti urban, ndriçimi publik, varrezat dhe shërbimi i funeralit, dekori, parqet e lulishtet, pastrimi dhe largimi i mbeturinave, planifikimi urban, menaxhimi i tokës, strehimi.<br>**b.** Shërbimet sociale (çerdhet, azilet, etj), veprimtaritë dhe institucionet kulturore e sportive me karakter vendor, etj.<br>**c.**Funksione që i shërbejnë zhvillimit ekonomik me karakter vendor si tregjet, mbështetja e biznesit, pyjet dhe kullotat, shërbimi veterinar, etj. | **1. Kompetenca administrative:**<br>Aftësia e organeve të qeverisjes vendore që në mënyrë të pavarur të vendosin për mënyrën e menaxhimit të shërbimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br>**Ato:**<br>- ngrenë dhe përmirësojnë strukturat administrative të veta, për numrin e personelit;<br>- miratojnë statutin dhe rregulloret e veta, të administratës dhe aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe personave juridik që krijon vetë ose është bashkëthemelues;<br>- vendosin emërimin shkarkimin, kualifikimin e personelit;<br>- përcaktojnë pagat dhe mënyrat e shpërblimit;<br>- krijojnë ndërmarrje të varësisë,<br>- vendosin për ushtrimin e funksioneve me të tretë. | - Në hartimin e rregulloreve (të këshillit, të administratës, të ndërmarrjeve dhe institucioneve që krijojnë) të përcaktohen qartë masat dhe veprimet për parandalimin e konfliktit të interesit.<br><br>- Në rast të përcaktimit të strukturave organizative e numrit të personelit dhe përmirësimit të tyre, mos të priren me paramendim nga interesa favorizuese për persona të veçantë dhe në konflikt interesi.<br><br>- Emërimi i personelit, në të gjitha mënyrat që do të aplikohet nga ana e organeve kompetente në qeverisjen vendore, kërkohet të marrë në konsideratë detyrimet ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, si mosmarrja në punë e personave në konflikt ose të lidhur, përjashtimi i zyrtarëve në konflikt nga komisionet, etj.<br><br>- Në fushën e caktimit të pagave dhe shpërblimeve, shmangia e favoreve, rast pas rasti, për personat e lidhur.<br><br>- Përcaktimi i kryerjes së shërbimeve publike me të tretë nuk duhet lejuar të bëhet me shoqëri që drejtohen nga persona të lidhur në konflikt interesi. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **2. Funksione të përbashkëta me pushtetin qendror:**<br>- arsimin parauniversitar,<br>- shërbimi parësor shëndetësor,<br>- rendi publik,<br>- mbrojtja civile,<br>- mbrojtja e mjedisit, etj.<br><br>3. **Funksione të deleguara:**<br>-shërbimi i gjendjes civile,<br>-ndihma ekonomike për familjet në nevojë,<br>-mobilizimi ushtarak. | **2. Kompetencë investimi:**<br><br>Autoriteti që kanë organet e qeverisjes vendore për:<br>-planifikimin,<br>shpërndarjen,<br>-realizimin<br>e investimeve që i jepet me ligj atyre për ushtrimin e funksioneve ekskluzive ashtu edhe për funksione të përbashkëta dhe të deleguara.<br><br>**3. Kompetencë shërbimi**<br>Aftësia e organeve të qeverisjes vendore për:<br>- planifikimin,<br>-shpërndarjen,<br>-realizimin<br>e mirëmbajtjes së objekteve dhe shërbimeve ndihmëse.<br><br>**4. Kompetencë rregullatore**<br>Aftësia e organeve të qeverisjes vendore për krijimin dhe vendosjen e rregullave në:<br>-dhënie leje e licensa,<br>-caktim orari pune dhe shërbimi,<br>- vendosje gjobash,<br>-në përgjithësi dhënie të drejtash dhe caktim detyrash. | - Planifikimi i fondeve për investime, me vendimmarrje në respektim të ligjeve, programeve dhe me transparencë me publikun.<br><br>- Respektimi i kërkesave ligjore të parandalimit të konfliktit të interesave në rastin e prokurimit të fondeve për investime publike. Përjashtimi nga komisionet i zyrtarëve në konflikt, përjashtimi nga ofertat i shoqërive që drejtohen nga persona në konflikt interesi etj.<br><br>- Ushtrimi i kontrollit, supervizimi, aktkolaudimet etj. të realizimit të investimeve dhe shërbimeve publike të mos kryhen nga persona në konflikt interesi me drejtuesit e shoqërive realizuese të investimeve.<br><br>- Angazhimi i shoqërive sipërmarrëse në shërbime publike të bëhet me procedura të rregullta konkurimi, me prokurim të fondeve në respektim të dispozitave për parandalimin e konfliktit të interesit.<br><br>- Dhënia e lejeve dhe licensave - të respektohen dispozitat e përgjithshme dhe ato specifike, përfshi edhe detyrimet për parandalimin e konfliktit të interesit.<br><br>- Çdo rast i dhënies së të drejtave dhe i caktimit të detyrave nga eprorët të respektohen dispozitat e parandalimit të konfliktit të interesit si dhe nga zyrtari të respektohet parimi i shmangies dhe deklarimit vullnetar të konfliktit. |

## 3.4. <u>Transparenca e pjesëmarrja e publikut në qeverisje dhe parandalimi i konfliktit të interesave.</u>

Njohja dhe menaxhimi i interesave publike nga ana e njësive të qeverisjes vendore kërkon kurdoherë të zhvillohet një proces krejtësisht transparent dhe me pjesëmarrje të publikut.

Transparenca dhe pjesëmarrja e publikut përbëjnë një detyrim ligjor, si kërkesë e Kushtetutës, Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore dhe më tej i konkretizuar në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Neni 35 i ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 përcakton si domosdoshmëri zhvillimin e seancave të këshillimit me bashkësitë vendore para vendimmarrjes për probleme të tilla të kompetencës së këshillit si: miratimi i buxhetit, mënyrat e përdorimit të pronës apo në rastet e tjetërsimit të objekteve të veçanta të saj, në fushën e taksave, si dhe standardeve për nivelin e shërbimeve publike etj. Ndërkohë ligji, po në këtë nen përcakton detyrimin për informimin e publikut në përputhje me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", për të cilat vetë këshilli ka detyrimin dhe mundësinë të aplikojë mënyra dhe procedura sipas kushteve të tyre specifike.

Transparenca dhe pjesëmarrja e komunitetit kërkohen nga vetë banorët. Janë ato që janë drejtpërdrejt të interesuar që në veprimtarinë e organeve të zgjedhura, të shohin përfaqësim dhe pasqyrim real të kërkesave të tyre në nivel vendor.

- **Pjesëmarrja e komunitetit të realizohet në dy forma**:

- Si pjesëmarrje <u>pasive</u> e publikut, me anë të së cilës pjesëmarrësit vetëm sa njihen me zhvillimin e proceseve qeverisëse. Si të tilla përmendim: publikimi i vendimeve, pjesëmarrje në mbledhje të organeve të zgjedhura apo në takime informative kur ato janë vetëm dëgjues, informimet e publikut nëpërmjet medias, anketimet për gjendjen, etj.

- Si pjesëmarrje <u>aktive</u> e publikut, ku komuniteti, kontribuon në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që shërbejnë për menaxhimin më të mirë të veprimtarisë publike. Si të tilla përmendim: diskutime dhe tërheqje mendimi për projekt/vendime për probleme të ndryshme në lidhje me funksionet qeverisëse, ballafaqime publike për veprimtarinë e realizuar në menaxhimin e veprimtarisë publike; analiza raportuese para publikut, sidomos në paraqitjen e konkluzioneve pas monitorimit apo kontrolleve të organizuara nga organizma të posaçme; krijimi i grupeve të punës për formulimin e qëndrimeve të komunitetit etj.

- Disa nga **drejtimet kryesore** ku kërkohet transparencë dhe pjesëmarrje e publikut për një qeverisje në plotësim të interesave të komunitetit dhe si parandalues të konfliktit të interesave mund të jenë:

- Hartimi i programeve të zhvillimit në përgjithësi apo programeve të veçanta e sektoriale.
- Analiza për nivelin e plotësimit të shërbimeve.

- Menaxhimi financiar,  e përdorimi i fondeve publike.
- Menaxhimi i pronave publike.

- **Transparenca dhe pjesëmarrja e komunitetit** në qeverisje, në shërbim të parandalimit të konfliktit të interesave, **kërkon**:

  - Përfshirje në proces të të gjitha shtresave të interesuara të banorëve.
  - Aktiviteti me pjesëmarrjen e komunitetit të jetë i organizuar në funksion dhe me optikë të qartë të problemit për zgjidhje.
  - Trajtim i kujdesshëm i mendimeve ndryshe.

- **Mënyrat për të siguruar transparencën dhe pjesëmarrjen** ***e qytetarëve***.

a. Me komunikim të drejtpërdrejtë me publikun.

b. Tërheqje mendimi me anketime apo pyetsorë, për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të caktuara.
c. **Referendumet** përbëjnë një nga mënyrat më demokratike dhe gjithëpërfshirëse për formulimin e mendimeve të komunitetit.
b**.** Me **grupe përfaqësues** të komunitetit.
ç. **Me strukturat e përhershme** që krijohen pranë organeve të qeverisjes vendore apo pranë institucioneve të ndryshme në shërbimin përkatës.

Të tilla përmendim "komitetet për planin apo për buxhetin" pranë këshillit të bashkisë, komunës apo qarkut, "bordi i shkollës", "këshilli i rregullimit të territorit", "komisionet e prokurimit", etj.  Organizmave të tilla mund t'u besohen kompetenca  të mirëfillta ose ato do të shërbejnë për të finalizuar opinionin qytetar përpara vendimmarrjes.

**d.  Media dhe interneti** përbën një nga mjetet më aktive të komunikimit me publikun.

Media duhet të përdoret me vëmendje të veçantë pasi ajo shërben:

- Si mjet informacioni.
- Për rol aktiv në komunikimin me qytetarët.

Transparenca dhe pjesëmarrja e publikut në qeverisje, për të gjitha organet e zgjedhura dhe administratën e qeverisjes vendore, mbetet një nga drejtimet shumë të rëndësishme të veprimtarisë së tyre, në veçanti të para në këndvështrimin e konfliktit të interesave. Kjo duhet të jetë e programuar nga këshilli i bashkisë/ komunës apo qarkut por edhe si detyrim i kryetarit të bashkisë/ komunës apo kryesisë së këshillit të qarkut dhe administratës përkatëse. Megjithatë, në bashki/ komunë apo në këshillin e qarkut, mund dhe duhet të funksionojnë zyra të veçanta për komunikimin me publikun të cilat, krahas detyrave për plotësimin e kërkesave ndaj qytetarëve dhe subjekteve të veçanta, duhet të jenë të angazhuara me detyra konkrete në plotësim të detyrave që u dalin organeve të qeverisjes vendore në këtë fushë, të përmendura më sipër në mënyrë shumë të përmbledhur.

## Kapitulli IV
## 4. KONFLIKTI I INTERESIT NË NIVEL VENDOR

### 4.1 Aspekte të përgjithshme të ligjit

Ligji nr. 9367 datë 7.04.2005, trajton çështjet e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Në këtë kontekst edhe njësitë e pushtetit vendor dhe çdo lloj institucioni, enti apo ndërmarrje/shoqëri në varësi të këtyre njësive, gjendet nën zbatimin e këtij ligji.

Për nga vetë mënyra e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor në Shqipëri, ne zbatimin e ligjit janë evidentuar probleme të caktuara në nivelin vendor. Në këtë kuptim, vështirësi do të konsiderojmë organizimin e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive në njësitë e qeverisjes vendore (NJQV-të) të cilat duke qenë edhe organe direkt të zgjedhura dhe për rrjedhojë edhe autonome, gëzojnë pavarësi në vendimmarrjen e tyre. Kjo strukturë organizimi e komplikon mbikqyrjen dhe identifikimin e rasteve të konfliktit të interesave, pasi nuk ekzistojnë organe eprore në kuptimin e hierarkisë administrative, të cilat bëjnë këtë detyrë por duhet të jenë vetë këto organe të pushtetit vendor (kryetarët dhe këshillat e NJQV-ve) të cilat duhet të parandalojnë vetë rënien në konflikt interesi dhe eventualisht zgjidhjen e tyre. Konkretisht duhet pasur në vëmendje se në njësitë e pushtetit vendor veprojnë në mënyrë autonome organet e zgjedhura vendimmarrëse dhe ekzekutive përkatësisht:

- Këshillat e qarqeve, bashkive dhe komunave;
- Kryetarët/ kryesia e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive dhe komunave;

Pavarësisht sa më sipër, duhet pasur parasysh që parandalimi i konfliktit të interesave është detyrim ligjor dhe këto organe, duke ruajtur pavarësinë e tyre, janë të detyruara të parandalojnë konfliktet e interesit dhe të marrin masat e nevojshme për zbatimin e ligjit jo vetëm prej tyre por edhe nga administratat përkatëse dhe institucionet e varësisë.

Objekti i këtij kapitulli të manualit është shpjegimi në mënyrën më të qartë të mundshme të ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" në drejtim të zbatimit të tij në nivelin e pushtetit vendor, kryesisht drejt:

- Kuptimit të "zyrtarit" dhe vendimmarrjes së tij në nivelin vendor;
- konfliktit të interesave dhe llojet e tij;
- aspektet e veçanta të konfliktit të interesave sipas rasteve specifike në nivelin vendor.

### 4.2 Zyrtari dhe vendimmarrja në kushtet e konfliktit të interesit në nivelin vendor

Parimi i përgjithshëm është detyrimi që çdo zyrtar i çdo fushe, funksioni dhe niveli duhet t'i kryejë detyrat dhe përgjegjësitë publike në mënyrë të drejtë pa u ndikuar nga konfliktet e interesit dhe të shmangë vetë rënien e tij në konflikt interesi të çdo lloji. Më specifikisht këtë parim e sanksionon neni 6, pika 1 e ligjit nr. 9367, dt. 7.4.2005 që parashikon:

*“Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit”.*

Këtij parimi i bashkëlidhet dhe detyrimi që çdo zyrtar tjetër, epror apo institucion epror dhe çdo institucion publik të kryejë, në mënyrë aktive, detyrat e ngarkuara nga ky ligj dhe çdo ligj tjetër për parandalimin e konfliktit të interesit. Neni 6, pika 2 e ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005, rregullon:

*“Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit”.*

“Zyrtari” është një koncept bazë i cili përdoret nga Ligji mbi parandalimin e konfliktit të interesave kur përcakton fushën dhe objektin e zbatimit të këtij ligji. Në këtë kuptim, me termin zyrtar ligji i referohet një kategorie të gjerë personash/ zyrtarësh që nga nivelet më të ulëta të administratës publike deri tek Presidenti i Republikës.

Në këtë këndvështrim dhe bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9367, ky ligj do të zbatohet nga:

a. çdo *zyrtar*, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për:

i) akte dhe kontrata administrative;
ii) akte të organeve gjyqësore, noteriale, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga organet e përmbarimit dhe akte të organeve të prokurorisë;
iii) akte normative, si dhe vetëm ato ligje që krijojnë pasoja juridike për subjekte individualisht të përcaktuara;

b. çdo *zyrtar* i institucioneve shtetërore, qendrore ose vendore dhe çdo punonjës i subjekteve të përcaktuara në shkronjën "d" ose përfaqësues i subjekteve të përcaktuara në shkronjën "ç", në subjektet e përmendura në shkronjën "d", kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte;
c) çdo *zyrtar ose punonjës*, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, në njërën nga subjektet e shkronjës "ç" ose "d" të pikës 1 të këtij neni;
ç) çdo institucion shtetëror, qendror ose *vendor;*
d) çdo organ apo subjekt i krijuar dhe/ose në varësi të subjekteve të shkronjës "ç", përfshirë edhe ndërmarrjet shtetërore ose vendore, shoqëritë tregtare me pjesëmarrje kontrolluese të kapitalit shtetëror ose vendor, organizatat jofitimprurëse dhe persona të tjerë juridikë, të kontrolluar nga subjektet e shkronjës "ç" ose nga vetë subjektet e kësaj shkronje;
dh) personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.

Për sa më sipër detyrimi për të zbatuar këtë ligj parashikon një rreth të gjerë personash që nuk kufizohen vetëm tek zyrtari por edhe tek “personat e lidhur” me zyrtarin, në vartësi të përcaktimeve dhe kufizimeve të këtij ligji apo ligjeve të tjera. Zbatimi i këtij ligji ështs shtrirë në shkallë të gjerë, pra jo vetëm tek zyrtarët e çfarëdolloj kategorie apo niveli.

Në mënyrë më konkrete mund të themi që ky ligj gjen zbatim në nivelin vendor në bashki, komunë dhe qark, përkatësisht:

1. <u>Në nivelin vendor në bashki:</u>

- kryetari i bashkisë;
- nën/kryetari i bashkisë;
- anëtarët e këshillit të bashkisë;
- zyrtarët e të gjitha niveleve të administratës së bashkisë dhe institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve/ shoqërive në varësi të tyre;
- personat e lidhur me kategoritë e mësipërme, sipas dispozitave specifike (neni 24 dhe neni 35) të ligjit më specifikisht ata janë bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es.

2. <u>Në nivelin vendor në komunë</u>:

- kryetari i komunës;
- nën/kryetari i komunës;
- anëtarët e këshillit të komunës;
- zyrtarët e të gjitha niveleve të administratës së komunës dhe institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve/shoqërive në varësi të tyre;
- Personat e lidhur me kategoritë e mësipërme, sipas dispozitave specifike (neni 24 dhe neni 35) të ligjit më specifikisht ata janë bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es.

3. <u>Në nivelin vendor në qark:</u>

- kryetari i këshillit të qarkut;
- nën/kryetari i këshillit të qarkut;
- anëtarët e këshillit të qarkut;
- zyrtarët e të gjitha niveleve të administratës së Qarkut dhe institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve/shoqërive në varësi të tyre;
- personat e lidhur me kategoritë e mësipërme, sipas dispozitave specifike (neni 24 dhe neni 35) të ligjit më specifikisht ata janë bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es.

Po kështu ligji ka specifikuar në mënyrë të detajuar edhe llojet e interesave private që mund të ndikojnë në vendimmarrjen përkatëse duke shkaktuar konflikt të interesit. Këto interesa private të cilat ligji i specifikon në nenin 5 janë:
a) Të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen apo për çdo marrëdhënie me interesa private për zyrtarin;
d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
dh) marrëdhënie familjare apo të bashkëjetesës, të komunitetit, etnike, fetare, të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
e) angazhime të mëparshme me burim interesash të mësipërme.

Parimi i kufizimit më të rreptë do të zbatohet kur për të njëjtën çështje gjejnë zbatim dy apo më shumë dispozita ligjore që trajtojnë këtë çështje, parë në këndvështrimin e konfliktit të interesit dhe trajtimi bëhet sipas "rreptësisë" në kufizimet e parashikuara.

### 4.3 Konflikti i interesave dhe llojet e tij

"Konflikti i interesave" përkufizohet, në nenin 3, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 9367 dt. 7.4.2005, si *konflikti ndërmjet detyrës publike dhe interesave private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të një zyrtari*.

Përkufizimi si më sipër, është përkufizimi i përgjithshëm i konfliktit të interesave i cili në ligj zbërthehet në disa lloje të tij, përkatësisht në konfliktin *faktik*, *në dukje* dhe *i mundshëm* i interesit si dhe *konflikti rast për rast* dhe *konflikti i vazhdueshëm*.

Tre llojet e para të konfliktit të interesit, pra *faktik, në dukje* dhe *i mundshëm*, do të veçohen nga ligji nën këndvështrimin e rolit në *efektin* që kanë pasur, kanë ose mund të kenë interesat private në vendimmarrje. Pra si më sipër do të dallojmë rezultatin e interesit në vendimmarrje që, do të thotë se, në rastin e *konfliktit faktik* interesi ka ndikuar në vendimmarrje, duke e cenuar atë dhe duke e bërë kështu në parim të pavlefshëm. Ndërsa në rastin e *konfliktit në dukje*, interesi megjithëse në dukje duket sikur ka ndodhur, ndodh apo mund të ndodhë, në rezultat, pra materialisht nuk ka ndodhur, nuk ndodh dhe nuk ka mundësi të ndodhë (neni 3 pika 4 shkronja b).

Për sa i përket *konfliktit të mundshëm* të interesit, ajo presupozon një hipotezë që në të ardhmen kryerja e detyrave apo përgjegjësive të caktuara *mund* të shkaktojnë në të ardhmen konflikt faktik ose në dukje, por kjo mbetet për tu shqyrtuar sipas rrethanave përkatëse të çështjes dhe në raport me dy llojet e tjera të konfliktit të interesit, atij rast për rast ose të vazhdueshëm.

Ndërkohë, ligji bën dallimin e dy formave të tjera të shfaqjes së konfliktit, përkatësisht konfliktit rast për rast dhe atij të vazhdueshëm. Bazuar në përkufizimin e ligjit, këto dy lloje konflikti kanë të bëjnë më tepër me dinamikën e shfaqjes së konfliktit të interesit, ku në konfliktin rast për rast do të kemi të bëjmë me shfaqjen e konfliktit të interesit vetëm në raport me *një* vendimmarrje të caktuar, ndërsa konflikti i vazhdueshëm lidhet me përsëritjen

në mënyrë të përsëritur ose të shpeshtë të konfliktit të interesit në të ardhmen, si pasojë e kryerjes së detyrave të caktuara.

Pra nga sa më sipër, dallojmë që ligji bën një ndërthurje midis tyre, të llojeve të konfliktit të interesit (sipas mënyrës së shfaqjes dhe efektit), që do të thotë që konflikti rast për rast mund të shfaqet i ndërthurur me një nga tre llojet e konfliktit përkatësisht atij faktik, në dukje ose të mundshëm, ndërsa konflikti i vazhdueshëm mund të shfaqet vetëm në formën e konfliktit faktik dhe atij të mundshëm. Juridikisht pra ligji mbulon shfaqjen dhe gjendjen e konfliktit të interesit në të gjitha "momentet" dhe "efektet" e saj në raport me vendimmarrjen.

Më poshtë paraqitet ndërthurja e llojeve të konfliktit të interesit në tabelë për tu kuptuar më mirë:

| **Efekti në vendimmarrje** / **Shfaqja e konfliktit të interesit** | **Konflikti rast për rast** (është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mëposhtme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë). | **Konflikti i vazhdueshëm** (është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ ose të shpeshtë në të ardhmen). |
|---|---|---|
| **Konflikti Faktik** (interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare). | Konflikti **faktik** e **rast për rast** i interesit. **(Neni 3, pika 4/a)** | |
| **Konflikti në dukje** (interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë). | Konflikti **në dukje** e **rast për rast** i interesit. **(Neni 3, pika 4/b)** | |

| | | |
|---|---|---|
| **Konflikti i mundshëm**<br>(interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara). | Konflikti **i mundshëm** e **rast për rast** i interesit (**faktik ose në dukje**), në lidhje me një **çështje në të ardhmen (Neni 3, 4/c).** | Konflikti **i mundshëm** e **i vazhdueshëm** i interesit.<br><br>**(Neni 3, pika 4/d)** |

*Shembuj ilustrues të konfliktit faktik, në dukje dhe të mundshëm të interesit*

**a) "Konflikt faktik i interesit"**

Konflikti faktik ilustrohet me shembullin si më poshtë:

*Shembull 1*

Gruaja e kryetarit të bashkisë Z, duke qenë në cilësinë e ortakes së vetme (zotërueses së pjesëve të kapitalit) të shoqërisë X sh.p.k. ka lidhur një kontratë qiraje për shfrytëzimin e një ambienti publik në pronësi të bashkisë në të cilën i shoqi, kryen funksionin e kryetarit të bashkisë. Kontrata e qerasë është lidhur me shoqërinë X sh.p.k pas një procesi konkurrimi të hapur publik ku edhe kompani të tjera morën pjesë, por kompania me pronare gruan e kryetarit paraqiti ofertën më të mirë ekonomike.

*Pyetje për diskutim*

A kemi konflikt interesi në këtë rast? A është e vlefshme kontrata e lidhur, megjithëse e lidhur pas një konkurrimi të hapur publik?

Në këtë rast gjendemi para një *konflikti faktik* të interesit (rast për rast) pasi, sipas pikës 2 të nenit 21 të ligjit Nr. 9637 dt. 7.4.2005, është absolutisht e ndaluar lidhja e kontratave midis zyrtarëve të specifikuar në këtë nen përkatësisht kryetari i bashkisë, komunës, këshillit të qarkut; anëtarët e këshillave të bashkisë, komunës, qarkut, si dhe zyrtarët e lartë në bashki, komunë apo qark) dhe personave të lidhur me ta siç parashikohen në nenin 24, si bashkëshorti/ja, fëmijët madhore dhe prindërit e zyrtarit apo të bashkëshortes. Pra pavarësisht se kontrata e qerasë është lidhur pas një procesi të hapur konkurrimi publik, kjo rrethanë nuk ndikon në gjykimin e kësaj si të lidhur në kushtet e konfliktit faktik të interesit.

*Mënyra e zgjidhjes:*

Kjo kontratë është lidhur në kushtet e konfliktit faktik të interesit dhe duhet të merren sanksionet përkatëse sipas nenit 44 në vijim të Ligjit Nr. 9367 dt. 7.4.2005. Gjykimi mbi vlefshmërinë e kontratës do të bëhet sipas analizës së hapave metodologjikë(për më tepër shiko kapitullin 5.5) dhe përcaktimeve të nenit 40 të ligjit Nr. 9367 dt. 7.4.2005.

Rasti i përmendur më sipër është praktikisht një rast lehtësisht i identifikueshëm nga fakti i ekzistencës së ndalimit absolut të parashikuar në nenin 21 pika 2, por në praktikë gjendemi para rasteve të ndryshme shumë më të komplikuar ku identifikimi, nëse kemi të bëjmë me një konflikt faktik të interesit, është më i vështirë dhe kësisoj, analiza e rastit duhet të jetë më komplekse, parë jo vetëm në këndvështrimin e ligjit nr. 9367, datë. 7.4.2005, por edhe me ligje të tjera.

**b) "Konflikt në dukje i interesit"**

Konflikti në dukje i interesit pasqyrohet në shembullin më poshtë:

*Shembull 2*

Kryetari i bashkisë Y, është njëkohësisht dhe kryetar i KRRT-së, si dhe personi i vetëm që mund të nënshkruajë lejet e ndërtimit. KRRT-ja shqyrton kërkesën e vëllait të kryetarit të bashkisë, për dhënie leje ndërtimi të një pallati banimi, në truallin pronë e trashëguar e kryetarit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij.

Pyetja: A është kryetari i bashkisë në konflikt interesi në rast se nënshkruan lejen e ndërtimit, të dhënë për vëllain e tij?

*Përgjigje*:

Leja e ndërtimit do të shqyrtohet (do të jepet ose jo) nga KRRT-ja, e cila është organ kolegjial. Në këtë organ kolegjial kryetari i bashkisë ka vetëm një votë. Megjithatë, për të shmangur konfliktin rast pas rasti të interesit, kryetari i bashkisë duhet të shmanget nga vendimmarrja për dhënien e lejes së ndërtimit.

Përsa i përket nënshkrimit të lejes së ndërtimit, kryetari i bashkisë nuk është në konflikti interesi, pasi pika 6 e nenit 37 të ligjit parashikon se:

*"Zyrtari lejohet të ushtrojë funksion dhe të kryejë detyrën me kusht që konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:*

*a) kur ai është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve:*

*b) dhe kur:*
   *i) nuk është i mundur as tjetërsimi i interesit privat, ...për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);*

   *ii) nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, ai të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni.*

*Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga institucionet e ngarkuara me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.*"

**c) "Konflikt i mundshëm i interesit"**

Rasti për ilustrimin e "konfliktit të mundshëm të interesit" paraqitet si më poshtë:

*Shembull 3*

Firma e pastrimit të qytetit BETA sh.p.k. ka një kontratë 5 vjeçare me bashkinë X. Pronar i firmës BETA sh.p.k është djali i një nga punonjësve të bashkisë, i cili është specialist në sektorin e ankesave të publikut që merret me protokollimin e ankesave dhe jo shqyrtimin e tyre. Në këtë pozicion pune babai nuk ka pasur asnjë rol në procesin e tenderimit të kontratës së pastrimit.

*Pyetje për diskutim:*

A ka konflikt interesi midis punonjësit dhe firmës së pastrimit BETA sh.p.k. ?

Në rastin e mësipërm punonjësi i bashkisë ka interesa private tek firma BETA sh.p.k. duke qenë se pronar është djali i tij (person i lidhur sipas nenit 24). Megjithatë në analizën e rastit vërejmë që specialisti i bashkisë nuk hyn në kategorinë e zyrtarëve të lartë sipas nenit 21/2 dhe për rrjedhojë nuk gjendemi para *ndalimit absolut* të parashikuar në këtë nen. Në këtë rast, duke qenë se zyrtari është i nivelit të ulët atëherë gjendemi para ndalimit relativ sipas nenit 21/3 i cili parashikon plotësimin e dy kushteve specifike, përkatësisht zyrtari duhet të ketë kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrje si dhe duhet të ketë interes privat sipas nenit 37 të Kodit të Procedurës Administrative dhe nenit 709 të Kodit Civil. Nën këtë këndvështrim vërejmë se zyrtari nuk ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen për kontratën e fituar nga firma e djalit të tij pra nuk plotësohet njëri nga kushtet e nenit 21/3 por nëse punonjësit do ti caktoheshin detyra apo përgjegjësi të caktuara në të ardhmen si p.sh. ajo e shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave për cilësinë e shërbimeve publike dmth. edhe të shërbimit të pastrimit (babai është specialist në sektorin e ankesave) etj, atëherë plotësohen kushtet për rënie në *konflikt të mundshëm* interesi bazuar në përkufizimin ligjor sipas nenit 3 pika 4 shkronja c):
*"konflikt i mundshëm i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara".*

Mënyra e zgjidhjes:

Duke qenë se kemi të bëjmë me një konflikt të mundshëm interesi, është detyrë e vetë zyrtarit, të deklarojë këtë interes privat, në mënyrë që të parandalohet konflikti. Parandalimi i konfliktit të interesit në këtë rast bëhet duke zbatuar një nga zgjidhjet e nenit 37 dhe 38 të ligjit Nr. 9367 dt. 7.4.2005 p.sh. ose duke u vetpërjashtuar nga vendimmarrja konkrete ose duke mos i caktuar këtij zyrtari detyra apo përgjegjësi si ato të përmendura më sipër.

*Shembuj ilustrues të konfliktit të interesit rast për rast dhe të vazhdueshëm në çështje dhe raste të veçanta*

Përveç specifikimit të llojeve të konfliktit të interesave nga ligji, duke i dalluar ato në "efektin" e tyre si më sipër, ligji nr. 9367, datë. 7.4.2005 dallon edhe dy forma shfaqjeje të konfliktit të interesave por duke veçuar "dinamikën" e shfaqjes së konfliktit përkatësisht të "konfliktit rast për rast të interesit" dhe "konfliktit të vazhdueshëm të interesit" në çështje dhe raste të veçanta.

1. Ligji 9367, datë 7.4.2005 e përkufizon "konfliktin rast për rast të interesit" si gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme të konfliktit, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;

*Shembull 4*

Firma ABC sh.p.k. ku pronar është vëllai i kryetarit të bashkisë Y, vazhdimisht merr pjesë në tenderat publike të organizuar nga institucionet publike. Bashkia Y ka organizuar tender për ndërtimin e rrugës Z,e cila është fituar nga firma ABC sh.p.k. me pronar vëllain e Kryetarit të Bashkisë.

Pyetje për diskutim:

A përbën konflikt interesi pjesëmarrja e firmës ABC sh.p.k. në tenderat publike? Po pjesëmarrja në tender në Bashkinë Y, ku vëllai është kryetar bashkie? Ç`lloj konflikti paraqet rasti i fitimit të tenderit të rrugës në Bashkinë Y?

Analiza në këtë rast do të bëhet e lidhur vetëm me këtë çështje d.m.th. vetëm me këtë tender dhe jo për rastet e tjera të tenderave ku kjo firmë ka marrë pjesë dhe ka fituar kontrata publike me institucione të tjera.

Pjesëmarrja në tender në bashkinë Y, ku vëllai i pronarit është kryetar i bashkisë është e palejueshme dhe KVO-ja duhet ta përjashtonte firmën ABC sh.pk. nga pjesmarrja në tender për shkak të konfliktit të interesit.
Në rastin kur firma ABC ka marrë pjesë dhe fiton tenderin e rrugës në bashkinë Y do të gjendeshim para një konflikti interesi faktik *rast për rast për çështje të veçantë ,pasi kryetari i bashkisë është titullar dhe ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese si dhe* vëllai është person i lidhur me kryetarin e bashkisë Y, sipas nenit 37 të Kodit të Procedurës Administrative dhe kështu plotësohen njëkohësisht të dy kushtet e kërkuara të nenit 21 pika 3 të ligjit PKI.

Mënyra e zgjidhjes:

Kontrata e lidhur për tenderin e rrugës me Bashkinë Y është kontratë e lidhur në kushtet e konfliktit faktik të interesit dhe duhet të merren sanksionet përkatëse sipas nenit 44 në vijim

të Ligjit Nr. 9367 dt. 7.4.2005. Gjykimi mbi pavlefshmërinë e kontratës do të bëhet sipas analizës së hapave metodologjikë(për më tepër shiko kapitullin 5.5) dhe përcaktimeve të nenit 40 të ligjit Nr. 9367 dt. 7.4.2005.

2. Për "konfliktin e vazhdueshëm të interesit" ligji e përkufizon gjendjen në të cilën, konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

Shembulli i mëposhtëm ilustron këtë lloj të shfaqjes së konfliktit të interesit.

*Shembulli 5*

Zyrtari X zgjidhet si kryetar i qarkut Y. Në administratën e qarkut Y ka qenë i punësuar dhe vazhdon të jetë i punësuar si drejtor në sektorin e zhvillimit rajonal vjehrri i zyrtarit X.

Pyetje për diskutim:

A gjendemi përballë një konflikti interesi në këtë rast ?

Në rastin e mësipërm nuk kemi të bëjmë me një *konflikt faktik interesi rast për rast*, pasi vjehrri i zyrtarit X ka qenë punonjës i qarkut para se zyrtari X të zgjidhej si kryetar i qarkut, pra, zyrtari nuk ka ndikuar në lidhjen e kontratës së punësimit. Nga analiza e këtij rasti bazuar edhe ne hapat metodologjike (shih kapitullin 5.5) konkludojmë se ushtrimi i detyrave nga ana e kryetarit të qarkut në vazhdimësi do të mund të ndikohej nga fakti që vjehrri i tij ka lidhje familjare me të (është edhe person i lidhur sipas nenit 24 dhe 35 të ligjit për PKI) dhe mund të gjendemi para trajtimeve preferenciale apo interesave të tjera. Ne këtë kontekst shfaqja e konflikti faktik ose të paktën në dukje është e pashmangshme dhe kur këto mund të shfaqen në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen nisur edhe nga fakti që vjehrri është zyrtar i lartë në administratën e qarkut dhe ka epror të drejtpërdrejt dhe lidhje të drejtpërdrejtë hierarkike me kryetarin e qarkut, dhëndrin e tij, ky konflikt do të përbënte një konflikt te vazhdueshëm të interesit.

Mënyra e zgjidhjes:

Për të shmangur konfliktin e vazhdueshëm të interesit, Kryetarit të Qarkut, do t'i sugjerohej zgjdhja me mirëkuptim që vjehrri i tij të transferohej në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel por ku lidhja hierarkike të mos ishte e drejtpërdrejtë me kryetarin e qarkut, p.sh. në të njëjtin rang, por një institucion tjetër, duke u bazuar në nenin 37 pika 4/d e ligjit PKI. Transferimi i vjehrrit në një detyrë tjetër duhet të bëhet me pranimin dhe miratimin e këtij të fundit pasi duke qenë nëpunës civil, ligji për nëpunësit civil e mbron atë nga transferimet e detyruara.

Pra, mund të përmbledhim se në konfliktin e interesit rast për rast, dinamika e shfaqjes së konfliktit ka të bëjë me konfliktin e interesit vetëm për "një" vendimmarrje të veçantë, pra në mënyrë sasiore vetëm për një çështje, kjo sipas tre llojeve të konfliktit, atij faktit, në dukje

apo të mundshëm. Ndërsa për konfliktin e vazhdueshëm dinamika e shfaqjes së konfliktit konsiston në përsëritjen ose shpeshtësinë në të ardhmen por edhe si papajtueshmëri funksionale si më poshtë.

Përveç sa më sipër, Ligji 9367/2005 ka specifikuar disa situata juridike në të cilat ndalohet konflikti rast për rast dhe i vazhdueshëm i interesit. Në kreun III të ligjit kemi ndalime specifike për kategori të ndryshme zyrtarësh midis të tjerëve edhe për zyrtarët në nivelin vendor. E rëndësishme është të theksohet që në kreun III ligji bën dallimin midis dy llojeve të konfliktit të interesit, atij rast për rast dhe të vazhdueshëm, sipas ndalimit absolut që ju drejtohet jo vetëm zyrtarëve por edhe personave të lidhur me ta.

Për një sqarim sa më të mirë duhet thënë që seksioni 2 i kreut të III të ligjit PKI, i cili flet për kufizimin e interesave private për raste të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave ka të bëjë me konceptin e “papajtueshmërisë” funksionale d.m.th. që kufizimi i interesave në këndvështrimin e ligjit ju bëhet zyrtarëve të caktuar (neni 27-33 i ligjit PKI) jo për shkak të përfshirjes së tyre në ndonjë vendimmarrje konkrete, por për shkak të kryerjes së një funksioni të caktuar. Neni 29 i referohet specifikisht ndalimit (papajtueshmërisë funksionale) kategorisë së zyrtarëve vendorë.

Për ti ilustruar më mirë çka u tha më sipër, po përdorim skemën e mëposhtme:

**Konflikti i interesit**
**në çështje dhe raste të veçanta**
(Kreu III i ligjit nr. 9367 dt. 7.4.2005)

**Konflikti rast për rast**
**për çështje të veçanta**

1. **Neni 21/2** - Ndalimi i lidhjes së kontratave nga zyrtarët vendore (kryetarët, anëtarët e këshillave dhe zyrtarët e nivelit të lartë drejtues).
2. **Neni 24** – Personat e lidhur me zyrtarët në zbatim të nenit 21/2.
3. **Neni 21/3** – Ndalimi për zyrtarët e të gjitha niveleve.
4. **Neni 22** – Ndalimi i të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë.
5. **Neni 23** - Ndalimi i dhuratave.

**Konflikti i vazhdueshëm**
**për raste të veçanta**

1. **Neni 29** – Kufizimet për kryetarin e këshillit të qarkut, bashkisë, komunës.
2. **Neni 35 -** Personat e lidhur me zyrtarin në zbatim të nenit 29.
3. **Neni 38/1/c** –transferimi i zotërimit aktiv të aksioneve tek personi i besuar, (në rast se nuk gjendet zgjidhja sipas nenit 37).

Më poshtë po i trajtojmë me hollësi të dyja ndalimet sipas kategorive përkatëse për zyrtarët në nivelin vendor sipas përcaktimit të kreut III të ligjit 9367 dt. 7.4.2005/2005 për nga vetë rëndësia që ato paraqesin. Duhet të kihen parasysh ndalimet dhe kufizimet e konfliktit të interesave sipas dy llojeve të mësipërme dhe dallimit që i bën atyre ligji, pasi identifikimi dhe trajtimi juridik i secilës prej tyre ndryshon në disa detaje.

Në fillim le të trajtojmë konfliktin e interesit rast për rast ashtu siç trajtohet në nenin 21 të ligjit 9367 dt. 7.4.2005/2005. Neni 21 i ligjit *parashikon ndalimin absolut të lidhjes së kontratave* midis individit nga njëra anë dhe institucionit publik nga ana tjetër, në rastin kur ky individ është një nga zyrtarët e specifikuar në seksionin 2 të kreut III të ligjit (p.sh. kryetari i qarkut, i bashkisë, komunës etj.) ose edhe me shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri të thjeshtë, ku këta zyrtarë zotërojnë, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasie.

Neni 21/1:

*"Asnjë individ nuk mund të lidhë kontratë me asnjë institucion publik, kur ky individ njehsohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, ose me asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri të thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasie.*

Neni 21/1 si më sipër ka të bëjë në fakt me juridiksionin "lëndor" pra ndalimi i kontratave si koncept i përgjithshëm absolut. Nga ky koncept i juridiksionit lëndor (neni 21/1) kemi disa përjashtime, të cilat p.sh. i përkasin kufizimit të ndalimit të kontratave vetëm në juridiksionin tokësor/territorial, kjo në rastin e pushtetit vendor.

Përjashtohen nga zbatimi i kësaj dispozite:
*a) zyrtarët e nivelit të mesëm a të ulët drejtues, specialistët, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit;*
*b) zyrtarët e njësive të qeverisjes vendore, të cilët, për këtë ndalim, trajtohen sipas pikës 2 të këtij neni".*

Rasti i mësipërm i ilustruar në tabelë do të jepej si poshtë:



Ndërsa kufizimi për ndalimin e lidhjes së kontratave si më sipër, për kategorinë e zyrtarëve vendore është një ndalim më specifik dhe trajtohet nga pika 2 e nenit 21 të ligjit nr. 9367, datë. 7.4.2005/2005, si më poshtë:

Neni 21/2:
*"Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nën/kryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, sipas interpretimit të këtij termi në ligjet përkatëse, ndalimi, sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie".*

Nga sa më sipër shikojmë se rrethi i zyrtarëve sipas këtij neni që kanë ndalim për lidhjen e kontratave me këshillin e qarkut, bashkinë dhe komunën si dhe me institucionet e varësisë së tyre (kufizimi në juridiksionin territorial) ndahet në 3 kategori:

1. **Personat e zgjedhur** ( kryetari i bashkisë, kryetari i komunës, kryetari i këshillit të qarkut si dhe anëtarët e këshillave bashkiak, komunal dhe të qarkut).

2. **Personat e emëruar** (nën/kryetari i bashkisë, nën/kryetari i komunës, nën/kryetari i këshillit të qarkut).

3. **Zyrtarët e nivelit të lartë drejtues** (këtu futen zyrtarët e administratës sipas përcaktimit të ligjeve përkatëse, d.m.th. të ligjit për statusin e nëpunësit civil, i cili gjen zbatim në administratën e bashkisë dhe qarkut, ndërsa administrata e komunës trajtohet sipas Kodit të Punës. Përkatësisht në bashki dhe qark zyrtarë të nivelit të lartë drejtues do të jenë duke filluar nga drejtorët e përgjithësh dhe funksionet e njehsuara me to e duke vazhduar sipër në hierarkinë administrative.

Ndërsa në administratat e komunës, zyrtarë të lartë drejtues do të konsiderohen zyrtarët që janë më lartë në hierarkinë drejtuese të administratës së komunës, por duke qenë se nëpunësit e komunës nuk klasifikohen sipas statusit të nëpunësit civil, atëherë do të merren në konsideratë ligje të tjera. Nga analiza që i bëjmë legjislacionit nuk ekziston ndonjë ligj specifik që t'i referohet klasifikimit të hierarkisë së nëpunësve të komunës por megjithatë një referencë mund të gjejmë tek VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", ku si zyrtarë të lartë mund të përcaktohen nëpunësit që për efekt page klasifikohen në kategorinë më të lartë.

Momenti i dytë që duhet të kemi në vëmendje është që ndalimi për lidhjen e kontratave ju përket zyrtarëve vendorë vetëm në rast se kontratat lidhen me *bashkinë, komunën ose qarkun përkatës ku zyrtarët kryejnë funksionin.*

Për ta ilustruar mund të themi që p.sh. kryetari i komunës X, nuk mund të lidhë asnjë kontratë me komunën apo institucionet në varësi të komunës ku ai është kryetar, por mund ta bëjë këtë p.sh. me komunën apo bashkinë fqinjë, por jo me këshillin e qarkut pasi kryetari i komunës, sipas ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, është njëkohësisht edhe anëtar i këshillit të qarkut, gjë që e fut atë në rrethin e zyrtarëve sipas nenit 21/2 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.

## 4.4 <u>Personi i lidhur me zyrtarin sipas nenit 24</u>

Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 i shtrin efektet e tij jo vetëm në kategoritë e zyrtarëve por edhe tek personat e lidhur me ta, në kuptim që këta persona trajtohen nga ligji njëlloj sikur të jetë vetë zyrtari dhe si i tillë edhe ndalimet dhe kufizimet përkatëse do t'i prekin edhe këta persona të lidhur me zyrtarin.

Në varësi të llojit të konfliktit të interesit ndryshon edhe rrethi i personave të lidhur me zyrtarin.

Për nenin 21/2 si persona të lidhur me zyrtarin (edhe me zyrtarët vendorë) do të konsiderohen personat e përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, si më poshtë:

Neni 24/1,
*"Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 pikat 1, 2 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga <u>bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es</u>".*

## 4.5 <u>Ndalimi për lidhjen e kontratave për të gjithë zyrtarët (Neni 21/3)</u>

Ligjvënësi për këtë kategori zyrtarësh (neni 21/3) nuk ka vënë një ndalim absolut të lidhjes së kontratave por nuk i ka lënë ata jashtë fokusit të ligjit, pasi në nenin 21/3 ligji thotë:

*Pavarësisht përcaktimeve të bëra në pikat l e 2 të këtij neni (neni 21), ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet një institucioni publik apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë dhe një individi, personi fizik a juridik apo ndonjë formë tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:*

- *a) zyrtari, që ushtron funksionet në këtë institucion publik ka <u>kompetencë thelbësore</u> dhe <u>përcaktuese</u> në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës;*
- *b) ky zyrtar ka <u>një interes privat,</u> sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative, apo të nenit 709 të Kodit Civil, ose ka një interes të llojit të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij neni.*

Pra, shikojmë që ndalimi në këtë rast i takon momenteve kur zyrtari, pavarësisht funksionit të tij, duke u nisur që nga më i ulëti deri tek nivelet e sipërme, në rast se kanë kompetencë

thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen përkatëse që synon arritjen e finalizimit të kontratave apo akteve administrative që të çojnë tek lidhja e kontratave, atëherë ato janë subjekt i këtij ligji dhe ndalimit, si të gjithë zyrtarët e tjerë të përmendur specifikisht.

Edhe në këtë rast do të duhet të specifikojmë se ç'kuptohet me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese. Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, në shkronjën "c" të pikës 2, të nenit 4, e përcakton kompetencën thelbësore dhe përcaktuese si më poshtë:

*"një zyrtar'" ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit".*

Edhe ILDKP-ja, në Udhëzimin Nr. 239, datë 02.02.2006 [7] përcakton kompetencën thelbësore dhe përcaktuese kur zyrtari me pjesëmarrjen dhe qëndrimin e tij që mund të vijë si rrjedhojë e rolit të tij si urdhërues, propozues, këshillues të projekt/akteve administrative apo projekt/kontratave marrin karakter përcaktues për vendimmarrjen për aktin, pavarësisht pjesëmarrjes ose jo të tij në aktin final të vendimmarrjes.

P.sh. një specialist i njësisë së prokurimit në bashki pavarësisht se nuk merr pjesë në vendimmarrjen për përcaktimin e ofertuesit fitues në prokurimin publik (detyrë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) ai mund të ketë rol thelbësor dhe përcaktues në momentin e hartimit të specifikimeve teknike të tenderit apo dokumenteve të tenderit që është detyrë e njësisë së prokurimit, pra si rrjedhojë do të trajtohet sipas ndalimit të nenit 21 pika 3 shkronja a) e ligjit.

Pavarësisht sa më sipër në këndvështrimin e nenit 21 pika 3 (shkronja a dhe b) duhet që, përveç kompetencës thelbësore dhe përcaktuese (shkronja a) duhet të plotësohet njëkohësisht edhe kushti i shkronjës b) d.m.th. që zyrtari të ketë një interes privat sipas nenit 37 të Kodit të Procedurës Administrative apo të nenit 709 të Kodit Civil, ose ka një interes të llojit të përcaktuar në pikat 1 e 2 të nenit 21. Pra, shikohet që pavarësisht ndalimit të kontratave sipas nenit 21 pika 2, që i përket vetëm një lloj kategorie të zyrtarëve vendorë, pika 3 e këtij neni e zgjeron kategorinë e zyrtarëve pothuajse me të gjitha nivelet e zyrtarëve por sipas kushteve të përcaktuara (kompetenca thelbësore e përcaktuese dhe interesi privat).

Neni 37 i Kodit të Procedurës Administrative shprehet si më poshtë:

*"Asnjë punonjës i organeve të administratës nuk mund të marrë pjesë në një proces vendimmarrës administrativ apo në një lidhje kontrate ku administrata që ai përfaqëson është palë në rastet kur punonjësi ka ose/dhe dyshohet të ketë kushtet e mëposhtme:*

*a) Ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;*
*b) bashkëshorti apo bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes direkt apo indirekt në çështjen në fjalë".*

[7] "Komentari ligjor Nr.3" ILDKP, qershor 2006.

Nga sa më sipër shikojmë që ligji i referohet interesit personal (interesit privat) që mund të jetë direkt ose indirekt. Në fakt, nuk kemi një shtjellim të saktë në Kod se ç'kuptojmë me interesin direkt dhe atë indirekt, por në këndvështrimin e ligjit nr. 9367, datë 07.4.2005, mund të bëjmë analogji me llojet e konfliktit të interesit konkretisht atij faktik dhe në dukje.

Neni 37 e shtrin rrethin e personave të lidhur deri në "shkallë të dytë" të lidhjes së gjakut, pra është më i gjerë se përcaktimi i personave të lidhur sipas ligjit të PKI-së.

P.sh. a kemi të bëjmë me një konflikt interesi kur vëllai i zyrtarit AB në komunën X, i cili është specialist inxhinier në njësinë e prokurimit, do të marrë pjesë në tenderin e rrugës së shpallur nga komuna X ?

Në këtë rast dallojmë që zyrtari ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, pra plotëson një nga kushtet, ndërsa vlerësimi për konfliktin e interesit në lidhje me vëllain, nëse e bëjmë vlerësimin sipas nenit 24 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, nuk do të ishim në gjendjen e konfliktit të interesit pasi vëllai në këtë kontekst nuk futet tek rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, por që nën këndvështrimin e nenit 37 të Kodit të Procedurës Administrative ne gjendemi para konfliktit të interesit (interesit personal direkt) pasi vëllai hyn në rrethin e të afërmve të shkallës së dytë.

Ndërkohë neni 709 i Kodit Civil, pavarësisht se parashikohet si kusht që duhet të plotësohet njëkohësisht me nenin 37 të Kodit të Procedurës Administrative, nuk gjen zbatim në rastin e zyrtarëve vendore pasi ky nen shprehimisht i referohet ndalimit për zyrtarët që janë ngarkuar për administrimin e pronave që vihen në ankand, ku specifikisht neni 709 thotë:

*"Nuk mund të blejnë drejtpërdrejt, me anë të një tjetri, ose në ankand:*

*a) personat që administrojnë ose ruajnë sende të huaja në bazë të ligjit ose të emërimit nga shteti, sendet që administrojnë ose ruajnë;*
*b) personat zyrtarë që janë të ngarkuar të bëjnë shitje me ekzekutim të detyrueshëm, sendet që këta shesin;*
*c) gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit, noterët dhe avokatët, sendet për të cilat ka grindje; përpara gjykatës në të cilën bëjnë pjesë ose ushtrojnë funksionet e tyre, përveç kur këta janë bashkëpronarë mbi ato".*

*Përjashtimi nga ndalimi i lidhjes së kontratave (neni 21 pika 4)*

Ndalimi i lidhjes së kontratës sipas pikës 1dhe 2 të nenit 21 megjithëse është një ndalim i natyrës absolute parë në këndvështrimin për pasojat që sjell (pavlefshmërinë absolute të kontratave) si dhe në shtririjen e gjerë si për rrethin e zyrtarëve ashtu edhe për objektin/kontratat që zbatohet, do të ishte shumë penalizues dhe mund të sillte ndikimin e kundërt me atë që synon ligji të arrijë nëse nuk do të kishte edhe disa përjashtime. Në lidhje me vlerësimin nëse një kontratë e lidhur në kushtet e konfliktit të interesit do të jetë absolutisht e pavlefshme, sipas kuptimit të Kodit të Procedurave Administrative, duhet pasur gjithmonë në vëmendje rasti specifik dhe analiza e detajuar e tij. Në kapitullin 5.5 trajtohet

gjerësisht çështja e pavlefshmërisë së akteve dhe kontratave të lidhura në kushtet e konfliktit të interesit.

Në këtë kuptim, vetë ligji në pikën 4 të nenit 21 bën përjashtim nga ndalimi i lidhjes së kontratave duke veçuar disa lloje kontratash që lejohen për t'u lidhur dhe nuk konsiderohen si të lidhura në konflikt interesi.

P.sh. kontratat që kanë të bëjnë me punësimin e vetë zyrtarit janë kontrata që përjashtohen nga ndalimi i lidhjes së tyre sipas nenit 21 të ligjit. Më specifikisht pika 4 e nenit 21 shprehet:

*" Nga ndalimet e pikave l, 2 dhe 3 të këtij neni përjashtohen rastet kur lidhja e kontratës:*

*a) ka të bëjë me punësimin e vetë zyrtarit në institucion publik ose me statusin e tij ligjor;*
*b) ka të bëjë me marrjen nga zyrtari të një shërbimi, që ofrohet nga institucioni publik ose organizmat dhe subjektet e krijuara nën kontrollin e institucionit publik, kur këto shërbime janë të parashikuara në objektin e veprimtarisë së institucionit publik, si dhe me kushtin që shërbimi nuk i jepet zyrtarit në mënyrë favorizuese apo si trajtim preferencial në raport me të tjerët;*
*c) bazohet në ligje të veçanta, për qëllime publike, ose për trajtime të posaçme të kategorive të ndryshme të zyrtarëve;*
*ç) është e domosdoshme për kryerjen e funksionit publik dhe nuk ka alternativë tjetër;*
*d) ka të bëjë me një dhuratë, favor ose trajtim preferencial, në çdo rast pa kundërshpërblim, që subjektet e përcaktuara në pikën l shkronjat "a" dhe "b" dhe në pikën 2 të këtij neni, bëjnë në favor të një institucioni publik".*

Për sa më sipër vlen të mbahet gjithmonë në vëmendje kjo pikë e këtij neni kur të merren në analizë çështje të mundshme të konfliktit të interesave në lidhje me kontratat. Kjo pasi ndalimi i lidhjes së kontratave është një ndalim i natyrës absolute dhe nëse verifikohet dhe provohet se kontratat janë lidhur me konflikt interesi atëherë ato nuk prodhojnë asnjë pasojë juridike pra janë absolutisht të pavlefshme dhe si të tilla të gjitha pasojat që mund të kenë ardhur nga zbatimi i këtyre kontratave do të konsiderohen si të paqena pra *nul,* dhe për këtë gjithmonë duhet verifikuar nëse kemi të bëjmë me rast përjashtimor të parashikuar nga neni 21 pika 4.

### 4.6 <u>Ndalimi i sigurimit të të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë (neni 22 i ligjit nr.9367, datë. 7.4.2005)</u>

Përveç ndalimeve si më sipër, ligji 9367 dt. 7.4.2005/2005, për konfliktin e interesit rast për rast parashikon edhe ndalimet sipas nenit 22, i cili parashikon:

- *ndalimin e të ardhurave nga zotërimi aktiv i aksioneve apo pjesëve në kapital të shoqërive tregtare, apo çdo lloj përfitimi tjetër, kur këto shoqëri kanë përjashtime apo lehtësira doganore apo tatimore, apo veprojnë në zonat e lira, kur zyrtari ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen për dhënien e këtyre trajtimeve preferenciale për shoqëritë* (neni 22 pika 1).

- *për zyrtarin (neni 22 pika 2), që është përfaqësues i një institucioni publik në zotërimin e aksioneve ose të pjesëve në kapital të shoqërive tregtare, gjatë ushtrimit të këtij funksioni i ndalohet:*

    *a) marrja drejtpërdrejt ose tërthorazi, me ndërmjetësimin e palëve të treta, e çdo përfitimi financiar, përfshirë krijimin e një burimi të ardhshëm financiar, që lidhet ose përftohet për shkak të detyrës së tij si përfaqësues;*
    *b) pranimi, në favor të tij, i dhuratave ose pjesëve në kapital nga shoqëria, anëtarët ose organet e saj;*
    *c) blerja e pjesëve në kapital, aksioneve ose pasurive të këtyre shoqërive;*
    *ç) përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga furnizues apo klientë të këtyre shoqërive.*

Ndalimi sipas (nenit 22 pika 2) ka rëndësi të veçantë për pushtetin vendor duke marrë parasysh që njësive të qeverisjes vendore (NJQV-të) në thellimin e procesit të decentralizimit ju kanë kaluar ose kanë krijuar ndërmarrje/shoqëri tregtare ku ato kanë caktuar përfaqësuesit e tyre. Më e dukshme kjo bëhet në rastin p.sh. të përfaqësuesve të njësive të qeverisjes vendore në Këshillat Mbikëqyrës të Ndërmarrjeve të Ujësjellësave dhe në Asamblenë e Aksionerëve. Ndalimi i parashikuar në këtë rast për të ardhurat që lidhen me funksionin e veçantë të përfaqësuesit të NJQV-së është i natyrës absolute, pasi deformimi i përfaqësimit për shkak të përfitimeve cenon rëndë interesat e NJQV-ve në këto ndërmarrje.

Prandaj, këshillat e njësive vendore sipas rastit të bashkisë, komunës dhe qarkut, duhet të jenë shumë të kujdesshme në këtë drejtim dhe të shmangin sa më shumë emërimin e personave në të tilla institucione që janë apo mund të bien në konflikt interesi.

## 4.7. Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale (neni 23)

Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 trajton marrjen e dhuratave, favoreve, premtimeve apo trajtimeve preferenciale si raste të veçantë të konfliktit rast për rast të interesave që duhen parandaluar dhe shmangur efektivisht.

Parimi kryesor në nenin 23 është ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve apo trajtimeve preferenciale si rregull por që vetë ligji lejon disa raste specifike të përjashtimit nga ky rregull.

Pika 1 e nenit 23 parashikon që: *"Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji".*

Pika 2 e nenit 23 parashikon që: *"Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare".*

Ndalimi me natyrë të përgjithshme i takon edhe zyrtarëve të nivelit vendor pa asnjë lloj përjashtimi.

Veçoria e këtij neni është tek rrethi i <u>personave të lidhur</u> me zyrtarin që në krahasim me situatat e tjera të përcaktuara nga ky ligj është shumë më i gjerë. Konkretisht pika 2 e nenit 24 parashikon shprehimisht se:

*"Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të nenit 23 të këtij ligji, përveç atyre të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, zgjerohet edhe me çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim".*

Pra sa më sipër person i lidhur me zyrtarin nuk është vetëm bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es por edhe çdo person fizik ose juridik që luan rolin e ndërmjetësit.

<u>Deklarimi dhe identifikimi i interesave privatë</u>

Në rastin e konfliktit rast për rast të interesit, <u>interesat privatë</u> të <u>çdo</u> zyrtari duhet të vetëdeklarohen detyrimisht në mënyrë paraprake, atëherë kur dyshohet se këto interesa mund të ndikojnë vendimmarrjen. Pra, vetëdeklarimi është <u>rast për rast</u> vetëm kur dyshohet se interesat privatë mund të ndikojnë një vendimmarrje <u>të caktuar.</u>

### 4.8 <u>Konflikti i vazhdueshëm i interesit për raste të veçanta</u>

Siç u tha më sipër, ligji përqendrohet dhe trajton në veçanti dy llojet e konfliktit të interesit: atij rast për rast dhe të vazhdueshëm, si dhe mënyrat përkatëse të deklarimit të interesave sipas këtyre dy lloj konfliktesh interesash.

Në këtë pjesë do të trajtojmë konfliktin e vazhdueshëm të interesit sipas përcaktimit që bën ligji në Kreun e III, seksionin e 2 nga neni 27 deri në nenin 33. Në këtë seksion ligji bën ndalime specifike të interesave private që mund të jenë burim i mundshëm i konfliktit të vazhdueshëm të interesave. Në këtë aspekt ligji dallon disa kategori të caktuara zyrtarësh të cilët ju referohen ndalimet specifike.

Në interesin e këtij manuali hyn kategoria e zyrtarëve vendore që për sa më sipër trajtohen specifikisht nga neni 29 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.

Neni 29 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, shprehet se:

*"Kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut:*

*a) nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të tij;*

*b) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër".*

Në radhë të parë, bazuar në dispozitën e mësipërme shikojmë që kufizimit specifik sipas këtij neni i nënshtrohen vetëm kryetarët e bashkive, komunave dhe këshillave të qarkut, pra një rreth i kufizuar i zyrtarëve vendorë, në krahasim me pikën 2 të nenit 21, ku ndalimeve të përcaktuara në atë nen ju nënshtrohen edhe anëtarët e këshillave, nën/kryetarët, zyrtarët e lartë.

Së dyti, kufizimet e parashikuara ne nenin 29 te ligjit nuk lidhen me konflikte interesi me ndonjë vendimmarrje përkatëse (konflikti rast për rast) por janë kufizime të interesave që mund të çojnë në lindjen e konfliktit të vazhdueshëm (papajtueshmëria funksionale).

Së treti, analizojmë që kufizimet në shkronjën "a" të nenit 29, i referohen atyre situatave kur kryetarit të bashkisë, komunës apo qarkut ju ndalohet të jenë drejtues apo anëtarë të organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse brenda territorit të juridiksionit.

Në këtë kuptim duhen analizuar me radhë:

1. Qenia drejtues ose anëtar i organeve drejtuese. Me këtë nënkuptohet p.sh. që kryetarët s`mund të jenë administratorë ose anëtarë të bordeve drejtuese të shoqërive tregtare, por mund të jenë aksionerë ose ortakë në shoqëritë tregtare, pasi këto atribute në kuptimin e ligjit për shoqëritë tregtare nuk janë atributet e drejtuesit apo anëtarit të organit drejtues. Pra nënkuptojmë që kryetarët mund të zotërojnë aksione apo pjesë në kapitalin e shoqërive tregtare, pavarësisht juridiksionit ku e kryejnë veprimtarinë këto firma.

2. Së dyti bazuar në analizën juridike themi që kryetarët e bashkive, komunave dhe qarqeve mund të jenë përkatësisht edhe drejtues apo anëtarë të organeve drejtuese të shoqërive tregtare por vetëm me kushtin nëse shoqëritë e kryejnë veprimtarinë jashtë sferës së juridiksionit territorial të njësisë vendore ku kryetari kryen funksionet e tij si kryetar. Por këtu duhet të analizojmë nëse këto detyra, si drejtues apo anëtar i organit drejtues të organizatës fitimprurëse, janë me kohë të plotë apo të pjesshme, pasi sipas shkronjës "b" të nenit 29, kryetarëve nuk ju lejohet të jenë të punësuar diku tjetër përveç funksionit që kryejnë me kohë të plotë, pra mund të jenë të punësuar vetëm me kohë të pjesshme.

Po kështu, kufizimi i tretë i cili parashikohet për kryetarët e bashkive, komunave dhe këshillave të qarqeve në shkronjën "b" të nenit 29, është më specifik dhe ndalon të ardhurat e

krijuara nga qenia person fizik tregtar, ortakëri personash, profesionet e lira etj, si dhe ndalon punësimin me kohë të plotë në detyra të tjera.

Personi i lidhur me zyrtarin

Sipas parimit që ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin janë të njëjta edhe për personat e lidhur me të, për kategorinë e zyrtarëve vendorë të përcaktuar si më sipër në nenin 29 të ligjit 9367 dt. 7.4.2005/2005, për sa i përket personave të lidhur me ta specifikimi i tyre bëhet në nenin 35 pika 2, i cili në këtë rast, si persona të lidhur, konsideron:

*"bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es".*

Edhe në këtë rast rrethi i personave të lidhur është i njëjtë me rrethin e personave sipas nenit 24 (personat e lidhur në konfliktin rast për rast).

Megjithatë neni 35 pika 4 për personat e lidhur me zyrtarët e kategorive të specifikuara që nga neni 27 deri tek neni 33, parashikon disa kufizime të veçanta shprehimisht:

*"Personi i lidhur me një zyrtar nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike. përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohen të paktën një nga kushtet e mëposhtme:*
*a) mjeti i vetëm, me të cilin ky zyrtar mund të krijojë efektet e mësipërme, është një ligj ose një vendim i këshillit të bashkisë, komunës ose qarkut ose një vendim gjyqësor;*
*b) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin prej 10 milionë lekësh".*

Veçoria që paraqitet për personat e lidhur (neni 35) në rastin e zyrtarëve vendore sipas nenit 29 të ligjit PKI, është se neni 29 shkronja a) trajton ndalime për vetë zyrtarin dhe që lidhen me papajtueshmërinë funksionale, pra që lidhen me funksionin që zyrtari kryen dhe nuk shtrihen tek personat e lidhur. Pra, në këtë kuptim personat e lidhur nuk preken nga kufizimet për zyrtarët vendorë sipas nenit 29 shkronja, që do të thotë se bashkëshorti/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es mund të jenë *drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse*.

## 4.9 ***Raste konkrete të konfliktit të interesave sipas funksioneve të caktuara të pushtetit vendor***

**Rasti Nr 1[8].**

[8] Në rastin Nr. 1 është perdorur metodologjia e plotë sesi duhet te analizohet dhe trajtohet një cështje në drejtim të konfliktit të interesit, bazuar edhe në manualet e tjera të ILDKP-së. Në rastet e tjera të analizuara në këtë manual, per shkaqe objektive dhe për të qënë sa më konçiz, trajtimi i rasteve është bërë në mënyrë më të shkurtuar.

Subjekti ndërtues “Alb-Co” me përfaqësues dhe ortak të vetëm E.N, ka paraqitur kërkesën për miratimin e lejes për shesh ndërtimi në KRRT e Bashkisë M.

Anëtari R.N. i KRRT-së së e Bashkisë M (organ kolegjal i përberë prej 9 anëtarësh nga të cilët 7 janë të emëruar nga Këshilli i Bashkisë, një nga Ministri i linjës dhe Kryetari i Bashkisë) është bashkëshorti i ortakut te vetëm të shoqërisë BN. Ai merr pjesë në shqyrtimin e projektit te paraqitur nga subjekti ndërtues BN, i cili voton pro projektit dhe leja e ndërtimit miratohet nga KRRT e Bashkisë M.

**Çështje për tu diskutuar në lidhje me rastin:**

1- A përbën konflikt interesi pjesëmarrja në votim e anëtarit të KRRT së Bashkisë?
2- Nëse po, cilat janë mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes në rastin kur zyrtari
    a. Merr pjesë në votim
    b. Kur abstenon

3- Cilat janë masat që duhet të marre ILDKP, si Autoriteti Qendror Përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005?

**Analiza e rastit:**
Detyrimi për të parandaluar konfliktin e interesave në sektorin publik gjen zbatim për çdo fushë të vendimmarrjes publike dhe vepron mbi çdo zyrtar që kryen detyra dhe ka përgjegjësi që materializohen në një produkt vendimmarrjeje. Detyrimi ligjor përbën një urdhërim për institucionet publike dhe zyrtarët, si dhe vepron mbi çdo person të lidhur me një zyrtar.

Ligji nr. 9367, datë 07.04.2009 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”,* e kërkon përgjegjësinë dhe zbatimin e tij drejtpërdrejt nga vet zyrtari kur ka një interes privat që bie ndesh me funksionin e tij publik në një vendimmarrje të caktuar.

Nga ana tjetër, zyrtari jo vetëm që ka detyrimin të parandalojë dhe zgjidhë vetë çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit, por gjithashtu, ka përgjegjësinë dhe detyrimin të deklarojë interesat e tij private, që mund të bien ndesh me ushtrimin e detyrave të tij publike.

Me qëllim garantimin e një vendimmarrje të paanshme në administratën publike, në nenin 37 të Kodit të Procedurave Administrative janë parashikuar rastet e skualifikimit për punonjësit e organeve të administratës të marrin pjesë në një proces vendimmarrës administrativ.

Në rastin konkret, jemi para përcaktimeve të pikës 1, gërma “a” dhe “b”, në kuptim të së cilës, anëtari i KRRT që ka një interes direkt ose indirekt në çështjen në fjalë, ose kur bashkëshorti apo bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes direkt ose indirekt në çështjen në fjalë, duhet të shmangen nga vendimmarrja.

Gjithashtu, në pikën 4 të nenit 5 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 përcaktohen qartë llojet e interesave private që mund të vlerësohen si shkak për lindjen e një konflikti interesi, të tilla si: (a) të drejtat dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre; (b)çdo marrëdhënie tjeter juridiko-

civile; (c) **marrëdhënie familjare apo të bashkëjetesës**, të komunitetit, etnike, fetare, të njohura të miqësisë apo të armiqësisë...etj.

Duke qenë se çdo zyrtar ka detyrimin ligjor të parandalojë dhe të shmangë vetë çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit, anëtari i KRRT, me qëllim shmangien e konfliktit të interesave duhej t'i referohej mënyrave bazë për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, të parashikuara në nenin 37 ligji nr. 9367, datë 07.04.2005. Në zbatim të pikës b të këtij neni ai duhej të vetpërjashtohej nga procesi konkret i vendimmarrjes dhe të mos merrte pjesë gjatë shqyrtimit dhe votimit të kërkesës së subjektit ndërtues "Alb-Co".

**Si do të trajtohej rasti kur anëtari i KRRT abstenon në votimin e kërkesës së subjektit ndërtues "Alb-Co?**

KRRT e Bashkisë M është një organ kolegjial. Në nenin 13 pika 3 e ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" parashikohet se:

"*Ata anëtarë të organit kolegjial që kanë pengesë ligjore nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe votimit*". Pra, në rastin e një vendimmarrje të një organi kolegjial, ku zyrtari/anëtari i këtij organi, detyrohet nga ligji të zgjidhë konfliktin e interesit duke u vetpërjashtuar paraprakisht nga kjo vendimmarrje për shkak të interesave të tij private, abstenimi në votim nuk e zgjidh konfliktin e interesit.

**Mënyra e zgjidhjes:**
Në përfundim të analizës së mësipërme, anëtari i KRRT duhej të vetdeklaronte interesin e tij privat lidhur çështjen konkrete. Ai duhej të vetpërjashtohej nga procesi konkret i vendimmarrjes duke mos marrë pjesë gjatë shqyrtimit dhe votimit të kërkesës së subjektit ndërtues "Alb-Co".

**Cilat janë masat që duhet të marrë ILDKP, si Autoriteti Qendror Përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 9367,datë 7.4.2005?**

ILDKP**,** bazuar në nenin 42/1 gërmat "dh", "gj" të Ligjit Nr. 9367 datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"* më datë 07.04.2009 duhet të fillojë hetimin administrativ për konflikt interesi lidhur me procedurat e vendimmarrjes në mbledhjen e KRRT së Bashkisë M.

Në përfundim të hetimit administrativ, ILDKP konstaton konfliktin e interesave në pjesëmarrjen e anëtarit të KRRT së Bashkisë M, gjatë shqyrtimit dhe votimit të kërkesës së subjektit ndërtues "Alb-Co".

Në zbatim të nenit 44/1/dh, 44/2/3/4 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"* dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, ILDKP vendos masë administrative gjobë ndaj anëtarit të KRRT së Bashkisë M në shumën 400.000 leke.

Lidhur me përfundimin e hetimit administrativ dhe vendimin për konstatimin e konfliktit të interesave ne rastin konkret, ILDKP njofton Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit si dhe KRRT e Bashkisë M.

**Rasti Nr. 2**

Një anëtar i këshillit (bashkiak/ komunal/ të qarkut) është pronar i firmës ABC që merret me pastrimin e mbetjeve urbane. Kjo firmë ka lidhur kontrata pastrimi me bashkitë dhe komunat fqinjë me NJQV-në ku ky kryen detyrën e këshilltarit. Në vitin pasardhës ai aplikon për pjesëmarrjen në tenderin e pastrimit në bashkinë ku është këshilltar.

*Pyetje për diskutim*

A ka konflikt interesi në rastin kur firma e këshilltarit kryen kontratën e pastrimit në NJQV-të fqinje ?

A përbën konflikt interesi lidhja e kontratës së pastrimit me NJQV-në ku ai është këshilltar ?

Mënyra e zgjidhjes

> Në rastin e parë këshilltari nuk gjendet në konflikt interesi pasi, ndalimi i lidhjes së kontratave, sipas nenit 21/2 të ligjit PKI, është vetëm për ato raste kur kontrata lidhet me NJQV-në ku ai kryen funksionet apo detyrat e përcaktuara.
>
> Në rastin e dytë gjendemi përballë konfliktit të interesit dhe Komisioni i Vlerësimit të ofertave duhet t'a skualifikojë ofertën e kësaj firme, sipas nenit 26 pika 1 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për shkak të konfliktit të interesave.

**Rasti Nr.3**

Babai i kryetarit të këshillit të qarkut Y është administrator në një shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit. Kjo shoqëri paraqitet në tender në qarkun, ku është kryetar djali i tij.

*Pyetje për diskutim*:

A mund të lidhet kontrata mes këshillit të qarkut dhe kësaj shoqërie? A është në konflikt interesi kryetari i këshillit të qarkut?

*Përgjigje*:

Në rastin konkret kryetari i këshillit të qarkut përfshihet në ndalimin e përgjithshëm, të parashikuar nga pika 2 e nenit 21 të ligjit nr. 9367 dt. 7.4.2005, datë 7.4.2005. Babai është person i lidhur dhe për të gjen zbatim i njëjti ndalim, si për vetë zyrtarin.

Neni 24 përcakton se "*Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 pikat 2 përbëhet nga bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es*".

Për rrjedhojë, kjo kontratë nuk mund të lidhet. Nëse kontrata është lidhur atëherë ajo do të analizohet në këndvështrimin e nenit 40 te ligjit për PKI. Po kështu në bazë të nenit 44 do të merren sanksionet përkatëse për personat që nuk kanë shmangur konfliktin e interesit në lidhjen e kontratës.

**<u>Rasti Nr.4</u>**

Kryetari i komunës Z, është njëkohësisht dhe kryetar i KRRT-së, si dhe personi i vetëm që mund të nënshkruajë lejet e ndërtimit. KRRT-ja shqyrton kërkesën e babait të kryetarit të komunës, për dhënie leje ndërtimi të një godine banimi, në truallin pronë e trashëguar e kryetarit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij.

*Pyetje për diskutim*:

A është kryetari i komunës në konflikt interesi në rast se nënshkruan lejen e ndërtimit, të dhënë për babain e tij?

*Përgjigje*:

Leja e ndërtimit do të shqyrtohet (do të jepet ose jo) nga KRRT-ja, që është organ kolegjial. Në këtë organ kolegjial kryetari i komunës ka vetëm një votë. Megjithatë, për të shmangur konfliktin rast pas rasti të interesit, kryetari i komunës duhet të shmanget nga vendimmarrja për dhënien e lejes së ndërtimit.

Për sa i përket nënshkrimit të lejes së ndërtimit, kryetari i bashkisë nuk është në konflikt interesi, pasi pika 6 e nenit 37 të ligjit parashikon se:

"*Zyrtari lejohet të ushtrojë funksion dhe të kryejë detyrën me kusht që konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:*

*a) kur ai është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;*
*b) dhe kur:*
*i) nuk është i mundur as tjetërsimi i interesit privat, ...për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);*
*ii) nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, ai të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni.*

*Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga institucionet e ngarkuara me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike*".

**<u>Rasti Nr. 5</u>**

Kryetari i bashkisë është njëkohësisht administrator i "ABC" sh.p.k., e cila ushtron veprimtarinë jashtë territorit të juridiksionit të bashkisë.

*Pyetje për diskutim*:

A ndodhet kryetari i bashkisë në kushtet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit, për shkak të pozicionit të tij në "ABC" sh.p.k.?

*Përgjigje*:

Rastet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit për kryetarët e komunës, bashkisë dhe qarkut janë trajtuar nga neni 29 i ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesit", i cili parashikon se:

"a) *Kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut, nuk mund të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të tij;*
*b)nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të liçencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën"a" të këtij neni dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër*".

Meqenëse "ABC" sh.p.k. ushtron veprimtarinë jashtë territorit të juridiksionit të bashkisë, kryetari i bashkisë është në përputhje me shkronjën "a" të nenit 29. Sigurisht, territori ku ushtron veprimtarinë "ABC" sh.p.k. duhet të jetë pasqyruar në dokumentet e kësaj shoqërie, ashtu siç përcaktojnë ligjet për shoqëritë tregtare.

Në vijim, duhet parë nëse kryetari i bashkisë është i punësuar me kohë të plotë apo të pjesshme në "ABC" sh.p.k. Nëse është i punësuar me kohë të pjesshme, kryetari i bashkisë nuk është në konflikt interesi. Është e rëndësishme që kjo të jetë pasqyruar në kontratën e punës dhe në dokumente të tjera të shoqërisë.

**<u>Rasti Nr. 6</u>**

Në këshillin e bashkisë për shkak të humbjes së mandatit të këshilltarit nga disa anëtarë dhe zgjedhjes së personave të caktuar sipas radhës në listën proporcionale, kanë marrë mandatin si anëtar këshilli bashkiak, vjehrri me dhëndrin.

*Pyetje për diskutim*:

A mund të jenë vjehrri me dhëndrin, anëtar të të njëjtit këshill bashkiak?

*Përgjigje*:

Ligji nr. 9367 dt. 7.4.2005, datë 7.4.2005 nuk parashikon ndonjë ndalim të shprehur për këtë rast. Megjithatë, pika 2 e nenit 5 parashikon se "*Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë*".

Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" parashikon në nenin 25 të tij se "*Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat që janë me njëri-tjetrin bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrri e vjehrra me nusen dhe dhëndrin*".

Për këtë arsye, vjehrri me dhëndrin nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill bashkiak.

**<u>Rasti Nr.7</u>**

Babai i specialistit Y të zyrës së taksave në bashkinë X ka licensë për aktivitetin biznes i vogël. Specialisti Y merret me regjistrin e tatimpaguesve dhe jo me vlerësimin dhe kontrollin tatimor.

*Pyetje për diskutim*

A përbën konflikt interesi rasti i mësipërm? Nëse po, si mund të zgjidhet ai?

Në këtë rast nuk gjendemi para konfliktit të interesit, sepse specialisti i taksave nuk rezulton te jete një nga zyrtarët (kryetari i bashkise, komunës dhe qarkut) sipas ndalimit të nenit 29 të ligjit për PKI si dhe në kryerjen e detyrave të parashikuara për pozicionin e tij ai nuk ushtron asnjë lloj vendimmarrjeje ndaj subjekteve tatimpaguese për rrjedhojë edhe biznesit të babait të tij (thjesht mban evidencën e bizneseve në regjistrin e tatimpaguesve) në të cilin të mund të ndikonte interesi privat.

Megjithatë ky rast mund të trajtohet edhe si rast i konfliktit të interesit në dukje dhe specialisti Y duhet të marrë të gjitha masat për parandalimin e çdolloj konflikti, paraprakisht duke vetëdeklaruar konfliktin e interesit nëse do të caktohej të kryente detyra apo përgjegjësi të caktuara dhe duke u vetëpërjashtuar nga vendimmarrja.

*Mënyra e zgjidhjes*:

Zyrtari vetë duhet të shmanget nga çdo lloj vendimmarrje eventuale që mund të përbëjë konflikt interesi si dhe eprori i tij drejtëpërdrejtë nuk duhet ti caktojë atij detyra të cilat mund të çonin specialistin në gjendje të konfliktit të interesit.

**<u>Rasti Nr. 8</u>**

Th.M. është bashkëpronar në firmën X sh.p.k. e cila tregton farëra për bimë bujqësore në disa komuna përfshirë edhe komunën P. Pas zgjedhjeve vendore Th.M. zgjidhet kryetari i komunes P.

*Pyetje për diskutim*

A ka konflikt interesi Th.M si kryetar i komunes P.? A duhet të heqë dorë Th.M. nga bashkëpronësia apo firma duhet të ndërrojë selinë e aktivitetit të saj?

Th.M. në cilësinë e kryetarit të komunës P dhe si bashkëpronar në firmën X sh.p.k. nuk ka konflikt interesi sipas ndalimit të parashikuar në nenin 29 të ligjit 9367 dt., 7.4.2009. Ky nen parashikon ndalimet si më poshtë:

*Kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut:*
*a) nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të tij;*
*b) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.*

Pra shikojmë që Th.M. në cilësinë e kryetarit të komunës nuk i ndalohet të jetë bashkëpronar në pjesë në kapital në shoqëritë fitimprurëse që veprojnë në territorin e komunës. Gjithashtu, përderisa Th.M. nuk ka ndalime për të qenë bashkëpronar për rrjedhojë edhe firma mund të veprojë në territorin e komunës. Por, duhet të kemi në vëmendje që firma nuk mund të lidhë asnjë kontratë me komunën. Përveç kësaj do të duhej që të parandalohet konflikti i mundshëm i interesit në qoftë se Kryetari do të merrte vendime apo urdhëra të cilat do të ndikonin në veprimtarinë e firmës dhe në këtë rast nëse kjo përbën një mundësi përsëritje të shpeshte në të ardhmen atëherë, Kryetari do të duhej të shmangte konfliktin e vazhdueshëm të interesit duke i shitur ose transferuar pjesët e tij në kapital tek persona të tjerë.

Mënyra e *zgjidhjes*:

Kryetari i komunës do të vazhdojë t'i zotërojë aksionet ose pjesët në kapital të firmës X sh.p.k. dhe firma X sh.p.k do të vazhdojë të ushtrojë aktivitetin e saj në komunë, por duke

pasur në vëmendje implikimet e mësipërme dhe parandalimin e rënies në konflikt të mundshëm dhe/ose të vazhdueshëm të interesit.

**Rasti Nr. 9**

B.L. është drejtues i një firmës XETA sh.p.k dhe pas zgjedhjeve vendore zgjidhet anëtar i këshillit të bashkisë X.

*Pyetje për diskutim*

A përbën konflikt interesi qenia drejtues e B.L. në një shoqëri tregtare me detyrën e tij si anëtar i këshillit bashkiak?

Qenia e B.L. si drejtues i një shoqërie tregtare nuk përbën konflikt interesi të vazhdueshëm sepse ndalimi për zyrtarët vendor sipas nenit 29 të ligjit 9367 dt. 7.4.2005 nuk shtrihet edhe tek anëtarët e këshillave të bashkisë, komunës apo qarkut (shih nenin si në rastin më sipër).

*Mënyra e zgjidhjes*:

B.L. do të vazhdojë detyrën si drejtues i firmës XETA sh.p.k.

**Rasti Nr. 10**

Drejtori i Qendrës Kulturore që është institucion varësie i Komunës X, zgjidhet pas zgjedhjeve vendore dhe fiton mandatin si anëtar i Këshillit të Komunës.

*Pyetje për diskutim*:

A përbën konflikt interesi qenia njëkohësisht Drejtor i Qendrës kulturore dhe anëtar i Këshillit të Komunës?

*Përgjigje*:

Në ligjin për PKI-në nuk do gjejmë trajtim specifik për rastin e mësipërm por analiza bëhet në raport me nenin 25 të Ligjit 8652 dt. 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i cili ndalon anëtarit të këshillit të komunës si më poshtë:

*Neni 25*

*Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit*

*1. Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:*
*a) funksionin e kryetarit, zëvendëskryetarit të komunës ose bashkisë;*
*b) funksionin e sekretarit të këshillit komunal ose bashkiak;*

*c) funksionin e nëpunësit të administratës së komunës ose bashkisë përkatëse;*
*ç) funksionin e deputetit.*

Pra, mund të konkludojmë se mbajtja njëkohësisht e dy detyrave përbën konflikt interesi ose papajtueshmëri. Kur flitet për administratën e bashkisë apo apo komunës, flitet për te gjithë administratën e çdo organi pjese e bashkisë apo komunës si njësi qeverisjeje vendore. Pra, për çdo organ të tyrin, qoftë ky edhe një organ i cili nuk është pjesë e Këshillit Bashkiak apo Kryetarit të Bashkisë. Prandaj, drejtori i Qendrës Kulturore duhet të heqë dorë nga detyra e tij përndryshe do të jemi në konflikt të vazhdueshëm interesi për shkak të fakti që Këshilli i qeverisjes vendore do të ketë vazhdimisht detyrimin të nxjerrë akte për çdo organ të qeverisjes vendore përkatëse në ushtrim të respektimit të detyrimit ligjor.

## Kapitulli V
## 4. MËNYRAT E TRAJTIMIT DHE TË ZGJIDHJES SË KONFLIKTIT TË INTERESAVE

### 5.1 AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE DHE ZGJIDHJEN E GJENDJEVE TË KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” përcakton disa autoritete përgjegjëse për evidentimin parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Kështu në nenin 41 të ligjit përcaktohet qartësisht se, në varësi të subjektit të prekur dhe fushës së veprimit autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave janë:

1. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive cili është autoriteti qendror përgjegjës sipas ligjit.

2. Autoriteti ose strukturat e tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë:
   a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik;
   b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik;
   c) institucionet eprore.[9]

Këto struktura veprojnë në shkallë hierarkike pasi komunikimi i parë i zyrtarit bëhet në radhë të parë me eprorin direkt. Kjo nuk përjashton ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të strukturave të tjera superiore.

#### 5.1.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Inspektorati i Lartë (ILDKP), me cilësinë e autoritetit qendror përgjegjës për zbatimin e këtij

[9] Neni 41- Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

ligji, kryen detyrat dhe ka përgjegjësitë për drejtimin dhe përmirësimin e politikave dhe të mekanizmave të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave.

Si autoritet qendror përgjegjës për evidentimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave, ILDKP merret gjithashtu me monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së akteve nënligjore dhe të rregulloreve të brendshme, të miratuara nga institucionet publike për konfliktin e interesave, me parimet dhe detyrimet e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave.

Inspektoriati i Lartë është institucioni përgjegjës më i lartë i zbatimit të rregullave dhe ligjit për të shmangur konfliktin e interesave dhe zbatimit të tij nga institucionet publike. Me kontrollim të zbatimit të këtij ligji duhet kuptuar jo vetëm momenti i shqyrtimit të deklaratave të pasurisë por edhe të shfaqjes së konflikti rast për rast për të cilin është folur në kreun e mësipërm.

Çdo zyrtar vendor duhet të informojë mbi interesat e tij private që mund të jenë shkak për lindjen e konfliktit te interesave. Në bazë të nenit 10/2 çdo zyrtar jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i punës lëshon një autorizim në favor të institucionit me anë të të cilit e autorizon që të kryejë kontroll e të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin. Regjistrimin e rasteve të konfliktin të interesave të vendimmarrjeve në konflikt bëhet sipas nenit 11 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 nga  autoriteti përgjegjës sipas modelit në matricën nr. 3 bashkëngjitur këtij manuali i përcaktuar nga ILDKP. Ky institucion (ILDKP), gjithashtu përcakton modelin e deklarimit rast për rast të interesave, si dhe të regjistrimit të të dhënave që lidhen me një konflikt të tillë, pra për çdo vendimmarrje të caktuar që mund të çojë në shfaqjen e konfliktit të interesave.

Inspektoriati, si autoritet qendror përgjegjës për shmangien e këtij konflikti, merret dhe me këshillimin e zyrtarëve të veçantë vendorë, të eprorëve të tyre, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin periodik të interesave të subjekteve deklarues.

Kjo do të thotë se çdo zyrtar vendor mund të këshillohet me këtë institucion për çdo rast të mundshëm konflikti, për mënyrën e parandalimit, evidentimit dhe zgjidhjes përfundimtare të tij.

Të tjera kompetenca të Inspektoriatit konsistojnë në:

- verifikimin dhe hetimin administrativ të deklarimeve periodike të interesave;
- verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit rast për rast të interesave, si dhe të ndalimeve e kufizimeve të interesave të përcaktuar në ligj, me kërkesë të institucionit publik a epror ose kur e gjykon të nevojshme edhe me nismën e tij;
- vendosjen e masave administrative ndëshkuese në kompetencë të tij, sipas përcaktimeve në legjislacionin shqiptar;
- Inspektoriati i Lartë, në zbatim të përgjegjësive dhe kompetencave të veta, nxjerr akte nënligjore në formën e urdhrave dhe të udhëzimeve.[10]

[10] Neni 42- Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

### 5.1.2 Autoritetet ose strukturat përgjegjëse

Autoritete përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji sipas hierarkisë në pushtetin vendor janë:

| Organet e zgjedhura kolegjiale | Organet e zgjedhura ekzekutive | Organet ekzekutive |
|---|---|---|
| këshilli i bashkisë / komunës / qarkut | kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut | nën/ kryetari i bashkisë/ komunës/ këshilli të qarkut |
| | | drejtori i drejtorisë së burimeve njerëzore në bashki /komunë /këshill qarku |
| | | drejtuesit e institucioneve në varësi |
| | | drejtorët e drejtorive |
| | | përgjigjësit e sektorit |

Përcaktimi i autoriteteve apo strukturave përgjegjëse përmbush dhe qëllimin e veprimtarisë së bashkive dhe komunave në këtë drejtim. Kjo strukturë është përgjegjësja kryesore në bashki dhe komuna për evidentimin, trajtimin, parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesave nga zyrtarët. Ky autoritet përgjegjës përbëhet nga një zyrtar ose grup zyrtarësh drejtues që formojnë një strukturë kontrolluese.

Roli i kësaj strukture konsiston jo vetëm në kuptimin formal të përgjegjësisë, por duhet të ketë të qartë çastet e lindjes së konfliktit të interesit, të kuptojë vendimmarrjen dhe çastet thelbësore të saj dhe momentet paraprake të vendimmarrjes. Këto probleme duhet të jenë të njohura nga do zyrtar, prandaj është e domosdoshme të pasqyrohen në rregulloren e brendshme të hartuar për parandalimin konfliktit të interesave, që janë faktike ose mund të lindin në veprimtarinë e bashkive gjatë plotësimit të funksioneve nga ana e zyrtarëve përkatës.

Parandalimi dhe zgjidhja e konfliktit të interesave duhet të mbështetet mbi të gjithë legjislacionin mbi të cilin funksionon institucioni dhe konflikti do të kufizohet sipas parimit të kufizimit më të rreptë. Autoriteti përgjegjës duhet t'i zgjidhë rastet e konfliktit në bazë të kërkesave ligjore.

Autoriteti përgjegjës emërohet sipas kërkesave të nenit 41 gërma b, dhe nenit 42 pika 3 e ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 ''Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e

funksioneve publike''. Në institucionet e varësisë nga bashkia, komuna dhe këshilli i qarkut, në të cilat krijohet drejtoria e burimeve njerëzore kjo e fundit është autoritet përgjegjës për administrimin e punonjësve të institucionit të varësisë.

*Si rregull kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut emëron autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit në institucion drejtorin e burimeve njerëzore. Ky fakt duhet patur parasysh pasi sipas kërkesave të nenit 41 pika b jo gjithmonë mund të jetë kështu, gjë që ndodh kur titullari cakton një zyrtar tjetër.*

***Formati i njoftimit në ILDKP***

***REPUBLIKA E SHQIPËRISË***
***BASHKIA/ KOMUNA/ KËSHILLI I QARKUT ________***
***Nr…. Protokolli (Qyteti/Fshati.....), më ………***

***Lënda : Caktim i autoritetit përgjegjës për bashkinë/ komunën/ këshillin e qarkut__x__***

***INSPEKTORIATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE***

Në zbatim të nenit 41, pika 2, germa "b" dhe nenit 42, pika 3 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" ju njoftojmë sa më poshtë:

Duke filluar që nga data ……… z/znj……….. me detyrë drejtor i burimeve njerëzore ose përgjegjësi i personelit, juristi (kur nuk ka drejtori burimesh njerëzore). Në mungesë të këtyre strukturave (p.sh. në komunë) një person i caktuar nga kryetari ) do të jetë autoriteti përgjegjës i konfirmuar në bashkinë/ komunën/ këshillin e qarkut______x___

**KRYETARI I BASHKISË/ KOMUNËS/KËSHILLIT TË QARKUT**

___________________________________

**5.1.2. Autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit.**

Ndër detyrat kryesore të autoriteteve përgjegjëse është t'u japë të gjithë zyrtarëve të rinj, të sapo emëruar apo që marrin një pozicion apo funksion të ri, një dokument deklarimi për parandalimin e konfliktit të interesave.

Drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik vendor, në lidhje me parandalimin e

konfliktit të interesave, bazuar në nenin 10 të ligjit, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë, Komunës apo Këshillit të Qarkut, ushtrojnë detyrat si më poshtë:

a) të mbledhin, nga burimet e ligjshme të informacionit, të dhëna për interesat private të një zyrtari;
b) të pranojnë informacionet e siguruara në mënyrë të ligjshme;
c) të verifikojnë besueshmërinë e këtyre informacioneve;
ç) të vënë në dijeni zyrtarin për informacionet e siguruara për të;
d) t'i japin mundësi zyrtarit të provojë të kundërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë;
dh) të bëjnë regjistrimin e interesave private të zyrtarit.[11]

Po ashtu, drejtoritë e burimeve njerëzore, sipas përcaktimeve në rregulloren e administratës të miratuar nga këshilli i bashkisë, komunës apo këshillit të qarkut:

- Kryejnë detyrat e ngarkuara nga ligji si struktura përgjegjëse,
- Mbledhin dhe i dërgojnë Inspektoratit të Lartë, brenda datës 15 prill të çdo viti, deklaratat e plotësuara të interesave nga ana e zyrtarëve, si dhe e njoftojnë atë për rastet e mosdeklarimeve.
- Në ushtrim të rolit përkatës, drejtoritë e burimeve njerëzore kanë rol konkret në momentin e punësimit të zyrtarëve vendorë sipas legjislacionit për shërbimin cilivi por dhe sipas kodit të punës.

    - Kështu drejtoritë e burimeve njerëzore të cilat janë të ngarkuara të mbajnë dhe organizojnë dosjet e personelit me të dhënat përkatëse për çdo punonjës të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore i plotësojnë këto edhe me deklaratat dhe dokumentet e tjera në lidhje me konfliktin e interesit. Ato mbajnë përgjegjësi për konfidencialitetin dhe për ruajtjen, duke mos lejuar shpërdorimin e tyre.
    - Në momentin e punësimit të zyrtarëve këto drejtori merren me organizimin e konkurseve për pranimin e kandidatëve në punë në bashki dhe zbatimin e gjithë procedurave për marrjen, pezullimin dhe largimin nga puna të nëpunësve civile të punësuar në bashki duke veçuar sipas interesit dhe përcaktimit në aktet ligjore përkatëse rastet e shfaqjes së konfliktit të interesave.

Në përgjithësi, si autoritet përgjegjës caktohet drejtori i drejtorisë së burimeve njerëzore në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, por siç përcaktohet dhe në ligj, mund të caktohen dhe njësi të ngarkuara apo të ngritura posaçërisht sipas nevojës së çdo institucioni publik. Të tilla raste mund të jenë kur në njësinë përkatëse vendore nuk ka drejtori burimesh njerëzore. Një tjetër rast mund të jetë situata e këshillave si organe kolegjiale të pavarura nga kryetarët e bashkive. Si autoritet përgjegjës në këtë rast mund të jetë sekretari i këshillit të bashkisë, komunës apo qarkut. Duke qenë se drejtoria e burimeve njerëzore ka kompetenca të drejtpërdrejta mbi administratën, për anëtarët e këshillave si dhe për institucionet e varësisë së këtyre këshillave, rolin e autoritetit përgjegjës, duke u bazuar në të gjitha detyrat që ai ka sipas ligjit dhe sipas parashikimeve

[11] Neni 37- Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

të këtij manuali, e luan sekretari i përgjithshëm. Këshillat apo organet e varësisë së tyre janë organe që kanë rol thelbësor e përcaktues në vendimmarrje duke qenë se luajnë rolin e organeve legjislative në pushtetin vendor. Është detyrë e autoritetit përgjegjës të këshillit të bashkisë/komunës që para cdo vendimmarrje të shpërndajë tek të gjithë anëtarët e këshillit formularin e deklarimit rast për rast dhe të njohë anëtarët me rastet dhe pasojat e konfliktit të interesit.

Detyrat specifike të drejtorit të burimeve njerëzore si autoritet përgjegjës i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut janë të përcaktuara në mënyrë specifike në nenet 9 dhe 10 të rregullores tip, bashkëngjitur këtij manuali.

### 5.1.3. Institucionet eprore dhe eprori.

Organet e qeverisjes vendore krijojnë administratën e vet si dhe institucione nën varësi për ushtrim të drejtpërdrejtë të funksioneve dhe kompetencave të tyre.

Si institucione dhe ndërmarrje të varësisë së pushtetit vendor përfshihen:

- Administrata e organeve të qeverisjes vendore.
- Policia Bashkiake, Inspektorati i Ndërtimit etj, (kur ato nuk janë përfshirë në përbërje të administratës së njësisë vendore dhe veprojnë si persona juridik më vete).
- Çerdhet, institucione të kulturës, sportit, etj. të kësaj natyre.
- Organizmat që krijohen pranë organeve të qeverisjes vendore me autoritet vendimmmarrës si KRRT (Këshilli i Rregullimit të Territorit) Këshilli i Kujdestarisë etj.
- Ndërmarrje (apo institucione) të ndryshme të krijuara si për administrimin shkollave, për pastrimin, për parqe, lulishte, rrugë etj.

Roli epror ushtrohet në përputhje me ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike ku në vëmendje dhe në rastin tonë do të mbajmë në konsideratë ligjin për pushtetin vendor si dhe ligjet mbi të cilat veprojnë institucionet vendore sipas funksionit, rolit dhe mënyrës së krijimit të tyre.

Pavarësisht kompetencave të një institucioni epror, ai nuk mund të vlerësohet i tillë, nëse kjo do të çonte në cenimin e parimeve kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe të autonomisë institucionale.

Si institucion epror në pushtetin vendor do të konsiderojmë:

a. *këshillin e bashkisë, komunës, qarkut;*
b. *kryetarin e bashkisë, komunës dhe këshillit të qarkut.*

a. <u>Këshilli i bashkisë, komunës dhe qarkut.</u>
Duke iu referuar përkatësisht neneve 32 apo 54 të ligjit nr 8652 date 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", në kompetencat e këshillave të

mësipërme përcaktohet qartë roli i tyre në krijimin e ndërmarjeve publike, shoqërive tregtare ose personave të tjerë të cilat i krijon vetë ose është bashkëthemelues.

Këshilli është institucion epror në raport me:

- Anëtarët e këshillit përkatës.
- Ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë.
- Zyrtarët në administratën e njësisë vendore, në raport me ushtrimin e kompetencave ligjore ekskluzivisht të këshillit, pa përjashtuar raportet e tyre me kryetarin e bashkisë, komunës apo të këshillit të qarkut.

Pra, këshilli është institucion epror për sa i përket fushës së veprimtarisë së tij sipas përcaktimeve në Kushtetutë (neni 113) dhe në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" si dhe ndaj organeve që ka në varësi, pavarësisht së në ligjin nr. 9376 datë 7.4.2005, këshilli nuk përmendet në mënyrë specifike si institucion epror.

### 5.1.4. Roli i këshillit të bashkisë, komunës dhe qarkut, si institucion epror.

- Vetë institucionet e krijuara nga këshilli dhe që janë në varësi të tij, duhet të raportojnë përpara këshillit për plotësimin e veprimtarisë së tyre, në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesave. Për këtë ato gjithashtu paraqesin në mënyrë të dokumentuar situatën rast pas rasti.
- Si institucion epror këshilli ushtron kontrolle mbi administratën e bashkisë, institucionet dhe ndërmarrjet e varësisë. Kjo realizohet:
  - nëpërmjet raportimeve që i kërkon këshilli atyre si në mënyrë periodike ashtu edhe sipas nevojës,
  - nëpërmjet kontrolleve që organizon këshilli mbi veprimtarinë e tyre. Këshilli mund të nisë këto kontrolle me iniciativën e tij nëpërmjet komisioneve për një çështje të caktuar konflikti.

Në ushtrim të funksionit të eprorit nga ana e këshillit, një mjet shumë i rëndësishëm dhe i efektshëm që duhet të përdorë në veprimtarinë e tij janë kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Kontrollit të Deklarimit të Pasurive që është organi më i lartë epror për të gjithë institucionet publike qendrore dhe vendore.

b. <u>Kryetari i bashkisë, komunës dhe këshillit të qarkut.</u>

Kryetari i bashkisë, komunës dhe këshillit të qarkut, në ushtrim të kompetencave dhe detyrave të tij ekzekutive është institucion epror por edhe epror i drejtpërdrejtë pasi drejton veprimtarinë e administratës përkatëse. Si i tillë kryetari:

- Është institucion epror për ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë së njësisë vendore.
- Është epror përkatësisht për zyrtarët e administratës së bashkisë, komunës apo këshillit të qarkut.

Kryetari në ushtrim të rolit të tij në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit, organizon punën dhe siguron:

- mbledhjen, nga burimet e ligjshme të informacionit, të të dhënave për interesat privatë të zyrtarëve të administratës;
- pranon informacionet e siguruara në mënyrë të ligjshme dhe ia adreson drejtorisë së burimeve njerëzore;
- angazhon strukturat përgjegjëse që të verifikojnë besueshmërinë e informacioneve;
- drejtpërdrejt vetë ose me strukturat e caktuara, vë në dijeni zyrtarin për informacionet e siguruara për të;
- i krijon mundësi zyrtarit të provojë të kundërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë;
- kërkon nga struktura përgjegjëse në bashki të bëjë regjistrimin e interesave privatë të zyrtarit. Përsa këtë autoriteti përgjegjës duhet të dorëzojë pranë ILDKP-së regjistrin e plotësuar të evidentimit të konfliktit të interesave në bashki/ komunë apo këshill qarku, sipas matricës nr.3 bashkëngjitur këtij manuali.

Republika e Shqipërisë

Datë /_ /__2009

Institucioni____________________________

**Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së rasteve të konfliktit të interesave**

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Funksioni | Data e evidentimit te KI | Përshkrimi i konfliktit të interesit | Mënyra e zgjidhjes | Data e zgjidhjes | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | | | | | | | | | |
| 2. | | | | | | | | | |
| 3. | | | | | | | | | |
| 4. | | | | | | | | | |
| 5. | | | | | | | | | |

**Shënim:** Ky regjistër është pjesë e raportit vjetor për veprimtarinë e kryer në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, në të cilën duhet të evidentohen rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarimin periodik. Sqarimet në lidhje me rastet e konflikteve të interesave të detajohen në raportin vjetor të Autoritetit Përgjegjës për institucionin tuaj.

**Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave duhet të dërgohet i plotësuar në Inspektoriatin e Lartë brenda datës 31 Janar te çdo viti.**

**Autoriteti Pergjegjës**

______________________

## 5.2. MËNYRAT BAZË TË TRAJTIMIT DHE ZGJIDHJES SË KONFLIKTIT TË INTERESAVE.

### 5.2.1 Roli i vetë zyrtarit dhe eprorit në parandalimin e konfliktit të interesave.

Zgjidhja e rasteve të konfliktit të interesit është një detyrimi ligjor i vetë zyrtarit. Ky është dhe një parim themelor i kërkuar nga vet ligji sipas neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.. Në kryerjen e funksioneve, zyrtari vendor duhet të respektojë parimet etike (të parashikuara dhe në ligjin e etikës) me korrektësi për të shmangur çdo formë të shfaqjes së konfliktit të interesave.

Respektimi i parimeve të etikës përbën një drejtim shumë të rëndësishëm në sensin e rritjes së besueshmërisë së publikut ndaj të zgjedhurve dhe administratës së tij vendore. Kjo nënkupton mosmarrjen e dhuratave, favoreve ose trajtimeve preferenciale në kuptimin që nuk duhet të kërkojë apo të pranojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, familjen, të afërmit, personat fizikë apo juridike me të cilët është i lidhur, dhurata, favore, pritje apo çdo përfitim tjetër, si dhe premtime për to, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij zyrtar, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës, a janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes se detyrës zyrtare. Një dhuratë, konsiderohet e marrë në mënyrë të tërthortë kur i jepet familjes së nëpunësit, të afërmve, deri në shkallën e dytë, personave ose organizatave, me të cilat nëpunësi ka pasur ose ka marrëdhënie biznesi ose lidhje politike, në bazë të kërkesës, rekomandimit apo udhëzimit të nëpunësit.

Nëpunësi nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një nëpunës të një niveli më të lartë apo për persona të lidhur me të dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga nëpunës i një niveli më të ulët ose persona të lidhur me të, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.

Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të konfliktit të interesave, dhuratat, të cilat i ofrohen nëpunësit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit që merr dhuratën.

Nëpunësi mund të mbajë dhurata të lejueshme, pa qenë i detyruar t'i deklarojë ato, nëse nuk e kalojnë vlerën prej 10 000 lekësh për dhuratë, ndërsa në rast se dhuratat janë më të kushtueshme, ai duhet t`i deklarojë ato eprorit direkt, brenda 30 ditëve dhe t'i dorëzojë në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit.[12]

Duke u nisur nga këto drejtime të rëndësishme, përtej dispozitave ligjore, zyrtari vendor fillimisht duhet të zgjidhë vetë konfliktin e tij të interesit. Por kjo mënyrë zgjidhjeje nuk duhet kuptuar si një mundësi abuzimi duke i besuar vullnetit të zyrtarëve sepse, mbi të gjitha, kjo është një zgjidhje që rregullohet me ligj, pra është e detyrueshme për tu zbatuar.

Kështu, në ushtrimin e funksioneve të tij, zyrtari paraprakisht, sipas rrethanës, në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ai, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

**a)** duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë në kuptimin e trasferimit p.sh. të një pjese të caktuar aksionesh që ky zyrtar mund të ketë në një shoqëri tregtare. Në një situatë të caktuar, zyrtari mund të ketë kompetencë thelbësore në vendimmarrjen ose në lidhjen e kontratave dhe për të mënjanuar ndërhyrjen e këtij interesi privat, interesat transferohen;

**b)** duke u vetëpërjashtuar paraprakisht nga procesi konkret i vendimmarrjes, me përjashtim të rasteve kur është i pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;

**c)** duke dhënë dorëheqjen nga detyrat, funksionet apo angazhimet private, që janë në konflikt me funksionin e tij publik. Në këtë situatë zyrtari mund të jetë në rolin e drejtuesit të shoqërisë tregtare të çdo forme të cilën mund ta favorizojë gjatë veprimtarisë së tij publike. Mënyra e duhur e mënjanimit të konfliktit të interesave është pikërisht heqja dorë nga ky post dhe përqëndrimi vetëm në organin publik në të cilin vepron.

ç) duke dhënë dorëheqjen nga funksioni publik, veçanërisht në kushtet e lindjes së konflikteve të vazhdueshme të interesit.[13]

## <u>Rasti 11</u>

Zyrtari L.C. punon me detyrën drejtor në drejtorinë e shërbimeve të bashkisë Y ndërsa bashkëshortja e tij V.C është emëruar specialiste në po të njëjtën zyrë të së njëjtës bashki. Kryetari i bashkisë Y pas zgjedhjes së tij konstatoi këtë fakt.

*Çështje për diskutim*

A gjendemi para kushteve të konfliktit të interesit? Si duhet të zgjidhet kjo situatë?

---

[12] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 22.10.2004

[13] Neni 37 - Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

*Analiza e rastit*

Siç shihet kemi të bëjmë me lidhje të drejtpërdrejtë varësie midis bashkëshortëve dhe mundësia për të rënë në konflikt të vazhdueshëm të interesit është evidente (që nga momenti i mbajtjes në punë dhe trajtimi preferencial ndaj bashkëshortes). Ky rast duhet të zgjidhet sipas nenit 37 të ligjit për PKI por dhe në raport me ligjin për statusin e nëpunësit civil.

*Mënyra e zgjidhjes*

Bazuar në nenin 37 të ligjit për PKI dhe në ligjin për statusin e nëpunësit civil, kryetari komunikon me të dy bashkëshortët dhe merr vendim për transferimin e njërit prej tyre në një pozicion tjetër brenda administratës ose në ndonjë institucion varësie sipas rregullave të përcaktuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil ose kur kjo është realisht e pamundur si zgjidhje ekstreme merret largimi nga puna i njërit prej tyre.

Zyrtari vendor gjatë veprimtarisë së tij mund të bjerë në konflikt të vazhdueshëm të interesit në disa raste. *P.sh.: duke emëruar një person të afërt në një pozicion të tillë që zyrtari mund të shfrytëzojë bashkëpunimin me personin e afërt (të familjes) për të abuzuar dhe për të përfituar nga detyra e tij publike. Një rast i tille është, punësimi nga kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut i një personi të familjes si drejtues të një drejtorie në bashki/ komunë/ këshill qarku.*

Etapa tjetër e zgjidhjes është njoftimi i eprorit ose institucionit epror, sipas rastit, për zgjidhjen e sugjeruar. Ai duhet të provojë dhe dokumentojë këtë zgjidhje që do merret personalisht ose nga eprori. Zyrtari nuk çlirohet nga përgjegjësia e rënies në konflikt interesi, kur masat e marra nga vetë ai nuk rezultojnë të frytshme në parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit.

Kështu në nenin 10, pika 2 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" parashikohet se:

"*Çdo zyrtar, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në një institucion publik, është i detyruar të lëshojë një autorizim, në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai e autorizon këtë institucion që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar. Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror".*

Në zbatim të shkronjës "ç" të pikës 1 të nenit 46 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, institucionet publike duhet të vënë në dispozicion të zyrtarëve të tyre modelin e autorizimit të miratuar nga Inspektorati i Lartë, të pasqyruar më poshtë.

Në rastin e titullarëve të institucionit, autorizimi vihet në dispozicion, bashkënënshkruhet dhe dokumentohet nga institucioni më i afërt epror sipas hierarkisë administrative. Ky autorizim plotësohet nga çdo zyrtar që në momentin që emërohet, vetëm një herë, pra jo çdo vit dhe mbahet në dosjet e autoriteteve përgjegjëse.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

______________________________________________________________________

*(Emërtimi i institucionit)*

Nr.______ Prot. *(Qyteti, fshati)*më, ___/___/_____

***A U T O R I Z I M***

Unë, i nënshkruari, ______________________________________________________

*(emër, atësi, mbiemër)*

me funksion

______________________________________________________________________

*(emërtimi i funksionit dhe institucionit publik)*

në datën ___/___/______, në respekt të detyrimit tim ligjor sipas nenit 10 pika 2 dhe nenit 41 pika 2 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", autorizoj

institucionin______________________________________________________

*(emërtimi i institucionit publik ose i institucionit epror sipas pikës 10 të nenit 3 të ligjit nr.9367)*

që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për personin tim, kudo ku ato janë të regjistruara dhe që lidhen me llojet e interesave private të përcaktuara në nenin 5, me përjashtim të atyre të dhënave vetjake të përcaktuara në pikën 4 të nenit 7 të këtij ligji.

Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.

Autorizimi ka vlerë për të gjithë kohën që unë ushtroj detyrën publike, e cila është subjekt i kontrollit dhe i verifikimit sipas ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Gjithashtu, ky autorizim ka vlerë për çdo kohë, pavarësisht nga mosvazhdimi i detyrës sime publike, por vetëm për ato të dhëna të interesave të mia private, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike në kohën e ushtrimit të saj.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhënat vetjake, të kryera nga institucionet, ose personat e autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, nuk duhet t'u nxjerrë pengesë personave konkretë që posedojnë origjinalin ose kopjen e njehsuar me origjinalin të këtij autorizimi e të ngarkuar zyrtarisht, sipas ligjit për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna të interesave të mia private.

| | |
|---|---|
| AUTORIZUESI | TITULLARI I INSTITUCIONIT<br>(OSE I INSTITUCIONIT EPROR) |
| (*Emër, mbiemër, nënshkrimi*) | (*Emër, mbiemër, nënshkrimi*) |

(*Vula e institucionit*)

### *5.2.2. Po eprori në këtë rast çfarë duhet të bëjë?*

Pas paraqitjes së rastit, ose me nismën e tij personale, eprori i zyrtarit ose institucioni epror, duke filluar nga ai më i afërt, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh çdo situatë të konfliktit të interesit të një zyrtari vartës, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

a) t'i kufizojë zyrtarit informacione të caktuara, që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij;
b) të mos i ngarkojë zyrtarit detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
c) të mos lejojë që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
ç) të rishikojë ose të ndryshojë detyrat dhe kompetencat e zyrtarit;
d) t'a transferojë zyrtarin në një detyrë tjetër, që shmang konfliktin e interesave;
dh) të marrë masat e nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;
e) në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anullojë ose të revokojë, nëse e ka këtë kompetencë, aktet e marra nga zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur, dhe mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;
ë) anullimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;
f) anullimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori kur ai vlerëson se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anullim ose revokim, pra nuk është në proporcion me rëndësinë e situatës.[14]

Përtej të gjithë kufizimeve që vijnë nga përfitimet prej interesave private, një çështje e rëndësishme në këtë rast është dhe ajo e punësimit për të cilën pikat e mësipërme janë të zbatueshme. Në cdo rast emërimi, caktimi, përzgjedhjeje, vlerësimi, zhvillimi të karrierës, largimit nga puna apo akteve të tjera që rregullohen nga marrëdhëniet e punës gjithashtu do të konsiderohen si interesa private që mund të çojnë në shfaqjen e konfliktit të interesave, për shkak të lidhjeve të veçanta që zyrtari vendor mund të ketë me personin.

Në raste të veçanta kur konflikti i interesit lidhet me zyrtarin ose drejtuesin më të lartë të një institucioni publik, trajtimi dhe zgjidhja bëhen nga institucioni epror, nëse ka të tillë, dhe kjo nuk cënon parimin e pavarësisë së institucioneve. Kështu, nëse shfaqet konflikt i interesave për kryetarin e komunës/ bashkisë, atëhere si institucion epror vihet në lëvizje Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive i cili vepron në ushtrim të kompetencave sipas legjislacionit.

[14] Neni 37 - Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut lejohet të ushtrojë funksion dhe të kryejë detyrën me kusht që konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm sipas dispozitave të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit është ai në dukje, në raste kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

Kur kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut:

- Është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve. Këtu përfshihet rasti kur ai me ligj është anëtar ose drejtues i një forumi apo organizmi vendimmarrës.

*Shembull: Kryetarët e komunave dhe të bashkive, që bëjnë pjesë në qark, janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut. Kjo do të thotë që ata janë të pazënvendësueshëm në funksionin e tyre për shkak të pozicionit të veçantë që mbartin si kryetarë, dhe si të tillë nuk mund të zëvendësohen nga askush tjetër në anëtarësinë e tyre në këshillin e qarkut.*

- Vetëpërjashtimi i tij është i pamundur. *P.sh.: në delegimin e kompetencave tek një zyrtar tjetër, kur kjo është e pamundur nga situata e krijuar ose kur nuk e lejon ligji që këto kompetenca të delegohen.*

- Nuk është i mundur as tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij *(si lidhje familjare, komunitare etj.);*[15]

Nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, ai të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni.

Konflikti në dukje i interesit nuk përbën shkak për pavlefshmëri, në rastet e akteve dhe kontratave administrative kur ato dhe zyrtari i cili i nxjerr është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve ose vetëpërjashtimi i tij është i pamundur. Gjithashtu sipas Kodit të procedurave administrative, ky lloj konflikti nuk përbën shkak për pavlefshëmeri kur vendimet e zyrtarit nuk i nështrohen revokimit ose shfuqizimit nga institucioni epror. Në këto raste vendimet e zyrtarit i nënshtrohen gjithnjë një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga institucionet e ngarkuara me ligj për kryerjen e këtyre vendimeve. Këto vendime në çdo rast bëhen publike.

Në rastin kur kryetari i bashkisë ose komunës është personi i vetëm që mund të firmosë pas marrjes së një vendimi për dhënien e një leje, edhe nëse ai shmanget nga vendimmarrja se ka konflikt interesi, ushtrimi i funksionit të tij nuk e lejon që të shmanget nga procesi i firmosjes. Pra koncepti i pazëvendësueshëm ka kuptimin që nuk mund t'ia kalojë këtë tagër dikujt tjeter.

[15] Neni 37/6 - Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Përsa më sipër, me gjithë firmosjen nga ana e kryetarit, konflikti në dukje shmanget duke patur parasysh zbatimin e drejtë të kritereve të ligjit, gjë që është e verifikueshme nga bërja transparente dhe publike e procedurave të ndjekura në këtë rast. Ndërsa institucioni që mund të kryejë kontrollin (*p.sh. nëse ky rast paraqitet si konflikt interesi në media ose si ankesë në formë shkresore, është dhe ILDKP që inicion një procedurë hetimi administrativ për të verifikuar nëse kjo leje, kjo vendimmarrje, është kryer në kushtet e konfliktit të interesave apo jo.*

Eprori njofton me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar zyrtarin në konflikt interesi, si dhe eprorin e vet ose institucionin epror për zgjidhjen e dhënë. Zyrtarët përgjegjës (përfshirë eprorin), për parandalimin dhe shmangien e konfliktit konkret të interesit, nuk çlirohen nga përgjegjësia, kur masat e marra nuk rezultojnë të frytshme në parandalimin dhe shmangien e tij.

### 5.3 Zgjidhja e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave.

Gjatë detyrës së tyre zyrtarët vendorë mund të preken për shkak të funksionit të tyre nga konflikti i interesit. Ata mund të marrin në mënyrë të vazhdueshme vendime në kundërshtim me ligjin e parandalimit të konfliktit të interesit. Pra bëhet fjalë për ndërhyrje konstante të jashtëligjshme që çojnë në shfaqjen konfliktit të interesave.

Në rastet e të gjithë zyrtarëve të lartë vendorë të parashikuar, nga *rregullorja e brendshme tip bashkëngjitur këtij manuali*, zgjidhja e rasteve të konflikti të interesave bëhet në zbatim të ligjit të parandalimit të konfliktit të interesit por dhe dispozitave në ligje të tjerë që e trajtojnë këtë temë.

Që kryetari të vazhdojë të qëndrojë në të njëjtin funksion, duhet detyrimisht:

**a**) Të heqë dorë nga funksionet drejtuese ose të anëtarësisë në organet drejtuese të organizatave fitimprurese, në çdo rast që kjo i ndalohet, sipas ligjit dhe rasteve të shprehura në këtë manual, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 ditë nga çasti i lindjes së këtij detyrimi dhe të njoftojë e të dokumentojë me shkrim këtë fakt menjëherë dhe jo më vonë se 10 ditë nga kryerja e tij. Në momentin e paraqitjes së rastit për konflikt, zyrtari duhet që, brenda 15 ditëve, të largohet nga kjo detyrë private që bie ndesh me funksionin e tij publik. Pra, që në momentin e largimit nga këto organe drejtuese duhet që, brenda 10 ditëve të bëhet njoftimi dhe dokumentimi i këtij rasti. Për këtë rast duke mos patur institucion tjetër epror mbi vete, dokumentimi i rastit i paraqitet ILDKP-së.

**b**) Të ndërpresë, brenda 30 ditëve, ushtrimin e funksionit privat, dhe brenda këtij afati, por sa më parë, t'u kërkojë organeve kompetente ç'regjistrimin sipas ligjit të këtyre veprimtarive. Zyrtari njofton dhe dokumenton përmbushjen e këtyre detyrimeve menjëherë, por jo më vonë se 10 ditë nga afati i mësipërm, si dhe njofton dhe dokumenton ç'regjistrimet e kryera nga organet kompetente në çdo kohë dhe menjëherë, sapo ato të jenë kryer.

Pra sa më shpejt të jetë e mundur, brenda afatit 30 ditor, të ndërpresë veprimtarinë dhe brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 30 ditor të bëjë njoftimin dhe ç'regjistrimin sipas ligjeve përkatëse tregtare.

Në momentin e zhdukjes së shkaqeve të shfaqjes së konfliktit ose zgjidhjes përfundimtare të tij, zyrtari vendor mund të kthehet sërish në pozicionin e mëparshëm në raport me të drejtat mbi pronën.

Nëse dorëheqja nuk jepet brenda afateve të përcaktuara me sipër, eprori ose institucioni më i afërt epror, sipas radhës, zbaton njërën apo disa nga mënyrat e përcaktuara në shkronjat "ç" dhe/ose "d" të pikës 4 të nenit 37 të ligjit 9367 datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave", e cila mundëson zgjidhjen më të frytshme, jo më vonë se 10 ditë nga afati përfundimtar, me përjashtim të rasteve kur ky veprim nuk është i mundur ose ky afat nuk mund të respektohet, për shkak të afateve të tjera procedurale, sipas përcaktimeve të ligjeve të tjera plotësuese të ligjit mbi parandalimin e konfliktit te interesave. [16]

## 5.4. PROCEDURAT KONKRETE TË ZGJIDHJES SË KONFLIKTIT TË INTERESAVE NGA ZYRTARËT VENDOR, EPRORET DHE ORGANET KOLEGJIALE

Procedurat konkrete përfshijnë një sërë veprimesh që synojnë në evidentimin, parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave në pushtetin vendor.

Evidentimi i rasteve të konfliktit të interesit mund të ketë burime të ndryshme.
Identifikimi dhe ofrimi i informacionit për rastet e konfliktit të interesave mund të bëhet nga:

- çdo palë e interesuar që preket nga vendimmarrja e paligjshme;
- çdo zyrtar epror ose jo;
- çdo qytetar që ka një interes të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë.

Duhet theksuar se në çdo rast, burimi i informacionit duhet të jetë i ligjshëm. Informacionet që merren për zyrtarët duhet të jenë marrë në përputhje me ligjin.

Në rastet e parashikuara, për shmangien e konfliktit të interesave, evidentimi i tyre mund të bëhet dhe me kërkesë të palës së interesuar, për shmangien nga vendimmarrja të punonjësit të njësisë vendore që preket nga konflikti i interesit. Pala e interesuar i drejtohet organit që ka kompetencë për të vendosur në lidhje me largimin e tij nga vendimmarrja. Kërkesa tregon qartë faktet mbi të cilat ajo bazohet dhe i drejtohet eprorit të zyrtarit në fjalë. Palë e interesuar sipas rastit mund të jetë, çdo zyrtar, sidomos ai epror, që ka dijeni për interesat private që ndërhyjnë, si dhe është detyrë e çdo institucioni publik, që ka dijeni. Por palë e interesuar kuptohet edhe ajo palë në kuptimin e plotë të kësaj fjale, pra çdo qytetar që preket nga vendimmarrja e gabuar e zyrtarit vendor. Konstatimi i konfliktit të interesit mund të bëhet dhe nga çdo individ që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi dhe që përputhet me qëllimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave. Në këto raste, kur kërkesa bëhet nga palët e interesuara në procedim, akt apo kontratë administrative, punonjësi i prekur nga

[16] Neni 38 - Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

kjo kërkesë ka të drejtë të mbrohet. Me palë të interesuara në procedim administrativ, në rastet e konflitktit të interesave në pushtetin vendor, do të kuptojmë çdokënd që ka një interes të ligjshëm për çështjen në shqyrtim. Sipas ligjit, pjesëmarrës në një procedim të tillë është personi apo subjekti që është mbajtës i interesave të ligjshme, dhe me kërkesën e të cilit fillon procesi ose kundër të cilit zhvillohet procesi.

Burime të tjera informacioni mund të jepen dhe nga, regjistrat publike dhe private të mbajtura sipas legjislacionit në fuqi, të dhënat nga media, prej ankesave të publikut dhe çdo burim tjetër i ligjshëm.

### 5.4.1. Organet kolegjiale

Si veprohet për parandalimin e konfliktit të interesit në rastet kur kërkohet për anëtarë në organet kolegjiale?

Organe kolegjiale në pushtetin vendor janë të gjithë këshillat e bashkive, komunave, ose qarkut, Këshilli i Rregullimit të Territorit (K.RR.T.), borde, forume, komitete të krijuara për çështje të caktuara (si p.sh. Komiteti i Kujdestarisë së Fëmijëve etj.) dhe çdo organ tjetër kolegjial me aftësi vendimmarrëse i krijuar në pushtetin vendor.

Në rastet kur kemi të bëjmë me vendimmarrje në organe kolegjiale si p.sh. këshilli bashkiak, kërkesa për përjashtim nga vendimmarrja konkrete, bëhet nga vetë anëtari i këshillit me evidentimin nga burimet e përmendura më lartë. Kërkesa bëhet me shkrim kur një gjë e tillë kërkohet nga organi të cilit i drejtohet kërkesa, dhe i drejtohet kryetarit të këshillit bashkiak i cili, në vetvete, duhet theksuar se nuk funksionon si organ epror. Organ epror në këtë rast është vetë këshilli. Kryetari i tij, rastin e shfaqur referon në mbledhjen e këshillit. Kur anëtari i organit ka kundërshtim me përjashtimin e tij, (kjo mund të ndodhë në rastin kur anëtari i këshillit nuk e kërkon vetë përjashtimin e tij) me pretendimin se nuk gjendet në konflikt interesi, atëherë këshilli shqyrton pretendimin dhe kurdoherë mund të vihet në lëvizje për të marrë vendimin për përjashtimin ose jo të këshilltarit nga shqyrtimi i çështjes dhe marrja e vendimit përkatës.
Në rastet kur bëhet fjalë për përjashtimin e drejtuesit nga një vendimmarrje apo procedim administrativ, vendimi për këtë përjashtim merret gjithashtu nga vetë organi kolegjial, por pa pjesëmarrjen e drejtuesit.

**Rasti 12**
Firma X me presidente bashkëshorten e një anëtari të këshillit të bashkisë Y konkurron në procedurën e tenderimit për të marrë në sipërmarrje shërbimin e pastrimit në të njëjtën bashki.

*Çështje për diskutim*

A jemi në rastin e konfliktit të interesit dhe a duhet përjashtuar paraprakisht pjesëmarrja e firmës X në këtë tender?

*Analiza e rastit*

Bazuar në nenin 21 pika 2 të ligjit nr 9367 datë 7.4.2005 këshilltari bën pjesë në rrethin e zyrtarëve në të cilin ndalohet lidhja e kontratave brenda juridiksionit të njësisë vendore përkatëse. Ndërkohë në rastin konkret neni 24/1 përcakton në rrethin e personave të lidhur me zyrtarin ku përfshihet bashkëshortja dhe që ndalohet të lidhë kontratë me njësinë përkatëse. Si i tillë jemi në gjendjen e konfliktit të interesave.

*Mënyra e zgjidhjes*

Pas analizimit të këtyre të dhënave Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të Bashkisë Y, bazuar në piken 1 të nenit 26 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, vendos të skualifikojë firmën X, për shkak të lidhjeve familjare të presidentes së kësaj firme me njërin prej këshilltarëve të këshillit të bashkisë Y.

## Efektet e përjashtimit

Për rastet e konfliktit të interesave të paraqitura, anëtari i këshillit duhet të ndërpresë çdo veprim për sa kohë eprori ose drejtuesi nuk urdhëron të kundërtën.
Pavarësisht nga përjashtimi i zyrtarëve ose anëtarëve të organeve kolegjiale, ato janë të detyruar të ushtrojnë kompetencat e tyre në raste emergjence, me kushtin që këto veprime të ratifikohen nga subjekti zëvendësues ose nga organi kolegjial[17].

## Efektet e deklarimit të përjashtimit

Organi kolegjial do të funksionojë, si i tillë por pa pjesëmarrjen e anëtarit që është larguar, p.sh. nga votimi për një vendim të caktuar. Vendimi në lidhje me përjashtimin jepet brenda 5 ditësh sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Në rastet e një, zyrtari të administratës ai zëvendësohet nga zëvendësi i tij ligjor, përveç rasteve kur eprori e merr këtë çështje nën autoritetin e tij.

## <u>Rasti 13</u>

Specialisti Z.K, anëtar i KRRT është angazhuar nga firma X ka marrë pjesë në hartimin e projektit për rikonstruksionin e rrugës H.T që do financohet me fondet e bashkisë. KRRT-së i janë paraqitur 3 kërkesa të firmave të ndryshme mes të cilave firma X për leje ndërtimi për të njëjtën rrugë me projektet përkatëse.

*Çështje për diskutim*

A ndodhemi përpara konfliktit të interesave dhe a duhet parandaluar nëse ekziston ky fenomen?

*Analiza e rastit*

---

[17] Kodi i Procedurave Administrative

Sic shihet zyrtari ka interesa private konkrete në rastin në fjalë në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005. Për faktin që specialisti është anëtar i KRRT-së dhe me rol përcaktues në vendimmarrje është konfliktit rast për rast të interesave. Atëherë ai duhet parandaluar duke u bazuar në një nga mënyrat e zgjidhjes së konfliktit të përcaktuara në nenin 37 të ligjit të mësipërm.

Mënyra e zgjidhjes

Në këto rrethana specialisti Z.K. duhet të vetëdeklarohet dhe të vetëpërjashtohet nga shqyrtimi dhe votimi për këtë leje ndërtimi bazuar në dispozitat e nenit 37 të ligjit nr 9367 datë 7.4.2005 për PKI.

### 5.4.4. Masat disiplinore[18]

Aktet dhe kontratat në të cilat marrin pjesë punonjësit e njësive të qeverisjes vendore dhe që preken nga dispozitat mbi përjashtimin janë të pavlefshme. Çdo shmangie nga detyrimi i punonjësit për të bërë të ditur ekzistencën e kushteve të konfliktit të interesave, sipas ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005, përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe sipas rastit mund të çojë deri në sanksione sipas parashikimeve të këtij ligji.[19]

Trajtimet dhe zgjidhjet e përgjithshme të konfliktit të interesave, të paraqitura më sipër, nuk vlerësohen si sanksione. Sanksionet që aplikohen parashikohen në kodin e procedurave administrative dhe cilësohen si kundërvajtje administrative por edhe si masa disiplinore. Ato variojnë në sanksione të karakterit financiar, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika,ç,d,dh të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, por në rastet kur shkelja administrative përbën vepër penale do të zbatohen dispozitat e kodit penal dhe çështja do kalojë për shqyrtim gjyqësor. Në rastet kur një zyrtar vendor, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, bën një shkelje administrative që është parashikuar dhe nga kodi penal, do të zbatohen pikërisht dispozitat e këtij kodi.

Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, nga zyrtarët përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet, që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve.
Për zyrtarët, që njësohen ose janë anëtarë të organeve kushtetuese, siç janë kryetarët e bashkive/ komunave ose anëtarët e këshillave bashkiake, zbatohen masat dhe procedurat e përcaktuara nga Kushtetuta dhe dispozitat ligjore përkatëse.

Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, për shkeljen e kryer nga anëtarët e strukturës përgjegjëse të institucionit vendor, në drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive, i

[18] Kodi i Procedurave Administrative
[19] Neni 45 - Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

propozon titullarit të këtij institucioni largimin nga funksioni të këtij anëtari.

Mosdhënia e autorizimit nga zyrtarët për ushtrimin e kontrolleve dhe sigurimin e të dhënave vetjake ndaj tyre që sipas ligjit i bashkangjitet deklaratës së pasurive, sjell ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin, që rregullon marrëdhëniet e punës.

## 5.5.PAVLEFSHMËRIA E AKTEVE TË MARRA NË KUSHTET E KONFLIKTIT TË INTERESAVE DHE PASOJAT

Pavlefshmëria është një gjendje juridike paligjshmërie që krijohet nga organet e administratës publike nëpërmjet zbatimit të gabuar të ligjit ose vullnetit juridik të vesuar që shfaqet në aktin apo veprimin konkret administrativ. Në këtë drejtim do të trajtohet nxjerrja e akteve në kushtet e konfliktit të interesit, kur ato do të konsiderohen të pavlefshme duke trajtuar dhe llojet e ndryshme të pavlefshmërise dhe pasojat që sjellim. Gjithçka që do trajtohet në këtë pjesë për pavlefshmërinë duhet kuptuar në raport me konfliktin e interesit dhe se, kjo pavlefshmëri vjen pikërisht sepse këto akte nxirren në kushtet e konfliktit të interesit.[20]

Aktet dhe kontratat administrative të çdo njësie të qeverisjes vendore dhe ankimimi ndaj tyre, të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesave, janë të pavlefshme, sipas kuptimit të këtij termi dhe parimeve e procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

*Pavlefshmëria e akteve administrative, në kuptimin e këtij Kodi, paraqitet në format e mëposhtme:*
*a) akte administrative absolutisht të pavlefshme janë akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin;*
*b) akte administrative relativisht të pavlefshme janë akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin.*

Një akt ose kontrate administrative e nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit është i pavlefshëm, sipas kuptimit të këtij termi dhe parimeve e procedurave të përcaktuara në K.Pr.A . Gjithçka do të vlerësohet sipas situatave të veçanta, rast për rast për të kuptuar gjendjen në të cilën ndodhemi. Për të kuptuar llojin e pavlefshmërisë në të cilin gjendet akti ose kontrata administrative e nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit duhet të lexohet me kujdes ndarja e mëposhtme sepse ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me pasojat pas nxjerrjes së aktit.

### 5.5.1 Aktet administrative absolutisht të pavlefshme

Pavlefshmëria absolute e aktit është një gjendje e tillë ku ka mangësi të plotë veprimi juridik nga akti. Akti që në momentin e nxjerrjes së tij nuk krijon dhe nuk mund të krijojë pasojat juridike për të cilat është nxjerrë. Një akt i pavlefshem nuk është akt. Ai është një nulitet i plotë, një akt i dështuar i cili konsiderohet se nuk ka hyrë kurrë në fuqi. Pavlefshmëria që

[20] E drejta Administrative, faqe 129 – Sokol Sadushi, Tiranë 2005

konstatohet nëpërmjet revokimit nga organi që e ka nxjerrë ose nëpërmjet shfuqizimit nga një organ epror ose nga gjykata ka vetëm karakterin konstatues të faktit të pavlefshmërisë. Pra për aktet absolutisht të pavlefshme nuk është nevoja të shprehet domosdoshmërisht ndonjë organ.

Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në rastet e mëposhtme:
a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar pra që nuk ka tagrat e duhura të pushtetit të dhëna nga ligji;
b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore. Edhe në qoftë se ky organ është i ligjshëm ai nuk duhet ti kapërcejë kompetencat që i ka dhënë ligji gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;
c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji. P.sh. në rastin e një organi kolegjial rezulton se nuk është formuar shumica e nevojshme për zhvillimin e mbledhjes.[21]

*Efektet e aktit administrativ absolutisht të pavlefshëm.*

Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk prodhojnë pasoja ligjore, pavarësisht nga fakti nëse janë deklaruar apo jo si të tillë. Madje nuk është nevoja që të deklarohet sepse një akt absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjëherë pasoja ligjore sepse konsiderohet se nuk ka ekzistuar asnjëherë. Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë. Organi administrativ kompetent, me nismën e tij, mundet të konstatojë një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm në çdo kohë.
Në qoftë se vetëm një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme, i gjithë akti do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, në rast se pjesa që anullohet është aq e rëndësishme saqë pa të akti nuk e realizon qëllimin e tij.

### 5.5.2. Aktet administrative relativisht të pavlefshme

Akti administrativ relativisht i pavlefshëm është një gjendje e tillë e pavlefshmërisë së aktit që, përsa kohë nuk është bërë objekt i ankimit administrativ ose gjyqësor brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe në Kodin e Procedurës Civile. Ai paraqet fuqinë juridike të një akti të vlefshëm deri në momentin që organi administrativ kompetent ose gjykata në rrugën e rishikimit administrativ ose gjyqësor deklaron pavlefshmërinë. Që nga ky moment akti administrativ relativisht i pavlefshëm pushon së ekzistuari.

Akti administrativ do të konsiderohet relativisht i pavlefshëm në këto raste:

1. Kur përmbajtja e aktit nuk përputhet me përmbajtjen e ligjit ( p.sh. kur një subjekti të caktuar i njihen disa të drejta që ligji nuk i njeh).
2. Kur përmbajtja e aktit nuk përputhet me qëllimin e ligjit.

---

[21] Kodi i Procedurave Administrative

3. Kur vullneti i organit administrativ është i vesuar. Si vese të diktuara nga të tjerë ose jo të vullnetit do të konsiderojmë: gabimin apo lajthitjen, mashtrimin, dhunën fizike, dhunën morale, pazotësinë e organit administrativ etj.

Kur një akt i një institucioni publik vendor pra, në rastin e një zyrtari, eprori (kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut) dhe në rastin e anëtarëve të organit kolegjial këshilli ose çdo organ kolegjial sipas paraqitjes më sipër në manual) bëhet i pavlefshëm, sipas përcaktimeve të pikës së mësipërme dhe ky institucion publik gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim sipas ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005, ai:

- ndërmerr procedurat e dënimit disiplinor ndaj zyrtarit, shkaktar i pavlefshmërisë së aktit;
- përdor të gjitha mjetet ligjore për kalimin e barrës së dëmshpërblimit te ky zyrtar;
- i kërkon gjykatës përkatëse edhe vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;
- bën kallëzim penal ndaj zyrtarit, nëse gjykon se shkelja e kryer nga ai përbën vepër penale;

Në rastin kur vetë institucioni publik nuk e merr këtë nismë, sipas pikave të mësipërme, institucioni epror (nëse ka), duke filluar nga ai më i afërti e me radhë, sipas kompetencave ligjore, zbaton detyrat e përcaktuara me lart. Në mungesë të veprimit të tyre, detyrat e përcaktuara në këtë dispozitë, zbatohen nga Inspektorati i Lartë në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit;

Përcaktimet e mësipërme mund të zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari tjetër përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e veta nuk ka parandaluar konfliktin e interesit, shkak për pavlefshmërinë e aktit, ose për moszbatimin e detyrimeve të përmendura më sipër. Veprimet e përcaktuara të këtij paragrafi kryhen nga institucioni publik, sipas rastit, edhe kundër personit të lidhur, personit të besuar ose çdo personi tjetër bashkëpërgjegjës.

Megjithatë për të kuptuar më mirë se cilat akte në konflikt interesi jane relativisht ose absolutisht të pavlefshme dhe gjithashtu për të kuptuar nëse jemi në kushtet e konfliktit të interesit zyrtarët vendorë duhet të ndjekin hapat metodologjike të mëposhtme :

*1. Cilat janë detyrat dhe kompetencat konkrete e të detajuara të zyrtarit në fjalë?*
*2. A ka ai kompetencë thelbësore e përcaktuese në vendimmarrjen për nxjerrjen e akteve normative dhe/ose individuale konkrete?*
*3. Cila është sfera (hapësira, fusha) e ndikimit të këtij akti?*
*4. Sa i fortë është ndikimi i këtij akti në këtë sferë?*
*5. Cilat janë interesat private të zyrtarit në fjalë?*
*6. Çfarë mundësish ka që akti të ndikojë interesat private të këtij zyrtari në favor të tij?*
*7. Çfarë mundësish ka që interesat private të zyrtarit të ndikojnë negativisht rolin e tij në vendimmarrjen për këtë akt?*
*8. A ka një lidhje të fortë shkak-pasojë ndërmjet interesave dhe aktit, e tillë që vendimmarrja publike të mund të jetë, për këtë shkak dhe vetëm për të, një vendimmarrje e padrejtë?*

**<u>Rasti 14</u>: Aktet e pavlefshme**

Në bashkinë A është zhvilluar procedura e konkurrimit për pozicionin e drejtorit në drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore. Në përfundim të procesit të konkurrimit, nga tre kandidatët është renditur i dyti në konkurrim vëllai i kryetarit të bashkisë. Zyrtari nuk kishte deklaruar për lidhje familjare me kryetarin. Kryetari i bashkisë që është dhe eprori i drejtpërdrejtë i zyrtarit në fjalë firmos aktin e emërimit që i paraqitet nga drejtoria e burimeve njerëzore.

Njëri prej kandidateve të tjerë shkon në ILDKP dhe paraqet rastin e tij duke pretenduar se kandidati i përzgjedhur është në konflikt interesi për shkak të lidhjes familjare midis tij dhe kryetarit. ILDKP shqyrton rastin dhe konstaton lidhjen e pakundërshtueshme familjare për kryetarin dhe zyrtarin e emëruar që megjithatë nuk e kishin deklaruar lidhjen duke shkelur kështu nenin 37 të ligjit nr 9367 date 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" por dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjin për Statusin e Nëpunësit Civil.

*Çështje për diskutim*

- A jemi në gjendjen e konfliktit të interesave? Kush janë kushtet që duhet të plotësohen?
- A jemi në gjendjen e pavlefshmërisë së aktit të përzgjedhjes së zyrtarit?

*<u>Zgjidhje</u>*

- Edhe pse vëllai i kryetarit nuk hyn tek personat e lidhur sipas ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 ai, sipas kodit të procedurave administrative bazuar në nenin 37 të tij, hyn në rrethin e personave me lidhje familjare deri në shkallë të dytë. Ky moment mund të çojë në konflikt qoftë dhe në dukje të interesit sepse ekziston varësia e drejtpërdrejtë, madje në të ardhmen konflikti mund të bëhet i vazhdueshëm.
Kushti që plotësohet për qënien në konflikt interesi është shkelja e nenit 37 të kodit të procedurave administrative. Në këtë rast janë shkelur qartazi procedurat për emërimin, ku kryetari i bashkisë pavarësisht se ishte në dijeni të lidhjes së tij familjare gjithsesi nuk e paraqiti këtë rast dhe përzgjodhi zyrtarin në fjalë, Pra, ekziston lidhja familjare dhe mundësia në të ardhmen e rënises në konflikt interesi (nëpërmjet favoreve preferenciale që mund ti bëhen zyrtarit nga kryetari i tij, mundësia në ndërhyrje dhe në ndihmesa të bizenseve private të zyrtarit apo kryetarit)

- Bazuar në nenin 116 të Kodit të procedurave administrative në pikat b dhe c të tij në të cilin shprehet se një akt është absolutisht i pavlefshëm:

b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji. do ta konsiderojmë këtë rast si pavlefshmëri absolute në nxjerrjen e aktit dhe rrjedhimisht ky veprim emërimi nuk ka asnjë efekt ligjor dhe do të konsiderohet se nuk ka ekzistuar

asnjëherë. Sic shihet kryetari i bashkisë ka kapërcyer kompetencat e tij në emërimin e vëllait të tij duke shkelur ligjin PKI, duke emëruar një zyrtar të renditur të dytin në procedurën e konkurimit, gjithashtu ai ka qënë në dijeni të lidhjes së tij familjare por nuk e ka deklaruar sipas kërkesave të nenit 37 të ligjit PKI.

### 5.5.3. Shfuqizimi dhe revokimi i akteve administrative

**Shfuqizimi**

*Shfuqizimi është e drejta e organit më të lartë administrativ të pushojë fuqinë juridike të aktit të një organi më të ulët, nëpërmjet shuarjes së pasojave juridike të krijuara, krijimit të efekteve të reja ligjore për subjektet e interesuara ose ndryshimit të pasojave ekzistuese.*[22]

**Revokimi**

*Revokimi është e drejta e organeve administrative, për të rishqyrtuar aktin e tij nëpërmjet ndryshimit a shfuqizimit përfundimtar, për arsye të papërshtatshmërisë me ligjin, me rrethanat ose me kushtet e krijuara pas daljes së tij.*[23]

**Revokimi dhe shfuqizimi i akteve të pavlefshme.**

Aktet administrative relativisht të pavlefshme mund të revokohen ose shfuqizohen vetëm për shkak të pavlefshmërisë dhe brenda afatit kohor të caktuar për ankimin gjyqësor.

Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk mund të shfuqizohen apo revokohen sepse ato konsiderohen se nuk kanë patur asnjëherë fuqi ligjore dhe si të tillë nuk kanë hyrë asnjëherë në fuqi.

**E drejta për të revokuar dhe shfuqizuar**.

Me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, e drejta për të revokuar aktin i takon organit që e ka nxjerrë atë, ndërsa shfuqizimi i aktit është prerogativë e organit epror. Pra vetëm organet eprore kanë të drejtë të shfuqizojnë një akt. Organi që e ka nxjerrë mundet vetëm ta revokojë, pra ta tërheqë aktin. Aktet administrative të nxjerra me delegim mund të revokohen nga organi delegues, si dhe nga organi i deleguar, vetëm për aq kohë sa delegimi është i vlefshëm. Me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, akti revokues ose shfuqizues ka të njëjtën forme ligjore dhe ndjek të njëjtat procedura me aktin që revokohet ose shfuqizohet.

Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ të nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit ose kundër një refuzimi për nxjerrjen e aktit administrativ për

[22] E drejta Administrative, faqe 171- Sokol Sadushi, Tiranë 2005
[23] E drejta Administrative, faqe 167- Sokol Sadushi, Tiranë 2005

të favorizuar dikë tjetër me mosnxjerrjen e këtij akti. Organi administrativ, të cilit i drejtohet ankimi, shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar. Në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ. Pra, në rastet kur ekziston mundësia e ankimit administrativ, vetëm pasi kanë shteruar animimin administrativ, palët mund t'i drejtohen gjykatës. Seksionet administrative në të cilat dërgohen rishikimet mund të vlerësojnë vetëm ligjshmërinë e aktit, pra ato mund të specifikojnë nëse akti është nxjerrë apo jo në kushtet e konfliktit të interesave.

Ankimi administrativ pezullon zbatimin e aktit administrativ, pra ai nuk mund të ketë pasoja ligjore për sa kohë është i pezulluar. Në disa raste të parashikuara në kodin e procedurave administrative (neni 138 pika 2) zbatimi i aktit administrativ nuk pezullohet.

Ankimi administrativ mund të bëhet përpara organit që ka nxjerrë aktin administrativ të ankimuar ose që ka refuzuar të nxjerrë aktin administrativ dhe, nëse kjo nuk rezulton efektive i drejtohet organit epror të organit të përmendur për zgjidhjen përfundimtare të ankimimit. Pas ankimit në organin epror, ky i fundit mund t'ia transferojë dosjen përkatëse organit që ka nxjerrë ose ka refuzuar të nxjerrë aktin, së bashku me orientimet e tij për zgjidhjen e çështjes, ose organi epror shqyrton ankimin dhe merr vetë vendim mbi aktin e ankimuar

Të gjitha afatet kohore dhe procedurat për shfuqizimin, revokimin apo ankimin e akteve dhe kontratave administrative janë të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Në këtë Kod nenet e tij nuk shprehen specifikisht për konfliktin e interesave, por dispozitat e tij në lidhje me një vendimmarrje të veçantë duhet përshtatur dhe interpretuar rast për rast kur gjendemi në kushtet e konfliktit të interesave.

**<u>Rasti 15</u>**

Nën/kryetari i bashkisë X është aksioner në kompaninë Z. Kjo kompani lidh kontratë me bashkinë për pastrimin e qytetit. Në këtë rast siç shihet është shkelur neni 21 i ligjit PKI dhe jemi në gjendjen e konfliktit të interesave. Kryetari i bashkisë vihet në dijeni të këtij fakti dhe lëshon një urdhër për shkarkimin e nën/kryetarit të tij për shkakun e mësipërm. Pas disa kohësh kur çështja e shfaqur e konfliktit ishte zgjidhur sipas ligjit, kryetari vendos të revokojë aktin e shkarkimit dhe të rikthejë në detyrë nën/kryetarin.

Çështje për diskutim

Kush ka të drejtë të revokojë aktin e shkarkimit të nën/kryetarit dhe a mund të revokohet ai?

Analiza e rastit

Përsa i përket gjendjes së konfliktit të interesit nga ana e nën/kryetarit ajo është e qartë duke qenë se është shkelur qartazi neni 21 pika 2 e ligjit për PKI që përbën dhe kufizim absolut. Sipas nenit 121 të Kodit të Procedurave Administrative, nisma për revokim të akteve administrative bëhet me nismën e organit kompetent ose si rezultat i kërkesës për shqyrtim apo apelimit të palëve të interesuara. Në nenin 124 të po këtij kodi përcaktohet se *me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, e drejta për të revokuar aktin i takon*

*organit që e ka nxjerrë atë.* Në baze të nenit 122 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se mund të revokohen dhe aktet e vlefshme me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
*a) kur ligji parashikon parevokueshmërinë/ pashfuqizueshmërinë e tyre;*
*b) kur akti krijon të drejta të ligjshme;*
*c) kur akti i jep administratës të drejta dhe detyrime nga të cilat nuk mund të hiqet dorë.*

*Zgjidhja e rastit*
Siç shihet nismën për revokimin e aktit e ka vetë kryetari i bashkisë pra ai mund ta revokojë aktin e tij sipas ligjit. Duke qenë se çështja e konfliktit tashmë është zgjidhur, asnjë kufizim ligjor nuk ekziston më për mos revokimin e aktit. Pavarësisht se bëhet fjalë për revokimin e një akti të vlefshëm asgjë nuk është e kundraligjshme sepse nuk plotësohen kërkesat e nenit 122 të Kodit të Procedurave Administrative, pra akti mund të revokohet lirisht nga ana e kryetarit të bashkisë X.

### 5.5.4. Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Në pushtetin vendor në zbatim të ligjit nr. 8652 datë 31.7.2000 dhe, të nenit 46 të ligjit nr. 9367 datë. 7.4.2005, këshillat bashkiake/komunare dhe të qarkut, si në çdo fushë tjetër të administrimit të tyre dhe për parandalimin e konfliktit të interesave, në mbështetje të parimit të proporcionalitetit dhe të natyrës së veçantë të funksioneve të institucioneve publike dhe/ose të çdo zyrtari, nxjerrin një rregullore të brendshme mbi parandalimin e konfliktit të interesit në pushtetin vendor sipas modelit tip bashkangjitur këtij manuali.

2. Mungesa e akteve të përcaktuara në nenin 46 të ligjit nr. 9367 datë. 7.4.2005, nuk përbën pengesë për zbatimin e këtij ligji. Në mungesë të akteve, ky ligj zbatohet drejtpërdrejt. Bën përjashtim vetëm deklarimi periodik i interesave, që kryhet në bazë të urdhrave dhe të udhëzimeve shpjeguese, të nxjerra nga Inspektori i Përgjithshëm".[24]

## RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË BASHKINË / KOMUNËN/ KËSHILLLIN E QARKUT___ .

## KREU I
## RREGULLA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Baza ligjore

[24] Neni 46 - Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në bashkinë/ komunën/ këshillin e qarkut______ (këtu shënohet emri i njësisë vendore dhe në institucionet në varësi hartohet dhe miratohet në bazë të nenit 46 paragrafi 1 i ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 (për parandalimin e konfliktit të interesave). Kjo rregullore bazohet në ligjin e mësipërm si dhe në ligjin nr. 9049 datë 10.4.2003 ( për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike).

**Neni 2**
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i një vendimmarrjeje transaprente e të paanshme, në mbështetje të plotësimit të objektivave dhe detyrave të bashkisë, komunës, këshillit të qarkut______, në interes më të mirë të mundshëm të publikut, të besimit të tij ndaj saj dhe insitucioneve të varësisë, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të një zyrtari në ushtrim të kompetencave vendimmarrëse të insititucionit.

**Neni 3**
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

**Neni 4**
**Shpjegim i termave të përdorura**

1. Termat e përdorura në këtë rregullore si: konflikti interesi, konflikt faktik interesi, konflikt në dukje i interesit, konflikt i mundshëm i interesit, konflikt rast për rast i interesit, konflikti i vazhdueshëm i interesit, kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjigjësive, kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe përgjegjësive, zotërim aktiv ose pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital, zyrtar, dhurata, person i lidhur me një zyrtar, insititucion publik, epror i një zyrtari, institucion epror, parimi i proporcionalitetit, kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005.
2. Termat organe të njësive të qeverisjes vendore (bashki, komunë, këshill qarku), funksione ( të veta, të përbashkëta, të deleguara), kompetenca ( administrative, invesitimi, shërbimi, mirëmbajtjeje), pushtet qendror, kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr. 8652 datë 31.7.2000

**Neni 5**
**Çastet e vendimmarrjes**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

1. Vendimmarrje për një akt vlerësohet në çdo rast momenti i fundit (veprimtaria përfundimtare) e procesit vendimmarrës (mbledhja e këshillit, vendimi i kryetarit apo i çdo organi dhe insitiucioni kompetent).
2. Çastet paraprake të vendimmarrjes, por jo të kufizuara vetëm si më poshtë, janë:
a) hartimi i projekt/aktit nga zyrtari dhe dorëzimi tek organi kompetent për vendimmarrje;
b) komente, mendime, sugjerime, e çdo kontribut tjetër i dokumetuar për projekt/aktin nga zyrtarë të tjerë brenda apo jashtë institucionit, të subjekteve të interesuara për këtë projekt/akt, si dhe të çdo zyrtari në kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
c) çdo dokument paraprak ndërmjetës ose shoqërues të një vendimmarrje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë administrative mbi të cilat vendoset dhe mbështetet përmbajtja përfundimtare e projekt/aktit apo kontratës;
d) raste të tjera në përputhje me specifikat konkrete të misionit dhe veprimtarisë të këshillit të bashkisë/ komunës/ qarkut, kryetarit të bashkisë/komunës/këshillit të qarkut, zyrtarëve të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut dhe institucioneve të varësisë.

## Neni 6
## Kompetencat thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Zyrtari ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në një vendimmarrje për atë akt sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore dhe përcaktuese të një zyrtari për një akt përfshihet, në secilën nga çastet paraprake të vendimmarrjes (neni 5, pika 2), mundësia për të ndikuar mbi vendimmarjen e cila buron nga;
a) roli urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi, dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e aktit apo kontratës;
b) zotërimi i informacionit që lidhet kryesisht me të dhëna për biznesin, për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacionin personal, informacione për organet e hetimit dhe të ndjekjes, informacione për politikat ekonomike vendore dhe administrimin financiar;
c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete të funksionit të veprimtarisë së zyrtarit.

## Neni 7
## Interesat private

1. Në kushtet e bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_________, interesat konkrete që mund të bëhen shkak për lindjen e konfiliktit të interesave, si dhe masa e kufizimit të tyre janë:
a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
b) çdo marrëdhenie tjetër juridiko - civile;
c) dhurata, premtime, favore preferenciale;

ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës së kryer gjatë ushtrimit të detyrës;
d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie tjetër që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
e) marrëdhënie familjare apo të bashkëjetesës, komunitetit, etnike, fetare, të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
ë) angazhime të mëparshme nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendura në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2 Kufizimet e interesave private sipas ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005, në rastet kur për të njëjtin interes është përcaktuar kufizim në një ligj tjetër, zbatohet kufizimi më i rreptë. Nëse në një ligj tjetër, një interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave kufizohet shprehimisht me një kufi sasior atëherë ky kufizim zbatohet dhe për kriteret e përcaktuara në ligjin 9367, datë 7.4.2005, nëse në këtë ligj nuk është përcaktuar ndonjë kufizim i këtij interesi dhe anasjelltas.

## KREU II
## NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

### Neni 8
### Autoritetet përgjegjëse

1. Autoritete përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, sipas hierarkisë dhe kësaj rregulloreje jane:

a) këshilli i bashkisë/ komunës/ qarkut__________;
b) kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_________;
c) nën/kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_________;
d) drejtori i drejtorisë së burimeve njerëzore në bashki /komunë dhe këshillin e qarkut;
e) drejtuesit e institucioneve në varësi;
f) drejtorët e drejtorive;
g) përgjegjësit e sektorit.

2. Autoritet përgjegjës për zbatimin e ligjit nr 9367 datë 7.4.2005 në bashki /komunë/ këshill të qarkut, për parandalimin e konfliktit të interesave është drejtoria e burimeve njerëzore e bashkisë/komunës/këshillit të qarkut_____.
3. Si autoritet përgjegjës për këshillin e bashkisë ose komunës emërohet sekretari i këshillit.

3. Normat e përcaktuara në këtë rregullore janë të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo zyrtar i cili merr pjesë në një vendimmarrje për akte normative si dhe për akte e kontrata administrative ku përfshihen:

a) Kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_______.

b) Nën/kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut________.
c) Drejturesit e insitucioneve në varësi.
d) Drejtorët e drejtorive në bashki/ komunë/ këshill qarku _______ dhe institucionet në varësi.
e) Përgjegjësit e sektorëve në bashki/ komunë/ këshillin e qarkut ________ dhe institucionet e varësisë.
f) Specialistët në bashki/ komunë/ këshillin e qarkut______ dhe institucionet në varësi.
g) Anëtarët e KRRT-së.
h) Anëtarët e këshillit të bashkisë/ komunës/ qarkut_____.
i) Çdo zyrtar tjetër i institucioneve në varësi të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut________ (në rregullore citohen të gjitha institucionet, ndërmarrjet vendore, shoqëritë tregtare me pjesëmarrje kontrolluese të kapitalit vendor).

4. Institucionet e varësisë:

a) të cilat kanë ngritur strukturë përgjegjëse janë: ……. (pasqyrohen institucionet e varësisë në strukturën e të cilave funksionon drejtoria e burimeve njerëzore);
b) institucionet që nuk kanë ngritur strukturë përgjegjëse në bashkinë/ komunën/ këshillin e qarkut_________ janë: ….. (citohen institucionet).

5. Institucionet eprore:

a) Autoritet qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
b) Autoritete të tjera eprore janë:
- Eprorët e zyrtarëve sipas hierarkisë (drejtorë të drejtorive, përgjegjësit e sektorëve, drejtuesit e institucioneve në varësi).
- Drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore.

## Neni 9
## Detyrat e drejtorisë së burimeve njerëzore

1. Drejtoria e burimeve njerëzore, si autoritet përgjegjës në bashkinë/ komunën/ këshillin e qarkut__________, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 është e autorizuar që në mënyrë aktive, në emër të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_________:

a) të mbledhë, nga burime të ligjshme të informacionit, të dhëna për interesat private zyrtarëve;
b) të pranojë informacionet e siguruara në mënyrë të ligjshme;
c) të verifikojë besueshmërinë e informacioneve të marra;
d) të vërë në dijeni zyrtarin për informacionet e siguruara për të;
e) t'i japë mundësi zyrtarit të provojë të kundërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë;
f) të bëjë regjistrimin e interesave private të zyrtarit;
g) jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ose nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në një institucion publik, të njoftojë zyrtarin për detyrimin që të lëshojë një autorizim në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, për të kryer kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetiake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar. Ky autorizim ka të njëjtën vlerë dhe për çdo institucion epror;
h) për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistrohet identiteti i zyrtarit, interesat private të tij shkak për një konflikt interesi, thelbi i konfliktit, palët e

interesuara, mënyra e marrjes dhe e verifikimit të tyre, si dhe vendimi që është marrë, mbështetur në këto rrethana, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat;

i) me autorizim të kryetarit të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_____ kryen verifikim të interesave të deklaruara ose të padeklaruara të zyrtarëve, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji dhe informon për këtë, sipas rastit kryetarin e bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_______;

j) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së kundraligjshme të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin në vendosjen e gjobave në rastin e kundravajtjeve administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005;

k) përgatit plan-veprime, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj;

l) merr masa për të siguruar aksesin e informimit të publikut për të dhënat personale të zyrtarëve dhe me dokumente të tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit, duke respektuar konfidencialitetin e përcaktuar në legjislacionin shqiptar;

m) mbështet ILDKP-në në kryerjen e deklarimit periodik të interesave të zyrtarëve të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_________;

n) ndjek dhe zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të kryetarit të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_________ ose institucioneve të varësisë;

o) i gjithë dokumentacioni që ka të bëjë me deklarimin dhe kontrollin e pasurive arkivohet sipas rregullave përkatëse dhe ruhet për një periudhë 10 vjeçare.

## KREU III
## DETYRA PËR VEPRIM NË PROCES TË PARANDALIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

### Neni 10
### Administrimi i dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës

1. Autoriteti përgjegjës në zbatim të ligjit 9367, datë 7.4.2005, me qëllim administrimin sa më të mirë të dokumentacionit krijon dosje të veçanta si vijon:

a) Dosja nr. ____ me titull, aktet ligjore dhe nën ligjore. Në këtë dosje vendoset:

- ligji nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publik";
- ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në parandalimin e funksioneve publike";
- ligji nr 8485, datë 12.5.1999 " Kodi i procedurave administrative";
- ligji nr. 9131 datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- ligji nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare";
- ligji nr.8517, datë 22.7.1999 " Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- ligje të tjera që trajtojnë çështje të konfliktit të interesave në njësitë e qeverisjes vendore;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 22.10.2004 "Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike";

- urdhëra dhe udhëzime të ILDKP-së si dhe të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim;

- botime të ndryshme të ILDKP-së.

c) Dosja nr. ________ "Për identifikim dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave" e cila përmban:
- regjistrin e konfliktit rast për rast të interesave në forme libri, i sekretuar;
- autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarimin rast për rast të interesave;
- deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
- informacionet e marra nga publiku, nga media, apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
- verifikimet e bëra në regjistrat publike dhe private.

d) Dosja nr. _____ "Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe të interesave të zyrtareve që mbartin detyrim për deklarim në ILDKP", ku përfshihen:
- regjistri themeltar alfabetik, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKP;
- kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarim dhe konfirmimet e tyre;
- kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKP;
- kopje të formularit për listën e zyrtarëve që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
- libri për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

e) Libri i regjistrit të shkresave të nisura dhe të ardhura nga ILDKP.

## Neni 11
## Zyrtarët që mbartin detyrim për deklarim periodik të interesave private

1. Deklarimi i interesave private periodike bëhet nga zyrtarët sipas kërkesave të neneve *14 dhe 15* të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, ku përfshihet: kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut_________.
2. Kanë detyrim për deklarim të interesave private periodike: bashkëshorti/ja, fëmijët madhore të zyrtarëve të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut________ të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

## Neni 12
## Llojet e interesave private që deklarohen periodikisht

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave private që deklarohen periodikisht bëhen sipas përcaktimeve në nenin 15 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 dhe ligjit nr.9049, datë 10.4.2003.

## Neni 13
## Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo zyrtar apo subjekt që ofron informacion, bazuar në rastet e konfliktit të interesave të padeklaruar nga subjektet që mbartin detyrim, përfiton sipas rastit një mbrojtje të veçantë administrative.

a) Zyrtari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut _______, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi

shtetasin informues, dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit.

b) Kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i bashkisë/ komunës/ këshillt të qarkut______, që qëndron në marrëdhënie varësie më lart se zyrtari, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga përcaktimi i pikës 1, b të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ është ai në dukje, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Kur zyrtari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ :
   - Ose është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve.
   - Ose vetepërjashtimi është i pamundur, sepse është i pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës.
   - Ose për shkak se asnjëra nga zgjidhjet e parashikuara në nenin … të kësaj rregulloreje nuk është e mundur.

b) Dhe kur:
   - Vendimet e zyrtarit të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ , sipas parashikimeve në ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit, shfuqizimit nga një institucion epror.
   - Nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare etj).
   - Nuk ka kuptim që, për një rast konflikti të tillë, zyrtari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga eprori ose nga institucioni epror, i ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimet dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

### Neni 14
### Kufizimi i interesave private për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesave për çështje të veçanta

1. Funksioni i kryetarit të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______:

a) Nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______.

b) Nuk mund të ushtrojë veprimtari private që krijojnë të ardhura të personit fizik tregtar, ortakëri personash fizik tregtar të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licensuar, si dhe konsulentit, agjentit apo përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën (a) të këtij neni.

c) Nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.

d) Nuk mund të lidhë kontrata ndërmjet bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra ana dhe shoqërisë/ve tregtare ku kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut, ka aksione ose pjesë në kapital, pavarësisht nga sasia e aksioneve ose pjesëve të kapitalit që zotëron nga ana tjetër.

e) Nuk mund të lidhë kontrata ndërmjet bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë dhe një individi, personi fizik a juridik, apo ndonjë forme tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur kryetari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të kodit të procedurave administrative.

2. Funksioni i nën/kryetarit dhe zyrtarit të nivelit të lartë drejtues të bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ nuk mund të lidhë kontrata ndërmjet bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë nga njëra ana dhe shoqërisë/ve tregtare ku nën/kryetari ose zyrtari i nivelit të lartë drejtues të kësaj njësie vendore, ka aksione ose pjesë në kapital, pavarësisht nga sasia e aksioneve ose pjesëve të kapitalit që zotëron nga ana tjetër.

3. Pavarësisht përcaktimeve të mësipërme, ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ apo çdo institucioni tjetër të varësisë nga njëra anë dhe një individi, personi fizik a juridik, apo ndonjë forme ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) Zyrtari i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ apo insititucionit publik të varësisë ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës.
b) Ky zyrtar ka një interes privat sipas përcaktimeve të nenit 37 të kodit të procedurave administrative.

4. Ndalimet e përcaktuara në pikat e këtij neni zbatohen dhe për personat e lidhur të përcaktuar në nenin 16.

### Neni 15
### Ndalimi i marrjes së dhuratave

1. Është e ndaluar që çdo zyrtar i bashkisë/ komunës/ këshillit të qarkut ______ të marrë dhurata sipas kushteve dhe përcaktimeve të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 22.10.2004 "Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike".

2. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet gjithashtu sipas dispozitave të këtij vendimi të K.M. dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.

### Neni 16
### Prania dhe kufizimi i interesave të personave të lidhur me zyrtarin.

1. Persona të lidhur me zyrtarin, sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, janë bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es.

2. Person i lidhur me zyrtarin, në kuptimin e nenit 15 të kësaj rregulloreje, është bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es si dhe çdo person fizik ose juridik, i cili në lidhje me dhuratën, favorin apo premtimin preferencial luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lidhura nga ky veprim.

### Neni 17
### Mënyrat e trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave

1. Mënyrat bazë të trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave janë përcaktuar në kreun IV të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, neni 37.
2. Mënyrat bazë të trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit të vazhdueshëm të interesave janë parashikuar po në këtë ligj, në nenin 38 të tij.
3. Procedurat për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave përcaktohen sipas pikave të nenit 39 në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005.

**Neni 18**
**Shpërdorimi i së drejtës**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohen në asnjë rast sikur i japin të drejtë zyrtarëve të ndërmarrin veprime ose akte që cenojnë rregullat e përcaktuara në këtë rregullore dhe ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005.

2. Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005.

**Neni 19**
**Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më datë _________

**ANEKS GRUPI I EKSPERTËVE**

| | |
|---|---|
| Fatos Hodaj | Shoqata e Bashkive të Shqipërisë |
| Zyher Beci | Shoqata e Bashkive të Shqipërisë |
| Enea Hoti | Shoqata e Bashkive të Shqipërisë |
| Olsi Çoku | Shoqata e Bashkive të Shqipërisë |
| Eljona Lloja | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive |
| Dhimitrulla SPIRO | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive |
| Arbër Basholli | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive |
| Flori Karaj | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive |
| Fjorida Kallço | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive |
| Gjon NDREJA | Ekspert i Mbikëqyrjes dhe Auditimit, Programi i Shtetit Ligjor, DPK/USAID |
| Dr. Eralda ÇANI (METHASANI) | Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës |

BIBLIOGRAFIA


1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".
3. Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"
4. Kodi i Procedurave Administrative
5. E drejta Administrative – Sokol Sadushi, Tiranë 2005
6. "The politics of bureaucracy", Public Affairs Press, Washington DC, 1965 - Gordon Tullock.
7. "Komentari ligjor Nr.3" ILDKP, qershor 2006.
8. Ligji 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik